

# Dhuna në familje në Shqipëri

## Vrojt看im kombëtar me bazë popullatën

2013

### Raport i përgatitur nga

Dr. Robin N. Haarr

Konsulente ndërkombëtare e PNUD-it

**Nëntor 2013**



## PASQYRA E LËNDËS

|                                                                                                   |           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Falënderime                                                                                       | 5         |
| Lista e personelit të përfshirë në vrojtim                                                        | 5         |
| <b>Kapitulli 1: Hyrje</b>                                                                         | <b>7</b>  |
| Dhuna në familje në Shqipëri                                                                      | 9         |
| Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje (SKBGj-DhF)                       | 10        |
| Ligjet shqiptare lidhur me dhunën në familje                                                      | 12        |
| Vrojtimi i vitit 2007 me bazë popullatën për dhunën në familje në Shqipëri                        | 14        |
| Përse duhet bërë një vrojtim i dytë kombëtar me bazë popullatën për dhunën në familje në Shqipëri | 15        |
| Referenca                                                                                         | 16        |
| <b>Kapitulli 2: Ndërtimi i Studimit</b>                                                           | <b>17</b> |
| Përkufizime                                                                                       | 19        |
| Matja e dhunës në familje                                                                         | 21        |
| Zhvillimi i vrojtimit                                                                             | 21        |
| Struktura e vrojtimit                                                                             | 21        |
| Sigurimi i informacionit maksimal                                                                 | 23        |
| Ndërtimi i kampionit                                                                              | 23        |
| Intervistuesit                                                                                    | 24        |
| Administrimi i vrojtimit në terren                                                                | 24        |
| Përpunimi dhe analiza e të dhënave                                                                | 24        |
| Referenca                                                                                         | 24        |
| <b>Kapitulli 3: Demografia e kampionit</b>                                                        | <b>25</b> |
| Kampioni                                                                                          | 27        |
| Demografia e familjeve                                                                            | 27        |
| Demografia e grave                                                                                | 28        |
| <b>Kapitulli 4: Dhuna në familje ndaj grave</b>                                                   | <b>31</b> |
| Dhuna në familje ndaj grave                                                                       | 33        |
| Dhuna psikologjike                                                                                | 34        |
| Dhuna fizike                                                                                      | 36        |
| Dhuna seksuale                                                                                    | 37        |
| Llojet e shumëfishta të dhunës në familje                                                         | 40        |
| Kur fillon dhuna në familje në martesë                                                            | 41        |
| Dhuna fizike gjatë shtatzënisë                                                                    | 42        |
| Lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje                                                        | 42        |
| Dhunimi seksual, përdorimi i kontraceptivëve dhe rreziku i SST-ve                                 | 45        |

|                                                                 |    |
|-----------------------------------------------------------------|----|
| Alkooli dhe dhuna në familje                                    | 46 |
| Ndikimet demografike mbi dhunën në familje                      | 47 |
| Gjendja civile e grave                                          | 47 |
| Mosha e grave                                                   | 49 |
| Niveli arsimor i grave                                          | 50 |
| Statusi i punësimit të grave                                    | 51 |
| Vendbanimi i grave: urban kundrejt rural                        | 53 |
| Dhuna në familje e ushtruar nga anëtarë të tjerë të familjes    | 54 |
| Ndikimi i dhunës në familje tek fëmijët                         | 55 |
| Sjelljet e viktimave të dhunës në familje në kërkimin e ndihmës | 55 |
| Intervistat e ndërprera                                         | 58 |
| Referenca                                                       | 59 |

## **Kapitulli 5: Përfundim** **61**

|                                                                  |    |
|------------------------------------------------------------------|----|
| Dhuna në familje ndaj grave                                      | 63 |
| Llojet e ndryshme të dhunës në familje                           | 64 |
| Kur fillon dhuna në familje në martesë                           | 64 |
| Lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje                       | 65 |
| Dhunimi seksual, përdorimi i kontraktivëve, dhe rreziku i SST-ve | 65 |
| Alkooli dhe dhuna në familje                                     | 66 |
| Gjendja civile e grave dhe dhuna në familje                      | 66 |
| Mosha e grave dhe dhuna në familje                               | 66 |
| Niveli arsimor i grave dhe dhuna në familje                      | 67 |
| Niveli arsimor i burrave dhe dhuna në familje                    | 67 |
| Gjendja e punësimit të grave dhe dhuna në familje                | 67 |
| Gjendja e punësimit dhe dhuna në familje                         | 68 |
| Vendbanimi i grave (urban kundrejt rural) dhe dhuna në familje   | 68 |
| Dhuna në familje nga anëtarë të tjerë të familjes                | 68 |
| Ndikimi i dhunës në familje mbi fëmijët                          | 68 |
| Sjelljet e grave të dhunuara në kërkimin e ndihmës               | 69 |
| Referenca                                                        | 70 |

## **Shtojca me tabela** **71**

## FALËNDERIME

Ky raport kërkimor mbi dhunën në familje në Shqipëri është fryt i bashkëpunimit të ngushtë midis Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, me mbështetjen financiare të qeverisë së Suedisë. Ky projekt e ka bazën tek pranimi i premisë se të dhënat kombëtare për dhunën në familje në Shqipëri janë të domosdoshme për zhvillimin e politikave dhe të planeve të veprimit për reagim, ndërhyrje, dhe mbrojtje në rastet e dhunës në familje, sidomos të dhunës ndaj grave.

Dëshirojmë t'u shprehim falënderimet dhe mirënjohjen tonë të veçantë drejtuesve, personelit dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm të INSTAT-it, si institucioni kryesor teknik që hartoi dhe zbatoi këtë Vrojtje të dytë Kombëtar, mbështetur në përvojën e Studimit Bazë të vitit 2007. Dr. Ines Nurja dhe Dr. Gjergji Filipi, në kapacitetin e tyre si Drejtore të Përgjithshme të INSTAT-it, bënë në vijimësi drejtimin administrativ dhe teknik të projektit. Znj. Ledia Thomo, znj. Teranda Jahja, znj. Eriona Dhamo, znj. Blerta Miruku dhe zoti Shefqet Plyku rishikuan pyetësonin, bënë trajnimin e intervistuesve, përcaktuan metodologjinë e vërtetimit, si dhe kryen përpunimin e të dhënave. Znj. Ogerta Elezaj, Znj. Alma Kondi dhe znj. Dorina Metalia përkufizuan kampionin, programuan regjistrimin elektronik të informacionit, bënë ponderimin e të dhënave dhe përgatitën grupin e të dhënave përfundimtare për përpunim të mëtejshëm. Znj. Edlira Subashi dhe znj. Albana Lumani dhanë ndihmesën e tyre në testimin e

pyetësonit dhe të programit për hedhjen e të dhënave, si dhe bënë mbikëqyrjen e punës në terren.

Dëshirojmë gjithashtu t'i shprehim mirënjohjen dhe të falënderojmë PNUD-in për mbështetjen e këtij projekti kërkimor si dhe znj. Entela Lako dhe znj. Emira Shkurti për këshillat dhe udhëzimet profesionale që ofruan. Po kështu dëshirojmë falënderojmë konsulentin ndërkombëtar të PNUD-it, Dr. Robin Haarr, që dha këshilla për rishikimin e pyetësonit, kreu analizën e të dhënave dhe, në bashkëpunim të ngushtë me personelin e INSTAT-it, gjeneroi tabelat dhe figurat, si dhe shkroi raportin përfundimtar.

Dëshirojmë të falënderojmë ekspertët teknikë, përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, sidomos të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, dhe të Ministrisë së Brendshme, përfaqësuesit e organizatave dhe donatorëve ndërkombëtarë, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, anëtarët e botës akademike dhe ekspertët e tjerë të statistikave dhe të dhunës me bazë gjinore, për mendimet dhe rekomandimet e tyre të vyera mbi të dhënat paraprake të Vërtetimit.

Së fundi, dëshirojmë t'u shprehim mirënjohjen dhe falënderimet tona grave që morën pjesë në studim dhe dhuruan kohën e tyre për t'u përgjigjur pyetjeve tona dhe për të ndarë me ne përvojat e tyre vetjake. I kërkojmë ndjesë çdokujt që, pa dashje, mund të ketë mbetur pa u përmendur.

## PËR KONSULENTEN NDËRKOMBËTARE

Dr. Robin N. Haarr ka punuar për më se 15 vjet me organizata dhe institucione qeveritare për kryerjen e studimeve kërkimore themelore, vlerësuese dhe programuese, dhe për hartimin e rekomandimeve për politika dhe programe mbi bazën e të dhënave. Ajo ka ekspertizë edhe në drejtimin e trajnimeve për ndërtimin kapacitetesh në lidhje me studimet kërkimore dhe zhvillimin e politikave dhe të programeve. Ajo ka punuar gjerësisht me çështje si dhuna ndaj grave dhe fëmijëve, trafikimi dhe shfrytëzimi i qenieve njerëzore, shërbimet e mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave, mbrojtja e fëmijëve dhe sistemet e mirëqenies sociale, institucionet e përkujdesit alternativ dhe shërbimet për përkrahjen e viktimave, qasja në drejtësi dhe reagimet e sistemit të

drejtësisë, si dhe të drejtat e grave dhe fëmijëve. Për këto çështje ajo ka punuar me organizata si UNICEF, PNUD, Programi i Grave i OKB-së, ILO, OSBE, USAID, SDC dhe Departamenti i Shtetit i SHBA/Ambasadat e SHBA-ve. Dr. Haarr ka punuar në shumë vende të Azisë, të Komonuelthit të Shteteve të Pavarura, Evropës Qendrore dhe Lindore, dhe në Afrikë. Përkushtimi dhe drejtimi i saj në trajtimin e çështjeve si dhuna ndaj fëmijëve dhe grave, dhuna me bazë gjinore, shfrytëzimi dhe trafikimi i qenieve njerëzore, shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve dhe mbështetjen e viktimave, dhe qasja në drejtësi, kanë sjellë ndryshime të rëndësishme në politika dhe zhvillime programesh në të mirë të fëmijëve, grave, familjeve dhe bashkësive.

Kontakti: [robinhaarr@yahoo.com](mailto:robinhaarr@yahoo.com)

## LISTA E PERSONELIT TË PËRFSHIRË NË VROJTIM

### Drejtori i botimit

Dr. Gjergji Filipi, Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT-it

### Ekipi i ekspertëve të INSTAT-it

Ledia Thomo (M.A.)

Teranda Jahja (M.A.)

Eriona Dhamo (M.A.)

Blerta Miruku (M.A.)

Shfqet Plyku (M.A.)

Dorina Metalia (M.A.)

Alma Kondi

### PNUD

Entela Lako (M.A)

Emira Shkurti (LL.M., M.A.S)

### Bashkërenduese e vrojtimit

Elda Kapllani (M.A.)

### Konsulente ndërkombëtare

Dr. Robin N. Haarr

### Përktheu në shqip

Majlinda Nishku

# 1

## Hyrje







Dhuna në familje ndaj grave është një problem i përhapur shëndetësor global, që kapërcen kufijtë dhe ndodh në të gjitha kulturat dhe shoqëritë anëmbanë botës. Dhuna në familje është një formë dhune ndaj grave, të cilën Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës Ndaj Grave e përkufizon si “çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell ose ka gjasa të rezultojë në lëndime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike të grave, përfshirë edhe kanosjet për akte të tilla, shtrëngime, apo privime arbitrare të lirisë, qoftë kur ndodhin në jetën publike, ashtu edhe në jetën private.” (1)

Në vitin 2002, një sqyrtim i 50 studimeve me bazë popullsinë të kryera në 35 vende para vitit 1999, tregoi se 10% deri 69% e grave raportonin se ishin dhunuar fizikisht nga një partner intim në ndonjë moment të jetës së tyre, dhe se 10% deri 30% e grave raportonin se kishin përjetuar dhunë seksuale nga një partner intim (2). Në vitin 2005, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), në një studim shumë-vendësh për dhunën ndaj grave në familje të kryer në 10 vende të zgjedhura, tregoi se 13% deri 61% e grave që kanë pasur ndonjëherë partner, kanë pësuar dhunë

fizike nga një partner intim, ndërsa 6% deri 59% e grave kanë pësuar dhunë seksuale nga një partner intim (3). Në vitin 2013, OBSh kreu një meta-analizë të 185 studimeve nga 86 vende dhe analizoi të dhënat nga 155 studime në 81 vende dhe konstatoi që 30% deri 37% e grave që kanë qenë ndonjëherë në një marrëdhënie, kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partnerët e tyre intimë. Gjithashtu, ky studim konstatoi se rreth 80% e kësaj dhune ndodh në familje. Përveç kësaj, studimi konstatoi se 42% e grave të dhunuara fizikisht ose seksualisht nga partnerët e tyre intimë, kishin pësuar lëndime, dhe se 38% e numrit të përgjithshëm të vrasjeve të grave kryhen nga partnerët intimë (4).

Me gjithë ngjashmëritë në përvojat e grave me dhunën në familje në kultura dhe shoqëri të ndryshme, të kuptuarit e veçorive brenda një shoqërie të caktuar është kyç për zhvillimin e reformave legjislative dhe hartimin e politikave, të nismave parandaluese dhe atyre të ndërhyrjes, si dhe të sistemeve të mbrojtjes dhe përkrahjes për viktimat dhe të mbijetuarat e dhunës në familje.

## DHUNA NË FAMILJE NË SHQIPËRI

Në Shqipëri, dhuna në familje është një problem që ndikon negativisht tek gratë dhe fëmijët, si edhe tek familjet dhe bashkësitë (5, 6). Megjithatë, shqiptarët priren ta konsiderojnë dhunën në familje si një çështje private, familjare, dhe si një pjesë normale të jetës bashkëshortore e familjare. Duke qenë se dhuna në familje shpesh ndodh pas dyerve të mbyllura dhe nuk diskutohet, pranohet apo trajtohet hapur në shoqërinë shqiptare, viktimat përgjithësisht vuajnë në heshtje (7).

Dhuna në familje u shfaq si problem shqetësues në Shqipëri në vitet '90, kur vendi po përjetonte ndryshime të mëdha politike dhe shoqërore. Në vitin 1992, Partia e Punës e Shqipërisë ia la pushtetin një parlamenti të zgjedhur në mënyrë demokratike. Ky ndryshim madhor politik e hapi Shqipërinë ndaj ndihmave, ekspertizës dhe investimeve të huaja, ndërkohë që vendi filloi procesin e shndërrimit dhe reformimit të strukturave të tij ekonomike, ligjore dhe politike (8). Ky tranzicioni solli edhe një vërshim organizatash ndërkombëtare (ON) për mbështetjen e reformave dhe rindërtimit të vendit, si dhe krijimin e organizatave joqeveritare (OJQ). Disa prej këtyre organizatave iu kushtuan çështjeve të grave, ku përfshihen dhuna ndaj grave dhe të drejtat njerëzore të grave. Ndonëse dhuna në familje kishte ekzistuar shumë kohë përpara kësaj periudhe tranzicioni, rastet e dhunës në familje pësuan rritje të ndjeshme në vitet '90, ndërkohë që familjet po përjetonin shumë stresa dhe trysni si pasojë e tranzicionit (p.sh., nivele të larta papunësie, mungesa të mëdha në strehim, dhe shtim të trazirave shoqërore dhe krimeve të dhunshme në rrugë).

Dhuna në familje ndaj grave nuk është dukuri e re në Shqipëri; ajo i ka rrënjët thellë në traditat dhe zakonet patriarkale (p.sh., rolet dhe identitetet e ngurta gjinore, autoriteti patriarkal, respektimi i kodit të nderit dhe turpit, dhe kontrolli i disa brezave brenda familjes) që prej kohësh i kanë dhënë formë shoqërisë shqiptare. Dyzet vjet të regjimit komunist në Shqipëri (1946–1991) nuk i zhdukën plotësisht këto qëndrime patriarkale të rrënjësura thellë, ndër të cilat edhe ato që lidhen me Kanunin e Lek Dukagjinit, i cili përdorej në disa zona të Shqipërisë. Në fakt, burrat dhe gratë në disa zona të Shqipërisë ende i referohen Kanunit për të shpjeguar qëndrimet dhe pikëpamjet për rolet gjinore dhe autoritetin patriarkal, përfshirë të drejtën e burrit për ta “ndëshkuar” gruan, e cila konsiderohet si pronë e tij (9, 10).

Që nga viti 1991, qeveria e re e sapokrijuar e Republikës së Shqipërisë ratifikoi një numër të madh konventash të rëndësishme, si:

- Konventa e OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike (ratifikuar më 4 tetor 1991);
- Konventa e OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ratifikuar më 4 tetor 1991);

(1) Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve i jep kompetenca të qarta Shtetit për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës në shtëpi dhe familje, dhe përcakton rolin e tij si vendimmarrësi përfundimtar i interesit më të mirë të fëmijës në fushën familjare. Ndonëse Shteti nuk mund të mbajë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për akte të veçanta të dhunës së prindërve ndaj fëmijëve, atij i kërkohet të ofrojë kuadrin ligjor dhe masat e tjera të nevojshme për të ofruar mbrojtje të mjaftueshme, përfshirë edhe masat efektive parandaluese dhe frenuese.

- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, e ratifikuar më 27 shkurt 1992)<sup>(1)</sup>;
- Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese (ratifikuar më 11 maj 1994);
- Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e ratifikuar më 11 maj 1994);
- Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolli përkatës i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, (ratifikuar më 10 shkurt 1996);
- Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës dhe të Dënimeve ose Trajtimeve të tjera Çnjerëzore ose Degraduese (e ratifikuar më 10 shkurt 1996);
- Konventa Europiane për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (ratifikuar më 4 shkurt 2013).

Në vitin 1998, qeveria e Shqipërisë miratoi edhe Kushtetutën e re, e cila promovon parimet e barazisë dhe mos-diskriminimit, si dhe mbrojtjen e respektimit të dinjitetit njerëzor dhe të të drejtave të lirive të njeriut. Për shembull, Neni 18/2 i saj thotë: “Të gjithë janë të barabartë përpara

ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale.” Më tej, Neni 54/3 i Kushtetutës thotë se çdo fëmijë ka të drejtën “të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin normal të fëmijës.”

Që nga koha kur qeveria e Republikës së Shqipërisë i ratifikoi këto konventa të ndryshme ndërkombëtare dhe miratoi Kushtetutën e re, ON-të dhe OJQ-të kanë punuar në bashkëpunim me qeverinë për të trajtuar çështjet e dhunës ndaj grave, përfshirë edhe dhunën ndaj grave në familje. Ndër këto përpjekje të përbashkëta lidhur me dhunën në familje janë masat parandaluese (nismat edukative dhe fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit), masat mbrojtëse (shërbimet për përkrahjen e viktimave, shërbimet e këshillimit dhe strehat për dhunën në familje), dhe masat ligjore (legjislacioni për dhunën në familje që mbron viktimat e dhunës në familje dhe ndëshkon penalisht autorët e saj).

## STRATEGJIA KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE DHE DHUNËN NË FAMILJE (SKBGJ-DHF)

Në vitin 2006, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta hartoi Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje (SKBGJ-DHF) për periudhën 2007-2010. Kjo Strategji për vitet 2007-2010 dhe plani i veprimit i lidhur me të, ishin një tregues i angazhimit politik të qeverisë për të marrë masa për arritjen e barazisë gjinore përmes përfshirjes gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave, dhe për të përmirësuar ndihmën e mbrojtjen për viktimat e dhunës në familje, reagimin e sistemit të drejtësisë ndaj rasteve të dhunës në familje, dhe parandalimin nëpërmjet goditjes së shkaqeve themelore të dhunës në familje (11, 12). Në kuadrin e zbatimit të SKBGJ-DHF për vitet 2007-2010, u bë përpjekje për të siguruar bashkërendimin e nismave qeveritare me angazhimin e organizatave të shoqërisë civile (13).

Si rezultat i SKBGJ-DHF për vitet 2007-2010, ka pasur zhvillime të konsiderueshme dhe të prekshme në promovimin e barazisë gjinore dhe trajtimin e problemit të dhunës në familje. Ndër këto zhvillime ishin (14, 15):

- Krijimi i mekanizmave institucionale për barazinë gjinore;
- Përpjekje për ngritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin e dhunës në familje;


- Zhvillimi i reagimeve të bashkërenduara në bashkësi me synim përmirësimin e reagimit ndaj rasteve të dhunës në familje ndaj grave;
- Përmirësime në legjislacionin lidhur me dhunën në familje dhe atë me bazë gjinore, përfshirë legjislacionin për ndihmë sociale për viktimat e dhunës me bazë gjinore;
- Regjistrim dhe evidentim më i mirë i rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- Trajnime të punonjësve civilë në organet e qeverisjes vendore, punonjësve të shëndetësisë, dhe të punonjësve të rendit dhe ligjit, për të kuptuar dhunën me bazë gjinore e dhunën në familje dhe për të reaguar ndaj tyre;
- Krijimi i njësive përgjegjëse për dhunën në familje në institucionet përkatëse të Ministrisë së Brendshme;
- Përmirësime në zbatimin e ligjeve mbi barazinë gjinore dhe dhunën në familje.

Aty nga viti 2011, dhuna në familje po shihej gjithnjë e më shumë si një problem shoqëror i papranueshëm dhe në të gjithë vendin u shtri një sistem i bashkërenduar reagimi, me përfshirjen e organizatave qeveritare dhe joqeveritare.

Të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Sigurinë publike, tregojnë se numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në polici është rritur ndjeshëm nga vetëm 94 në vitin 2005, në 2

526 në vitin 2012. Përveç kësaj, numri i padive penale për urdhra mbrojtjeje u rrit nga 0 në vitin 2005 (në vitin 2005 nuk kishte urdhra mbrojtjeje) në 1 234 në vitin 2010 dhe 1 562 në vitin 2011.

**Figura 1.1.** Rastet e regjistruara të dhunës në familje dhe të padive për urdhër mbrojtjeje (2005-2012)



Kjo rritje shënoi edhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe besimit të publikut tek legjislacioni për dhunën në familje dhe ndihmën sociale për viktimat dhe të mbijetuarat e dhunës në familje. Në vitin 2011, në Tiranë u hap edhe streha e parë shtetërore për viktimat e dhunës në familje (16).<sup>(2)</sup>

Por, me gjithë arritjet e rëndësishme në promovimin e barazisë gjinore dhe trajtimin e dhunës në familje në Shqipëri, shumë shpesh, rastet e diskriminimit dhe të dhunës në familje ndaj grave nuk raportohen në polici dhe në gjykata, sepse gratë që janë viktimat të këtij diskriminimi dhe të kësaj dhune nuk i njohin të drejtat e tyre dhe shumë shpesh nuk guxojnë të flasin hapur apo të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje (17).

Në vitin 2010 u hartua Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje për vitet 2011-2015, me synimin për të çuar më tej arritjet e SKBGJ-DHF-së të viteve 2007-2010 dhe ato të Programit

të Përbashkët të OKB-së për Barazinë Gjinore. Strategjia për vitet 2011-2015 përvijon strategjinë kombëtare që do të vazhdojë të trajtojë çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje, duke forcuar barazinë gjinore përmes përfshirjes gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave, dhe duke rritur ndërgjegjësimin dhe forcuar shërbimet për mbrojtjen dhe mbështetjen administrative e ligjore për viktimat e dhunës me bazë gjinore (18, 19). Kjo do të thotë gjithashtu përmirësim i mëtejshëm i kornizave ligjore për dhunën me bazë gjinore dhe masa më të ashpra ndëshkimore për këto akte dhune, si dhe zgjerim të trajnimeve për autoritetet publike dhe punonjësit e drejtësisë për të përmirësuar reagimet e tyre ndaj dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Së fundi, ajo përfshin krijimin e një sistemi për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.

<sup>(2)</sup> Kjo strehë me 40 shtretër plotëson standardet ndërkombëtare dhe përbën një hap të parë nga ana e qeverisë për t'u ofruar strehë të mbijetuarave të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre.

## LIGJET SHQIPTARE LIDHUR ME DHUNËN NË FAMILJE

Në vitin 2006, parlamenti shqiptar miratoi ligjin e parë për dhunën në familje në Shqipëri. Qëllimi i këtij ligji, me titull “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare,” është të parandalojë dhe pakësojë dhunën në familje në të gjitha format e saj me anë të masave të përshtatshme ligjore, si dhe të garantojë mbrojtjen me mjete ligjore të anëtarëve të familjes që janë objekt i dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të posaçme nevojave të fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, dhe të moshuarve (20).<sup>(3)</sup>

Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” e përkufizon qartë dhunën në familje si “çdo akt dhune (domethënë çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një tjetri që sjell si pasojë cenimin e integritetit të tij fizik, moral, psikologjik, seksual, social, dhe ekonomik) i ushtruar ndërmjet personave që janë, ose kanë qenë, në marrëdhënie familjare”. Ligji ka katër objektiva kryesore (21):

1. Të krijojë një rrjet të bashkërenduar të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, dhe për zbutjen e pasojave të dhunës në familje dhe parandalimin e saj;
2. Të drejtojë përpjekjet për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
3. Të fuqizojë kompetencat e organeve gjyqësore në marrjen e masave mbrojtëse kundër dhunës në familje;
4. Të sigurojë/garantojë që viktimave të dhunës t’u ofrohen shërbime të shpejta, jo të kushtueshme, dhe të thjeshta nga gjykatat dhe organet e tjera ligjzbatuese në përputhje me ligjin.

Është e rëndësishme të theksohet se ky ligj ofron edhe masa mbrojtëse kundër dhunës në familje, ndër të cilat edhe urdhrat mbrojtës nga gjykata (vendim i lëshuar nga gjykata që ofron masa mbrojtëse për viktimën) dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes (urdhër me vendim gjykate i vlefshëm deri në lëshimin e një urdhri mbrojtjeje nga gjykata). Kur kërkesa për urdhër mbrojtjeje bëhet policia apo prokuroria, edhe në qoftë se viktimë (nën presion) dëshiron ta tërheqë padinë/paditë dhe ta ndërpresë procedimin penal, kjo nuk ndikon në vazhdimin e procesit gjyqësor. Dhe, duke qenë se gruaja e keqtrajtuar është dëshmitarja kryesore, ligji e përkufizon gruan e keqtrajtuar si “dëshmitare e detyrueshme” (22).<sup>(4)</sup>

<sup>(3)</sup> Ligji nr. 9669, datë 18 dhjetor 2006.

<sup>(4)</sup> Numri i individëve që iu drejtuan gjykatës për shkak të dhunës dhe numri i urdhrave të mbrojtjes të lëshuar nga gjykata u shtuan gjatë periudhës së SKBGJ-DhF 2007-2010 (gjykatat në qytetet e mëdha dhe të vogla mund të lëshojnë urdhra mbrojtjeje); sidoqoftë, strukturat ekzekutuese e kanë pasur të vështirë të ekzekutojnë urdhrat mbrojtës të lëshuar nga gjykatat.

Në bazë të nenit 321 të Kodit Penal, moszbatimi i një urdhri mbrojtjeje apo urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim deri në dy vjet. Është e rëndësishme të vihet në dukje se lëshimi i një urdhri mbrojtjeje apo urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje nuk i pengon palët e interesuara që të nisin edhe procedurat penale në lidhje me veprimet apo mosveprimet që klasifikohen si kundërvajtje penale (23).

Ndonëse në Shqipëri kompetencat e policisë për të hyrë në mjedise private janë përgjithësisht të kufizuara, ligji për dhunën në familje parashikon se policia mund të hyjë në një banesë private në një situatë dhune në familje, nëse një gjë e tillë u kërkohet nga një person që duket se banon në atë mjedis, ose kur punonjësi i policisë ka arsye të besojë se një person në atë mjedis është sulmuar ose mund të sulmohet nga çasti në çast (24).

Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” gjithashtu organizon gjashtë institucione qeveritare në një rrjet të bashkërenduar autoritetesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, zbutjen e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje (25). Autoriteti drejtues sipas këtij ligji është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Autoritetet të tjera përgjegjëse janë Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe njësitë e qeverisjes vendore. Në vitin 2011, në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 8/8 të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (ndryshuar në vitin 2010), Këshilli i Ministrave vendosi krijimin e “Mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”. Në bazë të këtij vendimi u krijuan komitete drejtuese përgjegjëse për bashkërendimin e veprimtarive të organeve kompetente përgjegjëse në nivel vendor dhe për referimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe u përcaktuan përgjegjësitë e ekipeve teknike ndër-dikasteriale dhe të bashkërenduesve vendorë për referimin e rasteve të dhunës në kushtet e familjes (26).

Në vitin 2010 ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” iu bënë ndryshime. Një ndër ndryshimet ishte edhe angazhimi për ngritjen e një qendre kombëtare për shërbime të përkujdesit social për viktimat e dhunës në familje. Gjithashtu, ai e vuri theksin edhe tek mbrojtja e konfidencialitetit të të dhënave dhe informacionit vetjak të viktimës me anë të përmirësimit të mekanizmave bashkërenduese dhe referuese për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, dhe përmirësimit të urdhrave të mbrojtjes (27).

Përveç ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, pas ndryshimeve të miratuara në vitet 2012 dhe 2013, Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë iu shtuan

edhe dispozita të veçanta për veprat penale që lidhen me dhunën në familje. Këto dispozita penale përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me:

- Neni 130/a: Dhuna në familje, përfshirë rrahja, kanosja, dhe plagosja e kryer me dashje, dënohen me burgim gjer në pesë vjet.
- Neni 121/a: Përndjekja. Kërcënimi ose apo “veprimet e përsëritura” me qëllimin për t’i shkaktuar një personi një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndërrojë mënyrën e jetesës. Këto kërcënime apo ngacmime dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 4 vjet. Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti/ bashkëjetuesi, dënimi rritet me një të tretat. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazot për t’u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet me një të dytën.
- Neni 124/b: keqtrajtimi fizik ose psikologjik ndaj të miturit nga anëtarët e familjes ose çdo person që kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet dhe mund të çojë edhe në humbje të përgjegjësisë prindërore.
- Me ndryshimet e kohëve të fundit janë shtuar në veçanti si rrethana rënduese: a) kur vepra penale është kryer në kundërshtim me urdhrat e mbrojtjes; b) kur vepra penale është kryer duke përfutur nga marrëdhëniet familjare ose të bashkëjetesës; c) kur vepra penale është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, identitetin gjinor, etj. Në këtë rast të fundit, e Drejta Penale nuk ofron asnjë mundësi për të kërkuar rrethana lehtësuese.
- Sipas ndryshimeve më të fundit, për veprat e tjera penale si vrasja me dhe pa paramendim, plagosjet e rënda dhe të lehta, parashikohen dënime më të rënda kur veprat penale janë kryer kundër një partneri, bashkëshorti, apo anëtar të familjes.
- Neni 102: Marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura. Në vitet 2012/2013 ky nen u ndryshua për të përfshirë edhe marrëdhëniet seksuale ndërmjet bashkëshortëve/bashkëjetuesve pa pëlqimin e njërit prej tyre, dhe dënohet me burgim deri në 3 vjet.
- Neni 106: Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari (kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale midis prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, midis personave të tjerë që janë gjini, ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie apo birësimi), dënohet me burgim deri në shtatë vjet.
- Vepra të tjera penale seksuale të kryera në praninë të miturve gjithashtu dënohen me ligj.

Ndër veprat e tjera penale kundër anëtarëve të familjes që vazhdojnë të jenë pjesë e Kodit Penal janë:

- Neni 124: Braktisja e fëmijëve të mitur (braktisja e fëmijës nën moshën 16 vjeç nga prindi ose nga personi që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet; kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e fëmijës, kjo dënohet me burgim nga 3 deri në 10 vjet). Ky nen u ndryshua në vitet 2012/2013 për të përfshirë keqtrajtimin fizik dhe psikologjik të një të mituri nga prindërit, vëllezërit dhe motrat, gjyshërit dhe gjyshet, kujdestarët ligjorë, apo çdo person tjetër që ka për detyrë të kujdeset për të miturin, dhe dënohet me burgim nga 3 muaj deri në 2 vjet.
- Neni 125: Mosdhënia e mjeteve për jetesë (mosdhënia e mjeteve të nevojshme për jetesën fëmijëve, prindërve ose bashkëshortit, nga personi që në zbatim të një vendimi gjyqësor ka detyrim ta japë), përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Përveç ndryshimeve në Kodin Penal të identifikuar më lart, që shërbyen për kriminalizimin e akteve të caktuara të dhunës me bazë gjinore dhe asaj në familje, dhe dhënien e dënimeve për këto vepra penale, Kodi Penal u ndryshua edhe për njohjen e kanosjes ose “veprimeve të përsëritura” me synim për t’i shkaktuar personit një ndjenjë të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi ose frike për sigurinë e vet, sigurinë e të afërmeve, apo sigurinë e një personi me të cilin kanë lidhje shpirtërore, apo që synojnë ta detyrojnë atë të ndryshojë mënyrën e jetesës. Këto kërcënime apo ngacmime dënohen me burgim nga 6 muaj në 4 vjet. Në rastin kur kjo vepër penale kryhet nga një ish bashkëshort/ bashkëjetues, dënimi rritet me një të tretën. Kur vepra penale kryhet ndaj një të mituri, gruaje shtatzënë, ose personi të paftë për t’u mbrojtur, nga një person me maskë ose shoqërohet me zotërim apo përdorim armësh, dënimi rritet me një të dytën.

Po kështu, Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë përmban një sërë nenesh lidhur me dhunën në familje ndaj bashkëshortit dhe fëmijës/fëmijëve. Kodi i Familjes trajton detyrimet prindërore dhe të drejtat e fëmijëve në jetën familjare, si edhe keqtrajtimin dhe lënien pas dore të fëmijëve. Për shembull, neni 62 parashikon se “bashkëshorti dhunues mund të nxirret jashtë banesës bashkëshortore”. Megjithatë, ky nen nuk ka dispozita të tjera procedurale.

Së fundi, ligji “Për Shëndetin Riprodhues” parashikon që çdo grua vendos me vullnetin e saj të lirë dhe pa asnjë formë diskriminimi, presioni, ose dhune, për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin dhe me shëndetin e saj seksual dhe riprodhues.<sup>(5)</sup>

<sup>(5)</sup> Ligji nr. 8876, datë 4 prill 2002.



## VROJTIMI KOMBËTAR I VITIT 2007 PËR DHUNËN NË FAMILJE NË SHQIPËRI<sup>(6)</sup>

Në vitin 2007, Instituti Kombëtar i Statistikave i Republikës së Shqipërisë (INSTAT) ndërmori vërtetimin e parë kombëtar me bazë popullatën për dhunën në familje në Shqipëri. Qëllimi i këtij vërtetimi kombëtar i vitit 2007 për dhunën në familje ishte të gjeneronte të dhëna dhe rezultate të besueshme për natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje në Shqipëri, që mund të përdoret si bazë për zhvillimin e masave efektive parandaluese, mbrojtëse dhe ligjore, si dhe të politikave për trajtimin e problemit të dhunës në familje dhe për mbështetjen e viktimave dhe të mbijetuarave të dhunës në familje (28).

Vërtetimi i vitit 2007 nxori përfundime shumë interesante dhe domethënëse, disa prej të cilave theksohen në këtë seksion; për përfundimet e plota mund t'i referoheni raportit të plotë (20). Një nga rezultatet më kryesore të vërtetimit kombëtar me bazë popullatën për dhunën në familje të vitit 2007 ishte se të paktën 56,0% e grave dhe vajzave 15-49 vjeç kishin përjetuar dhunë në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Më konkretisht, 50,6% e grave kishin përjetuar dhunë emocionale, 39,1% dhunë psikologjike, 31,2% dhunë fizike, dhe 12,7% dhunë seksuale, në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Përgjithësisht gratë e keqtrajtuara nuk kishin përjetuar vetëm një lloj dhune, por lloje të shumfishta dhune në të njëjtën kohë në martesë/marrëdhënien e tyre intime (29).

Në varësi nga lloji i dhunës në familje i përjetuar nga gratë, kishte disa dallime të rëndësishme sipas nivelit arsimor, gjendjes së punësimit, grupmoshës, dhe gjendjes civile të grave. Më konkretisht, gratë dhe vajzat me arsim të lartë kishin shumë më pak gjasa të përjetonin dhunë në familje në martesë/marrëdhënien e tyre intime, krahasuar me gratë dhe vajzat me arsim të mesëm, tetëvjeçar, fillor, apo më të ulët. Gratë me arsim fillor ose më të ulët kishin gjasat më të mëdha të përjetonin dhunë fizike nga bashkëshortët/partnerët e tyre intimë. Për sa i përket gjendjes së punësimit, gratë dhe vajzat që nuk punonin jashtë shtetësisë kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin dhunë në martesë/marrëdhënien e tyre intime në krahasim me ato që ishin të punësuar jashtë shtetësisë. Ndërsa për sa i përket dallimeve ndërmjet zonave urbane dhe rurale, gratë dhe vajzat në zonat rurale kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë në familje krahasuar me gratë në zonat urbane (30).

Vërtetimi i vitit 2007 tregoi gjithashtu se gjysma e grave që kishin përjetuar dhunë në familje thanë se dhuna kishte filluar brenda vitit të parë të martesës/bashkëjetesës. Një e treta e tyre thanë se dhuna në familje kishte filluar në vitin e 2-të ose të 3-të të martesës/bashkëjetesës. Kështu, shumë prej grave të intervistuar kishin jetuar me dhunën në martesën dhe në familjen e tyre nga 10 deri në 30 vjet (31).

Vërtetimi i vitit 2007 tregoi gjithashtu se gratë e keqtrajtuara shpesh kishin pësuar lëndime të shkallëve të ndryshme nga dhuna në familje. Në veçanti, 48,3% e grave të keqtrajtuara kishin pësuar çarje/prerje, nxirje, dhe/ose dhimbje; 18,1% kishin pësuar lëndime në sy, djegie, ndrydhje dhe/ose nxjerrje kyçesh/eshttrash; 5,4% kishin humbur ndjenjat; dhe 1% kishin pësuar plagë të thella, thyerje eshttrash, thyerje dhëmbësh, dhe/ose lëndime të rënda. Shumica e grave dhe vajzave që kishin pësuar lëndime nga dhuna në familje nuk kishin mundur të punonin për një periudhë prej një deri 15 ditësh si pasojë e këtyre lëndimeve (32).

Një konstatim tjetër i rëndësishëm i vërtetimit të vitit 2007 ishte se gratë e vajzat me bashkëshortë/partnerë intimë që pinin alkool, kishin pothuaj dy deri në tri herë më shumë gjasa të përjetonin dhunë në familje në martesë/marrëdhënien e tyre intime, krahasuar me gratë bashkëshortët/partnerët intimë të të cilave nuk pinin alkool. Gratë e keqtrajtuara, që kishin bashkëshortë/partnerë intimë që pinin alkool, kishin gjithashtu shumë më tepër gjasa të pësonin lëndime nga dhuna në familje (33).

Në përgjithësi, gratë e keqtrajtuara shpesh nuk janë të gatshme të flasin për dhunën në familje. Në fakt, rezultatet e vërtetimit të vitit 2007 treguan se vetëm 16% deri 28% e grave të keqtrajtuara kishin kërkuar ndihmë për dhunën në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Nga këto gra që kishin kërkuar ndihmë, pothuaj 91% e kishin kërkuar atë nga familja ose të afërm të tjerë dhe shumë pak prej tyre kishin dalë jashtë familjes për të kërkuar ndihmë për dhunën në jetën e tyre (34).

Vërtetimi i vitit 2007 tregoi se gratë e dhunuara rrallë kërkojnë ndihmë nga shërbimet për mbështetjen e viktimave ose punonjësit e ligjit për probleme të dhunës në familje. Arsytet janë të shumta, ndër të cilat: mungesa e shërbimeve për viktimat femra të dhunës në familje, sidomos në zonat rurale; familja dhe shoqëria i këshillojnë shumë gra të mos kërkojnë ndihmë nga organet e shtetit apo shërbimet në bashkësi; shumë gra ia vënë fajin vetes për viktimizimin e tyre; dhe shumë gra kanë frikë se, po të flasin hapur e të kërkojnë ndihmë, do t'ua vënë fajin atyre për viktimizimin e tyre (35).

Nuk janë vetëm bashkëshortët/partnerët e tanishëm apo të mëparshëm që kryejnë akte dhune në familje ndaj grave. Në fakt, vërtetimi i vitit 2007 tregoi se edhe anëtarë të tjerë të familjes (p.sh., prindërit, vëllezërit, motrat, njerëzit e burrit, dhe të afërm të tjerë) kryejnë akte dhune fizike ndaj grave. Në veçanti, që nga moshë 15 vjeçare, 13,8% e grave dhe vajzave ishin keqtrajtuar fizikisht nga nëna/njerka, 13,4% nga babai/njerku, dhe 9,7% nga një motër/vëlla. Çuditërisht, vetëm 2% e grave thanë se ishin keqtrajtuar fizikisht nga vjehrra apo vjehri (36).

Së fundi, fëmijët janë shpesh viktimat të harruara të dhunës në familje, megjithëse ata janë shpesh dëshmitarë të

<sup>(6)</sup> Raporti për Vërtetimin e Parë Kombëtar për Dhunën në Familje në Shqipëri u botua në vitin 2009, por meqë të dhënat u mbledhën në vitin 2007 dhe pasqyronin gjendjen e asaj kohe, në të gjithë raportin do t'i referohemi atij si Vërtetimi i vitit 2007.

akteve të dhunës në familje ose e dinë se po ndodh një gjë tillë sepse dëgjojnë britmat dhe grindjet, shohin lëndimet, apo dëmet në orëndi. Fëmijët që rriten në familje të dhunshme janë shpesh viktimë të drejtpërdrejta dhe/ose të tërthorta të dhunës në familje, dhe janë më të rrezikuar nga dhuna ndaj fëmijëve dhe lënia pas dore. Ndër gratë e intervistuar në vitin 2007, vetëm 7,9% e tyre mendonin se dhuna në shtëpinë e tyre kishte ndikim negativ tek fëmijët e tyre; por, nga ana tjetër 51% e grave nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje. Krahësuar me këtë, nga fëmijët e intervistuar, 57,7% thanë se ishin keqtrajtuar fizikisht nga një anëtar i familjes (45,1% e fëmijëve thanë se ishin lënduar fizikisht nga nëna/njerka; 29,3% nga babai/njerku, 24,4% nga motra/vëllai, 3,6% nga gjyshërit, dhe 1,4% thanë se ishin keqtrajtuar nga anëtarë të tjerë të familjes). Duke qenë se nënat/njerkat shpenzojnë më shumë kohë me rritjen e fëmijëve, nuk është për t'u çuditur që nënat/njerkat ishin ato që u identifikuan më shpesh nga fëmijët si personat që i kishin lënduar fizikisht (37).

Rezultatet e vërtetimit të vitit 2007 treguan se, ndonëse

shumica e fëmijëve në zonat urbane dhe rurale raportonin se ishin keqtrajtuar fizikisht nga një anëtar i familjes, fëmijët në zonat rurale (67,5%) kishin shumë më tepër gjasa të keqtrajtoheshin fizikisht nga një anëtar i familjes se sa fëmijët që jetonin në zonat urbane (51,2%). Po kështu, ndonëse një pjesë e konsiderueshme e djemve dhe vajzave kishin përjetuar dhunë fizike në familje, djemtë (66,7%) kishin shumë më tepër gjasa se vajzat (51,1%) të përjetonin dhunë fizike në familje. Gjithashtu, djemtë (52,0%) kishin shumë më tepër gjasa se vajzat (38,2%) të keqtrajtoheshin fizikisht nga babai/njerku; kurse vajzat (42,4%) kishin më tepër gjasa se djemtë (34,7%) të keqtrajtoheshin fizikisht nga motra/vëllai (38).

Së fundi, vërtetimi i vitit 2007 zbuloi se 53,3% e fëmijëve që ishin keqtrajtuar fizikisht thanë se kishin kërkuar ndihmë nga dikush në përpjekje për ta ndaluar keqtrajtuesin. Shumica e fëmijëve kishin kërkuar ndihmë nga një anëtar i familjes; shumë rrallë ndodhte që fëmija t'i kishte treguar dikujt jashtë familjes së ngushtë për keqtrajtimin apo dhunën (39).

## PËRSE TË BËHET NJË VROJTIM I DYTË KOMBËTAR ME BAZË POPULLATËN PËR DHUNËN NË FAMILJE NË SHQIPËRI?

Vërtetimi kombëtar me bazë popullatën për dhunën në familje i vitit 2007 ishte përpjekja e parë për të matur natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje ndaj grave dhe fëmijëve në Shqipëri. Por, përtej këtij vërtetimi, studimet kërkimore për dhunën në familje në Shqipëri vazhdojnë të jenë shumë të kufizuara. Për më tepër, nuk ka një tablo të qartë të ndryshueshmërisë së dhunës në familje në Shqipëri, përfshirë shtimin apo pakësimin e rasteve të dhunës në familje që mund të lidhen me nismat e zbatuara gjatë pesë viteve të fundit për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës në familje, kriminalizimin e akteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, ndëshkimin e autorëve të dhunës dhe mbështetjen e viktimave dhe të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Synimi i vërtetimit kombëtar me bazë popullatën për dhunën në familje i vitit 2013 ishte që të përdorte një metodologji dhe instrumente të ngjashme për mbledhjen e të dhënave me ato të vërtetimit të vitit 2007, të mbledhte të dhëna të besueshme për natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje ndaj grave dhe për sjelljet e grave të keqtrajtuara në kërkimin e ndihmës. Grupe të tilla të dhënash, të mbledhura në intervale të caktuara me kalimin e kohës, do t'i japin mundësi qeverisë së Shqipërisë, si dhe ON-ve dhe OJQ-ve, të kenë një të kuptuar më të mirë të dhunës në familje dhe të fillojnë monitorimin e tendencave të dhunës në familje ndaj grave me kalimin e kohës, si dhe të shqyrtojnë ndikimin e masave parandaluese, ndërhyrëse dhe mbrojtëse të zhvilluar kohët e fundit në natyrën dhe shtrirjen e dhunës në

familje. Të dhënat dhe konstatimet e këtij studimi mund të shërbejnë gjithashtu për të informuar reformat legjislative dhe hartimin e politikave, për t'i dhënë formë përpjekjeve parandaluese dhe ndërhyrëse, dhe do të përmirësojnë mbrojtjen dhe mbështetjen për gratë dhe fëmijët që janë viktimë dhe të mbijetuar të dhunës në familje.

Projekti kërkimor u realizua në bashkëpunim me PNUD-in dhe Institutin Kombëtar të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), së bashku me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Në nivelin kombëtar, INSTAT-i ishte organizata kryesore kërkimore. Sipas ligjit "Për statistikën zyrtare", INSTAT-i është përgjegjës për botimin e të dhënave dhe për të siguruar që instrumentet për mbledhjen e të dhënave të jenë të besueshme, të vlefshme dhe të përshtatshme nga ana teknike.<sup>(7)</sup> Po kështu, INSTAT-i është përgjegjës për përcaktimin dhe zbatimin e metodologjisë dhe të procedurave të duhura për zgjedhjen e kampionit, dhe për të siguruar përdorimin e programeve për përpunimin e të dhënave dhe të sintaksave kompjuterike të përditësuara, që analiza e të dhënave të jetë e besueshme, e paanshme, objektive, e hollësishme, dhe e interpretueshme. Që nga viti 2004, INSTAT-i gjithashtu ka botuar sistematikisht të dhëna kombëtare me bazë gjinore për palët e interesuara, për t'i ndihmuar ato në procesin e hartimit të politikave shtetërore me ndjeshmëri gjinore.

<sup>(7)</sup> Ligji nr. 9180, datë 2 mars 2004.

## REFERENCA

1. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1993). *Declaration on the Elimination of Violence Against Women* (Deklarata mbi Eliminimin e Dhunës ndaj grave) (Dok. i Rezolutës A/REX/48/104). New York, NY: United Nations, f. 2.
2. Krug E.G, L. Dahlberg, J.A. Mercy, A.B. Zwi & R. Lozano (2002). *World Report on Violence and Health* (Raporti Botëror për Dhunën dhe Shëndetin). Geneva, Switzerland: WHO.
3. Garcia-Moreno, C., H. Jensen, M. Ellsberg, L. Heise & C. Watts (2005). *WHO Multi-Country Study on Women's Health and Domestic Violence* (Studim shumë-vendësh i OBSH mbi Shëndetin e Grave dhe Dhunën në familje). Geneva, Switzerland: WHO.
4. OBSH (2013). *Global and Regional Estimates of Violence Against Women: Prevalence and Health Effects of Intimate Partner Violence and Non-Partner Sexual Violence* (Vlerësime globale dhe rajonale të dhunës ndaj grave: përhapja dhe pasojat shëndetësore të dhunës nga partnerët dhe dhunës seksuale nga jo-partnerët). Geneva, Switzerland: WHO.
5. Minnesota Advocates for Human Rights (1996). *Domestic Violence in Albania* (Dhuna në Familje në Shqipëri) Minneapolis, Minnesota: Minnesota Advocates for Human Rights.
6. Haarr, R.N. & M. Dharmo (2009). *Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtim Kombëtar me Bazë Popullatën*. Tiranë, Shqipëri: UNDP.
7. UNICEF (2000). *Mapping of Existing Information on Domestic Violence in Albania* (Organizimi i informacionit ekzistues për dhunën në familje në Shqipëri) Marrë nga interneti më 8 mars 2009, nga <http://www.unece.org/stats/gender/publications/Shqipëri/DomesticViolence.pdf>
8. Minnesota Advocates for Human Rights, 1996.
9. UNICEF, 2000.
10. Paulo Sergio Pinheiro (2006). *World Report on Violence against Children* (Raport Botëror mbi Dhunën ndaj fëmijëve) (Raport Botëror për Dhunën ndaj Fëmijëve). Geneva, Switzerland: UNICEF.
11. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje në Shqipëri, 2007-2010.
12. Hiller-Garvey, L. & M. Aguilar (2012). *Towards Equality in Albania: Actions and Achievements* (Drejt Barazisë në Shqipëri: Veprime dhe Arritje). Tiranë, Shqipëri: UN Women.
13. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje në Shqipëri, 2007-2010.
14. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje në Shqipëri, 2007-2010.
15. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje në Shqipëri, 2007-2010.
16. Hiller-Garvey & M. Aguilar, 2012.
17. Hiller-Garvey & M. Aguilar, 2012
18. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunës në Familje në Shqipëri, 2007-2010.
19. Hiller-Garvey & M. Aguilar, 2012.
20. Republika e Shqipërisë, Parlamenti (2006). *"Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"*, Ligji nr. 9669, datë 12.12.2006.
21. *"Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"*, Ligji nr. 9669, datë 12.12.2006.
22. *"Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"*, Ligji nr. 9669, datë 12.12.2006.
23. *"Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"*, Ligji nr. 9669, datë 12.12.2006.
24. *"Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"*, Ligji nr. 9669, datë 12.12.2006.
25. *"Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"*, Ligji nr. 9669, datë 12.12.2006.
26. Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave (2011). *"Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij"*
27. *"Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"*, ligji nr. 9669, datë 12.12.2006.
28. Haarr, R.N. & M Dharmo (2009). *Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtim Kombëtar me Bazë Popullatën*. Tiranë, Shqipëri: PNUD.
29. Haarr & Dharmo, 2009.
30. Haarr & Dharmo, 2009.
31. Haarr & Dharmo, 2009.
32. Haarr & Dharmo, 2009.
33. Haarr & Dharmo, 2009.
34. Haarr & Dharmo, 2009.
35. Haarr & Dharmo, 2009.
36. Haarr & Dharmo, 2009.
37. Haarr & Dharmo, 2009.
38. Haarr & Dharmo, 2009.
39. Haarr & Dharmo, 2009.



# 2

## Ndërtimi i studimit





Kryerja e vrojtmeve kërkimore për dhunën në familje paraqet vështirësi sepse dhuna në familje zakonisht ndodh pas dyerve të mbyllura dhe viktimat e saj – më së shumti gratë dhe fëmijët – shpesh ngurrojnë ose kanë frikë t'i raportojnë rastet e dhunës në familje sepse tremben nga hakmarrja e dhunuesit/dhunuesve apo reagimet negative të familjes dhe shoqërisë. Shumë shpesh gratë që flasin ose kërkojnë ndihmë për dhunën në familje fajësohen për viktimizimin e tyre (1).

Dy sfida të tjera madhore me të cilat përballen studiuesit e dhunës në familje janë hartimi i përkufizimeve të qarta operacionale të llojeve të ndryshme të dhunës në familje dhe përcaktimi i mjeteve për vlerësimin e natyrës dhe të shkallës së përhapjes të secilit prej këtyre llojeve të dhunës në familje (2).

Me gjithë vështirësitë që paraqet kryerja e vrojtmeve kërkimore mbi dhunën në familje, u ndërmor përpjekja për të kryer vrojtimin kombëtar me bazë popullatën për dhunën në familje në Shqipëri. Ky ishte vrojtimi i dytë kombëtar me bazë popullatën për dhunën në familje në Shqipëri; vrojtimi i parë kombëtar me bazë popullatën u bë në vitin 2007 (3). Vrojtimi kombëtar me bazë popullatën i vitit 2007 u hartua posaçërisht për të matur natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje ndaj grave dhe fëmijëve në Shqipëri, si dhe sjelljet e grave dhe fëmijëve që përjetojnë dhunë në familje në kërkimin e ndihmës (4). Ky vrojtım i dytë kombëtar me bazë popullatën për dhunën në familje i vitit 2013 përdori metodologji dhe instrumente të ngjashme për mbledhjen e të dhënave si ai i vitit 2007.

Vrojtimi i vitit 2013 shërben për të mbledhur të dhëna të besueshme në intervale kohore për natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje ndaj grave në Shqipëri, dhe për sjelljet e grave në kërkimin e ndihmës. Ai lejon gjithashtu të bëhen krahasime ndërmjet natyrës dhe shtrirjes së dhunës në familje në zonat urbane dhe rurale dhe rrethe, si dhe në bazë të grupmoshës, nivelit arsimor, dhe gjendjes së punësimit.

Ky vrojtım kombëtar me bazë popullatën i vitit 2013 gjithashtu shërben për të ndihmuar qeverinë që të ketë një kuptim më të mirë të dhunës në familje, për të filluar monitorime të tendencave të dhunës në familje ndaj grave me kalimin e kohës, dhe për të shqyrtuar ndikimin që kanë nismat parandaluese, ndërhyrëse dhe mbrojtëse të zhvilluara kohët e fundit, mbi natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje dhe mbi sjelljet e grave në kërkimin e ndihmës. Të dhënat dhe rezultatet e këtij studimi mund të shërbejnë gjithashtu edhe për të informuar reformat legjislativë dhe zhvillimet e politikave, do t'i japin formë përpjekjeve parandaluese dhe ndërhyrëse, dhe do të përmirësojnë mbrojtjen dhe mbështetjen për gratë dhe fëmijët që janë viktimat dhe të mbijetuar të dhunës në familje.

Njohuritë e bazuara tek të dhënat dhe të kuptuarit e këtij lloji, do t'i ndihmojnë organet qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të vendore në përpjekjet e tyre për hartimin dhe/ose reformimin e masave dhe politikave të nevojshme parandaluese, mbrojtëse dhe legjislativë lidhur me dhunën në familje dhe mbështetjen e viktimave.

## PËRKUFIZIME

Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave e përkufizon dhunën në familje si një lloj dhune ndaj grave që është "çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell ose mund të sjellë si pasojë dëmtimin ose vuajtjen fizike, seksuale apo psikologjike të gruas, përfshi edhe kërcënimet për kryerjen e veprave të tilla,

shtrëngimin ose privimin arbitrar të lirive, që ndodhin si në jetën publike ashtu dhe në jetën private" (5). Studimi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi Dhunën ndaj Fëmijëve gjithashtu tregoi se dhuna në familje është një problem me përmasa globale që ndikon negativisht dhe përfshin edhe fëmijët nën 18 vjeç (6).

### Kutia 2.1. Llojet e dhunës në familje

**Dhuna psikologjike** – përfshin një gamë sjelljesh që kanë për qëllim të kritikojnë dhe poshtërojnë, të mbajnë nën kontroll dhe izolojnë, të trembin dhe shkaktojnë frikë, dhe të sulmojnë karakterin e një gruaje dhe të shkatërrojnë ndjenjën e saj të vetë-vlerësimit, vetë-besimit, dhe sigurisë. Vrojtimi u hartua në mënyrë të tillë që të matë katër lloje të ndryshme të dhunës psikologjike:

- Dhuna verbale – kur gruaja kritikohet, fyhet, poshtërohet dhe/ose asaj i flitet në një mënyrë që sulmon karakterin e saj dhe i trondit ndjenjën e vetë-vlerësimit dhe vetë-besimit.
- Kërcënim psikologjik – kur gruaja kërcënohet dhe tek ajo shkaktohet ndjenja e frikës nëpërmjet kërcënimeve për ta lënduar fizikisht atë dhe/ose persona të tjerë të afërt me të, dhe/ose për të shkatërruar diçka të rëndësishme për të duke i tronditur kështu ndjenjën e sigurisë.
- Sjellje kontrolluese – kur gruaja shpërfillet, mbahet nën kontroll dhe izohet, dhe të qenit xheloz dhe akuzimi i gruas se nuk është besnike, për t'ia tronditur ndjenjën e vetë-vlerësimit dhe vetë-besimit.
- Dhunë ekonomike – mbajtja nën kontroll e parave të shtëpisë, përfshirë edhe pagën e gruas në ato raste kur ajo është e punësuar jashtë shtëpisë.

**Dhuna fizike** – është përdorimi i forcës fizike kundër dikujt në një mënyrë që lëndon, dëmton, ose e rrezikon atë person. Dhuna fizike përfshin një gamë të gjerë sjelljesh si gërvishtjet, shtyrjet, hedhjet, kapjet me forcë, kafshimet, vënien e duarve në fytyrë, pickimet, shpimet, shkuljet e flokëve, përdredhjet e krahut, shuplakat, shtrëngimin me forcë, goditjet, rrahjet, goditjet me shkelma, djegiet, goditjet me thikë, shtrëngimi i fytyrës/mbytytjet. Dhuna fizike mund të përfshijë edhe përdorimin e madhësisë trupore dhe të forcës, mjeteve të kufizimit të lirisë dhe/ose armëve nga ana e një personi (p.sh., armë zjarri, thikë apo ndonjë objekt tjetër) për të fituar dhe mbajtur kontrollin mbi një person tjetër. Ky vrojtim u hartua për të matur katër lloje të ndryshme të dhunës fizike që mbështeten tek shkalla e intensitetit të dhunës dhe mundësia e shkakut të lëndimeve fizike.

- Dhuna fizike e moderuar – përfshin një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme fizike: goditjet me shkelma, hedhjet tutje, shtyrjet, tërheqjet zvarrë, goditjet me shuplakë dhe/ose shkuljet e flokëve.
- Dhuna fizike e rëndë – përfshin një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme fizike: goditjet, rrahjet, djegiet me qëllim, marrjet e frymës ose mbytytjet, dhe/ose kërcënimet me armë ose përdorimi i një arme kundër personit.
- Dhuna fizike me armë – përfshin kërcënimet dhe/ose goditjet me armë ose me ndonjë objekt tjetër që mund të shkaktojë lëndime fizike.
- Dhuna fizike me lëndime rënduese – përfshin dhunën fizike që i shkakton lëndim fizik një personi tjetër.

**Dhuna seksuale** – përfshin detyrimin, shtrëngimin ose tentativën për të shtrënguar një person për të bërë kontakt ose sjellje seksuale pa pëlqimin e tij. Dhuna seksuale përfshin, por nuk kufizohet me përdhunimin bashkëshortor, sulmet në pjesët seksuale të trupit, detyrimin për të bërë seks pas ushtrimit të dhunës fizike ose trajtimi në mënyrë seksualisht poshtëruese. Dhuna seksuale kryhet nga bashkëshortët dhe/ose partnerët intimë dhe nga anëtarët e familjes brenda kontekstit të martesës, të marrëdhënieve dashurore dhe familjes.

Për qëllimet e këtij studimi, dhuna në familje i referohet “një modeli sjelljeje abuzive në çfarëdo marrëdhënieje, e ushtruar nga një partner intim ose anëtar i familjes për të fituar dhe mbajtur pushtet dhe kontroll mbi një partner intim ose anëtar tjetër të familjes.” Dhuna në familje përfshin dhunën psikologjike, fizike dhe seksuale që synon të poshtërojë, manipulojë, kërcënojë, izolojë, frikësojë, terrorizojë, kanosë, dhe lëndojë apo dëmtojë partner intim

ose një person tjetër në familje (7).

Studiues anëmbanë botës kanë përdorur kritere të ndryshme për ta përkufizuar dhunën në familje; megjithatë, një metodë e përdorur rëndom ka qenë klasifikimi i dhunës sipas llojit të aktit. Kutia 2.1 identifikon dhe përkufizon secilin prej llojeve të dhunës në familje që është shqyrtuar në këtë studim.

## MATJA E DHUNËS NË FAMILJE

Vrojtimi kombëtar u krye për të matur natyrën dhe përhapjen e tre llojeve të ndryshme të dhunës në familje të përkufizuara në kutinë 2.1.

Përkufizimet për secilin nga llojet e dhunës në familje u operacionalizuan në vërtetim nëpërmjet përdorimit të një vargu pyetjesh të lidhura në mënyrë specifike me sjelljet në secilin lloj dhune. Studimi nuk synonte të maste një listë

shteruese aktesh të dhunës; në vend të kësaj ai bën një numër pyetjesh për akte të veçanta që janë të zakonshme në martesat dhe familjet e dhunshme. Aktet e përdorura për të përkufizuar secilin prej tre llojeve të ndryshme të dhunës në familje ndaj grave – dhunës psikologjike, dhunës fizike, dhe dhunës seksuale – që janë matur në këtë studim, janë përmbledhur tek Kutia 2.2.

## ZHVILLIMI I VROJTIMIT

Në vitin 2007, INSTAT-i fillimisht hartoi Vrojtimin Kombëtar për Dhunën në Familje (VKDhF) pas shqyrtimit të gjerë të literaturës ndërkombëtare për dhunën në familje dhe shqyrtimit të instrumenteve ekzistuese të vrojtimit të përdorura në Shtetet e Bashkuara, Europë dhe Afrikë.<sup>(8)</sup> Përveç kësaj, INSTAT-i shqyrtoi edhe të dhënat e botuara nga Ministria e Brendshme për vitet 2004-2007, si dhe të dhënat dhe informacionet për dhunën në familje të botuara nga OJQ-të anëtare të Rrjetit Kundër Dhunës me Bazë Gjimore dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore.<sup>(9)</sup> Më tej, INSTAT-i studioi edhe botimin e vitit 1996 të Minnesota Advocates for Human Rights me titull *Domestic Violence in Albania* (Dhuna në familje në Shqipëri). VKDhF i vitit 2007 përmbante 10 module të veçanta, ndër të cilët edhe dy module që synonin të mblidhnin të dhëna për praninë dhe përdorimin e armëve në shtëpi dhe dy module që synonin të mblidhnin të dhëna nga fëmijët për përvojat e

tyre me dhunën në familje. Vrojtimi gjithashtu u fokusua tek intervistimi i një gruaje apo vajze, të moshës nga 15 deri 49 vjeç në çdo familje, në lidhje me përvojat e tyre me dhunën në familje.

Në vitin 2013, INSTAT-i rishikoi VKDhF-në e vitit 2007 me ndihmën teknike të konsulentës ndërkombëtare të PNUD-it, dhe u bëri përmirësime pyetjeve të vrojtimit dhe formulimeve, për të mundësuar një matje më të mirë të përvojave të grave me dhunën në familje, në marrëdhëniet bashkëshortore dhe ato intime. Përveç kësaj, u hoqën edhe katër modulet që synonin mbledhjen e të dhënave për praninë dhe përdorimin e armëve në familje dhe për përvojat e fëmijëve me dhunën në familje. Gjithashtu, një ndryshim tjetër ishte se VKDhF i vitit 2013 u fokusua tek intervistimi i një gruaje ose vajze për familje, të moshës nga 18 deri 55 vjeç, për përvojat e tyre me dhunën në familje.

## STRUKTURA E VROJTIMIT

VKDhF i vitit 2013 përbëhej nga pesë module të veçanta:

- Moduli 1: Moduli i Informacionit (MODHI);
- Moduli 2: Moduli i Strukturës Familjare (MODHL);
- Moduli 3: Moduli i Karakteristikave Social-Ekonomike (MODSE);
- Moduli 4: Moduli i Martesës (MODMA)
- Moduli 5: Moduli i Dhunës në Familje Ndaj Grave (MODDV)

Moduli 1 përbëhej nga një seri me nëntë pyetje me përgjigje me zgjedhje, përfshirë informacionet për personin intervistues dhe të intervistuar (data, rezultatet e intervistës, kodet e intervistimit për gratë dhe fëmijët, dhe numri total i anëtarëve të familjes).

Moduli 2 përbëhej nga një varg pyetjesh me përgjigje me zgjedhje që i mundësonin intervistuesit të regjistronin të gjithë anëtarët e familjes që banonin në atë shtëpi, si dhe marrëdhënien e secilit prej tyre me kryefamiljarin, seksin, moshën, vitin e lindjes, gjendjen civile, fenë, nivelin arsimor dhe gjendjen e punësimit.

Moduli 3 përbëhej nga një varg pyetjesh me përgjigje me zgjedhje që i mundësonin intervistuesit të mbante shënim kushtet e jetesës në shtëpi, përfshirë edhe pronësinë mbi shtëpinë, numrin e dhomave në shtëpi, prania e llojeve të ndryshme të pajisjeve elektroshtëpiake, burimi kryesor i ujit të pijshëm, dhe furnizimi me elektricitet.

Moduli 4 përbëhej nga një varg me 18 pyetje me përgjigje me zgjedhje mbi martesën dhe sjelljet seksuale, për t'u plotësuar nga një grua me moshë 18-55 vjeç për secilën familje. Pyetjet u hartuan në mënyrë të tillë që të matnin: historinë e martesës apo të bashkëjetesës së gruas me burrin; moshën e bashkëshortit; viti dhe moshën kur ka filluar të jetojë me burrin apo partnerin e parë intim; marrëdhëniet seksuale; përdorimi i mjeteve kontraceptive; refuzimi i përdorimit të mjeteve kontraceptive nga

<sup>(8)</sup> Burimi kryesor për këtë ishin dokumentet dhe pyetësorët e "Studimit demografik dhe shëndetësor në Shqipëri", në veçanti moduli për dhunën në familje.

<sup>(9)</sup> Rrjeti kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Dhunës në Familje u krijua në vitin 1998 dhe përfshin organizatat Refleksione, Qendrën Këshillimore për Gra dhe Vajza, Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare, Qendrën Aleanca gjimore për Zhvillim dhe Strehën për gra e vajza.

## Kutia 2.2. Llojet e dhunës në familje ndaj grave nga bashkëshorti/partneri

**Dhuna psikologjike** (16 zëra të përshkallëzuar, alfa = 0,879)

- ◆ Dhunë verbale (3 zëra të listuar, alfa = 0,694)
  - Ju bërtet dhe ju fyen
  - Thotë ose bën dika për t'ju poshtëruar para të tjerëve
  - Ju flet në një mënyrë që ju bën të ndiheni keq ose e pavlerë
- ◆ Kërcënime psikologjike (3 zëra të përshkallëzuar, alfa = 0,713)
  - Kërcënon t'ju lëndojë ju ose dikë të afërt me ju
  - Bën kërcënime se do t'ju lëndojë fizikisht
  - Shkatërron/ka shkatërruar diçka që ishte e rëndësishme për ju
- ◆ Sjellje kontrolluese (9 zëra të përshkallëzuar, alfa = 0,783)
  - Bashkëshorti im është (ishte) xheloz ose inatosej po të flisja me burra të tjerë
  - Bashkëshorti im më akuzon se e tradhetoj
  - Bashkëshorti im nuk më le të takohem me shoqet e mia
  - Bashkëshorti im më kufizon kontaktet me familjen time
  - Bashkëshorti im ngul/ngulte këmbë ta dijë se ku isha në çdo minutë
  - Bashkëshorti im ka/kishte dyshime se unë nuk isha besnike
  - Më shpërfillte/shpërfill
  - Merr/merrte vendime që duhet t'i kisha marrë vetë
  - Thoshte gjëra si, "Nëse s'je e imja, s'ke për të qenë e askujt tjetër"
- ◆ Dhuna ekonomike (1 zë i përshkallëzuar)
  - Bashkëshorti im nuk më jep para

**Dhuna fizike** (12 zëra të përshkallëzuar, alfa = 0,849)

- ◆ Dhunë fizike e moderuar (5 zëra të përshkallëzuar, alfa = 0,718)
  - Ju hedh tutje ose shtyn
  - Ju shkul flokët
  - Ju gjuan me shkelma
  - Ju tërheq zvarrë
  - Ju ka gjuajtur me shuplakë
- ◆ Dhunë fizike e rëndë (5 zëra të përshkallëzuar, alfa = 0,749)
  - Ju rreh
  - Është përpjekur t'ju djegë me qëllim
  - Donte t'ju mbyste/merrte frymën
  - Ju përplasi pas diçkaje
  - U përpoq t'ju lëndojë duke ju mbytur ose marrë frymën
  - Ju ka kërcënuar me thikë ose armë tjetër
  - Ju ka goditur me ndonjë objekt ose diçka tjetër që mund t'ju lëndojë
- ◆ Dhuna fizike me armë (2 zëra të përshkallëzuar, alfa = 0,639)
  - Ju ka kërcënuar me thikë ose me armë tjetër
  - Ju ka goditur me ndonjë objekt ose diçka tjetër që mund t'ju lëndojë
- ◆ Dhuna fizike me lëndime të rënduara (2 zëra të listuar, alfa = 0,808)
  - Keni përjetuar dhunë në familje gjatë jetës
  - Keni përjetuar ndonjëherë lëndime të shkaktuara nga dhuna në familje

**Dhuna seksuale** (2 zëra të përshkallëzuar, alfa = 0,728)

- ◆ Ju detyron të kryeni marrëdhënie seksuale kur nuk dëshironi
- ◆ Ju detyron të kryeni akte seksuale poshtëruese që nuk dëshironit t'i bënit

bashkëshorti/partneri intim; detyrimi nga bashkëshorti/partneri intim për të kryer marrëdhënie seksuale; rreziku i HIV apo i sëmundjeve seksualisht të transmetueshme; dhe analiza mjekësore apo përvoja të mëparshme me sëmundjet seksualisht të transmetueshme.

Moduli 5 përbëhej nga 35 pyetje me përgjigje me zgjedhje për përvojat e vetë-raportuara të grave për dhunën në familje, për t'u plotësuar nga një grua e familjes me moshë 18-55 vjeç. Pyetjet kishin për qëllim që të matnin përvojat e grave me dhunën psikologjike, fizike dhe seksuale nga bashkëshortët/partnerët e tyre intimë; kur filloi dhuna për herë të parë; lëndimet e pësura si rezultat i dhunës, dhuna fizike gjatë shtatzënisë, përdorimi i alkoolit nga burri; dhunues të tjerë në familje; sjelljet për kërkimin e ndihmës;

dhe perceptimi për ndikimin e dhunës tek fëmija/fëmijët e tyre.

Moduli 5 gjithashtu u fokusua tek përftimi i përllogaritjeve të besueshme për përvojat e grave me llojet e ndryshme të dhunës në familje, përfshirë edhe përvojat gjatë jetës së tyre që nga moshë 15 vjeçare, si dhe përvojat aktuale (gjatë dymbëdhjetë muajve para intervistës) me dhunën në familje, dhe shpeshësia e kësaj dhune.

Mesatarisht intervistuesve i duheshin 40 minuta për të kryer vrojtimin me personat e intervistuar në takime ballë për ballë. Vrojtimi u hartua në programin CPro-software dhe pastaj u ngarkua më tej në mini-kompjuterët portativë që u përdorën në terren për administrimin e vroitimit dhe regjistrimin e të dhënave.

## SIGURIMI I INFORMACIONIT MAKSIMAL

Që në fillim të vroitimit, u pranua se dhuna në familje është një çështje tejet e ndjeshme dhe se kishte shumë gjasa që gratë të ngurronin të flisnin hapur për përvojat e tyre me dhunën në familje. Për këto arsye, u bënë përpjekje për të hartuar një vrojtim i cili siguronte që gratë të ndiheshin të qeta dhe të afta të tregonin për çdo përvojë dhune në martesën/marrëdhënien e tyre intime. Veçanërisht, vrojtimi u strukturua në mënyrë të tillë që pjesët e fillimit të mbledhjes informacion për çështje më pak të ndjeshme (demografia dhe kushtet e banimit), ndërsa çështjet më

të ndjeshme (p.sh. vetë-raportimi i dhunës së ushtruar në familje nga bashkëshortët ose anëtarët e tjerë të familjes) të shqyrtoheshin më vonë në vrojtim. Përveç kësaj, kujdes iu kushtua edhe formulimit të udhëzimeve të vroitimit.

Të anketuarat u paralajmëruan për fokusin e vroitimit dhe natyrën e ndjeshme të pyetjeve të përfshira në të; por anëtarëve të tjerë të familjes nuk iu bë i ditur fokusi i vroitimit. Po kështu, personat e anketuar u informuan se përgjigjet e tyre do të mbeteshin konfidenciale.

## NDËRTIMI I KAMPIONIT

Studimi u përbë nga një vrojtim i njëkohshëm familjar me bazë popullatën, që u krye në nivel kombëtar në secilën prej 12 prefekturave në Shqipëri. Përzgjedhja e grave që do të bënin pjesë në kampion u bë sipas një modeli zgjedhjeje me stratifikim. Njësitë Parësore të Kampionimit (NjPK) të përzgjedhura në fazën e parë ishin zonat e numërimit (ZN), që janë zona të vogla operationale të përcaktuara në hartat për numërimet në kuadrin e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011. Në këtë fazë u përdor softueri SAS për përzgjedhjen sistematike të kampionit të ZN-ve me probabilitet në përpjesëtim madhësinë brenda secilës prefekturë. Faza e dytë ishte përzgjedhja e listës së familjeve nga ZN-të e përzgjedhura. Lista e familjeve të numëruara në Regjistrimin e Popullsisë të vitit 2011 për secilin kampion ZN-je u përdor si kuadër kampionues për përzgjedhjen e një kampioni prej 8 familjesh në secilin kampion ZN-je, nëpërmjet kampionimit të rastësishëm sistematik me probabilitet të barabartë.

Faza e tretë ishte përzgjedhja e grave, nga një për secilën familje që u zgjodh në fazën e dytë. Mbi bazën e kriterëve të para-përcaktuara, një grua quhej se i plotësonte kushtet për t'u anketuar nëse ishte me moshë nga 18 deri 55 vjeç dhe jetonte rregullisht në atë familje. Në ato familje ku

kishte vetëm një grua të pranishme, ajo u zgjodh për t'u intervistuar (për Modulin 2). Në familjet me më shumë se një grua të pranishme, u përdor softueri SAS për përzgjedhjen e rastësishme sistematike me probabilitet të barabartë.

Synimi ishte që të gjenerohej një kampion familjesh që do të lejonte bërjen e përllogaritjeve statistikisht të besueshme të natyrës dhe shtrirjes së dhunës në familje ndaj grave në nivel vendi dhe do të mundësonte krahasimet midis zonave urbane dhe rurale. Është e rëndësishme të vihet në dukje se INSTAT-i e pranon që madhësia e kampionit të një vroitimi të caktuar përcaktohet nga saktësia që kërkohet në përllogaritjet në nivel kombëtar, dhe gjithashtu nga ndikimet që lidhen me koston, burimet dhe çështje operationale. Madhësia e kampionit ndikohet gjithashtu edhe nga çështje logjistike që lidhen me organizimin dhe madhësinë e ekipeve, dhe ngarkesa e punës për administrimin e vroitimit dhe mbledhjen e të dhënave. Duke i marrë parasysh të gjithë këta faktorë, llogaritjet sugjeruan se një madhësi kampioni prej 3 600 familjesh ofronte kapacitet të mjaftueshëm për t'i përmbushur objektivat e studimit.



## INTERVISTUESIT

se të fillonte administrimi i vrojtit, INSTAT-i përzgjedhi dhe trajnoi me kujdes një ekip kërkimor me 81 anëtarë–20 mbikëqyrës rajonalë dhe 61 intervistues – për të kryer vrojtimin.<sup>(10)</sup> Secili anëtar i ekipit kërkimor u trajnuar për një periudhë katër-ditore, në maj të vitit 2013. Në trajnim u trajtuan çështje si, qëllimi dhe përmbajtja e vrojtit, përkufizimet kyçe, çështjet e dhunës në familje ndaj grave, procedurat e zgjedhjes së kampionit dhe ato të vrojtit, mënyra e zhvillimit të vrojtit në kushtet e intervistës ballë për ballë, si të ndihmoheshin personat e intervistuar për t'i kujtuar ngjarjet e dhunshme,<sup>(11)</sup> konsiderata etike dhe të sigurisë në intervistimin e grave dhe fëmijëve të dhunuar, si dhe përdorimi i programit CPro dhe i mini-kompjuterëve portativë. Po kështu, anëtarët e ekipit kërkimor patën mbështetje të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës së kryerjes së studimit.

## ADMINISTRIMI I VROJTIMIT NË TERREN

Vrojtimi në terren filloi javën e fundit të majit dhe mbaroi javën e parë të korrikut 2013. Vrojtmet u zhvilluan si

Duke qenë se siguria e të intervistuarve dhe ekipit kërkimor kishte rëndësi të jashtëzakonshme, në hartimin e kampionit të vrojtit, procedurat e administrimit dhe trajnimit të intervistuesve, u përfshinë konsideratat etike të përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (7). Intervistuesit morën udhëzime për rëndësinë e garantimit të konfidencialitetit dhe të respektimit të privatësisë së personave të intervistuar, me qëllim që të mbrohej siguria e të anketuarve dhe të përmirësohej cilësia e të dhënave. Për të mbrojtur konfidencialitetin, intervistuesit u trajnuan t'i intervistonin vetëm personat pjesëmarrës të përzgjedhur nga metodat e sipërpërmendura.

Koordinatori i projektit nga INSTAT-i dhe ekipi i mbikëqyrësve monitoruan rregullisht punën e intervistuesve dhe cilësinë e të dhënave që po mblidheshin.

## PËRPUNIMI DHE ANALIZIMI I TË DHËNAVE

Procedurat për mbajtjen shënimi dhe përpunimin e të dhënave ishin rigorozë dhe u mbikëqyrën me kujdes nga INSTAT-i. U përdorën metoda bashkëkohore kodimi, dhe programimi për hedhjen e të dhënave të cilat u hartuan në softuerin CPro. Kjo bëri të mundur që të sigurohej një administrim dhe regjistrim i duhur i vrojtit në terren. Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave, ato u hodhën të dhënat në mini-kompjuterë portativë duke përdorur softuerin CPro.

Përpunimi dhe pastrimi i të dhënave filloi në korrik dhe përfundoi në gusht të vitit 2013. Versioni i pastër i bazës së të dhënave u përdor për të bërë analizën e të dhënave me programin SPSS. Është e rëndësishme të theksohet se INSTAT-i ka standarde profesionale për përpunimin dhe interpretimin e të dhënave të cilat u zbatuan edhe në këtë vërtetim kombëtar për dhunën në familje.

## REFERENCA

1. Garcia-Moreno, C., H. Jensen, M. Ellsberg, L. Heise & C. Watts (2005). *WHO Multi-Country Study on Women's Health and Domestic Violence* (Studim shumë-vendësh i OBSH mbi Shëndetin e Grave dhe Dhunën në familje), Switzerland: Organizata Botërore e Shëndetësisë.
2. Garcia-Moreno et al., 2005.
3. Haarr, R.N. & Dharmo (2009). Dhuna në Familje në

Shqipëri: Vërtetim Kombëtar me Bazë Popullatën. Tiranë, Shqipëri: UNDP.

4. Haarr & Dharmo, 2009.
5. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1993). *Declaration on the Elimination of Violence Against Women* (Deklarata mbi Eliminimin e Dhunës ndaj grave) (Dokumenti i Rezolutës A/REX/48/104). New York, NY: United Nations,.
6. Pinheiro (2006). *World Report on Violence against Children* (Raport Botëror mbi Dhunën ndaj fëmijëve). Geneva, Switzerland: United Nations Publishing Services.
7. Garcia-Moreno et al., 2005.

<sup>(8)</sup> INSTAT-i kishte një ekip të kualifikuar për mbledhjen e të dhënave dhe për kryerjen e intervistave, ndaj edhe pjesa më e madhe e intervistuesve të përdorur në këtë studim ishin të punësuar nga INSTAT-i.

<sup>(9)</sup> Intervistuesit u trajnuan që t'i ndihmonin të intervistuarit të kujtonin me saktësi ngjarjet e dhunshme duke i vendosur ato në korniza kohore afër ngjarjeve të tjera të mëdha (p.sh. lindja e një fëmije, ngjarje të rëndësishme apo festa familjare, ose marrja e një shtëpie të re).

# 3

## Demografia e kampionit





Ky kapitull përmban të dhëna demografike për familjet dhe gratë e moshës nga 18 deri 55 vjeç që u përzgjedhën për të bërë këtë vërtetim.

## KAMPIONI

Kampioni përfundimtar kishte 3 589 familje dhe gra të moshës nga 18 deri 55 vjeç. Siç u shpjegua në Kapitullin 2, të dhënat u peshuan nga INSTAT-i mbi bazën e numrit të grave nga 18 deri 55 vjeç të popullsisë totale; ndaj

madhësia e kampionit (N), frekuencat (n), dhe përqindjet (%) e raportuara në të gjitha tabelat e këtij raporti mbështeten në të dhëna të peshuara.

## DEMOGRAFIA E FAMILJEVE

Tabela 3.1 paraqet të dhënat e familjeve. Familjet u anketuan në secilën prej 12 prefekturave të Shqipërisë. Nga familjet e anketuara, 54,7% ishin urbane dhe 45,3% rurale. Këto raporte përputhen me të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011, sipas të cilit 53,5% e popullsisë jeton në zona urbane dhe 46,5% në zona rurale.

Tabela 3.1 tregon gjithashtu se shumica e familjeve të intervistuar ishin myslimane (78,4%); vetëm 9,7% ishin katolike dhe 8,2% ortodokse.

**Tabela 3.1.** Demografia e familjeve

|                   | N=739,758* |      |
|-------------------|------------|------|
|                   | n          | %    |
| <b>Prefektura</b> |            |      |
| Berat             | 36 531     | 4,9  |
| Dibër             | 34 306     | 4,6  |
| Durrës            | 71 245     | 9,6  |
| Elbasan           | 77 279     | 10,4 |
| Fier              | 79 598     | 10,8 |
| Gjirokastrë       | 17 915     | 2,4  |
| Korçë             | 56 361     | 7,6  |
| Kukës             | 21 773     | 2,9  |
| Lezhë             | 35 389     | 4,8  |
| Shkodër           | 56 318     | 7,6  |
| Tiranë            | 207 252    | 28,0 |
| Vlorë             | 45 791     | 6,2  |
| <b>Vendbanimi</b> |            |      |
| Urban             | 40 986     | 54,7 |
| Rural             | 334 772    | 45,3 |
| <b>Feja</b>       |            |      |
| Myslimanë         | 580 088    | 78,4 |
| Ortodokse         | 60 626     | 8,2  |
| Katolike          | 71 814     | 9,7  |
| Bektashi          | 10 159     | 1,4  |
| Tjetër            | 1 633      | 0,2  |
| Pa besim fetar    | 15 438     | 2,1  |

\* Të dhëna të ponderuara për një kampion të përbërë nga 3 589 familje

## DEMOGRAFIA E GRAVE

Tabela 3.2 tregon karakteristikat demografike të kampionit të plotë të 3 589 grave të anketuara (të dhënat në tabela janë të dhëna të peshuara). Gratë që u anketuan ishin me moshë nga 18 to 55 vjeç dhe moshë mesatare 39.6 vjeç. Gratë u pyetën çfarë moshe kishin në vjeç dhe pastaj u krijuan grupmoshat gjatë analizës. Tabela 3.2 tregon se gratë e grupit 18-24 vjeç ishin më pak të përfaqësuara (8,4%), në krahasim me gratë e grupmoshave 25-34 vjeç (23,8%), 35-44 vjeç (31,3%), dhe 45-55 vjeç (36,5%).


Shumica e grave në kampion ishin aktualisht të martuara/bashkëjetonin (86,0%); ndërsa vetëm 2,4% e grave ishin të veja dhe 1,8% të divorcuara/ndara. Përveç kësaj, vetëm 9,9% e grave të anketuara ishin beqare, nga të cilat 0,1% bashkëjetonin me të dashurin. Figura 3.1 tregon se gratë e grupmoshës 18-24 vjeç (53,8%) kishin shumë më tepër gjasa të ishin beqare, krahasuar me ato të grupmoshës 25-34 vjeç (17,0%), 35-44 vjeç (3,0%), dhe 45-55 vjeç (1,1%; shih Shtojcën, Tabela 1).

**Tabela 3.2.** Demografia e grave

|                               | N=739 758* |      |
|-------------------------------|------------|------|
|                               | n          | %    |
| <b>Mosha</b>                  |            |      |
| 18-24 vjeç                    | 61 771     | 8.4  |
| 25-34 vjeç                    | 176 123    | 23.8 |
| 35-44 vjeç                    | 231 538    | 31.3 |
| 45-55 vjeç                    | 270 326    | 36.5 |
| <b>Gjendja civile</b>         |            |      |
| E martuar/bashkëjeton         | 636 003    | 86.0 |
| E ve                          | 17 401     | 2.4  |
| E shkurorëzuar/ndarë          | 13 337     | 1.8  |
| Beqare                        | 73 017     | 9.9  |
| <b>Niveli arsimor</b>         |            |      |
| Fillor ose më i ulët (4 vjet) | 31 677     | 4.3  |
| Tetëvjeçar (8 vjet)           | 288 949    | 39.1 |
| I mesëm/profesional           | 300 004    | 40.6 |
| Universitar/pasuniversitar    | 110 123    | 14.9 |
| <b>Gjendja e punësimit</b>    |            |      |
| Punon jashtë shtëpisë         | 321 132    | 43.4 |
| Me leje lindjeje              | 6 168      | 0.8  |
| Nuk punon jashtë shtëpisë     | 412 458    | 55.8 |

\* Të dhëna të ponderuara për një kampion me 3 589 gra

**Figura 3.1.** Gjendja civile e grave sipas grupmoshës




\* Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

Tabela 3.2 tregon gjithashtu se shumica e grave kishte arsim tetëvjeçar (39,1%) ose arsim të mesëm/profesional (40,6%); vetëm 14,9% e grave ishin me arsim të lartë ose pasuniversitar. Përveç kësaj, vetëm 4,3% e grave kishin arsim fillor ose më të ulët. Figura 3.2 tregon se gratë në zonat urbane kishin shumë më tepër gjasa të kishin arsim të mesëm/profesional (46,9%) ose universitar/pasuniversitar (23,2%), krahasuar me gratë në zonat rurale (përkatësisht

33,9% dhe 5,2%). Krahasimisht, gratë në zonat rurale kishin shumë më tepër gjasa të kishin vetëm arsim tetëvjeçar (55,0%), krahasuar me gratë në zonat urbane (26,9%). Gratë në zonat rurale gjithashtu kishin pak më shumë gjasa të kishin kryer vetëm arsimin fillor ose më pak (5,9%), krahasuar me gratë në zonat urbane (3,0%; shih Shtojcën, Tabela 2).


**Figura 3.2.** Niveli arsimor në zonat urbane kundrejt atyre rurale



Së fundi, Tabela 3.2 tregon se vetëm 43,4% e grave kishin punuar jashtë shtëpisë për të paktën 20 orë në javë në muajin para intervistës, kurse 55,8% e grave nuk kishin punuar jashtë shtëpisë gjatë muajit para intervistës. Më pak se 1% e grave ishin me leje lindjeje në kohën e intervistës. Figura 3.3 tregon se gratë në zonat urbane (51,0%) punonin shumë më tepër jashtë shtëpisë se sa gratë në zonat rurale (34,3%); ndërsa gratë në zonat rurale (65,0%) kishin shumë më tepër gjasa të mos punonin jashtë shtëpisë, krahasuar me gratë në zonat urbane (48,1%; shih Shtojcën, Tabela 2).

Nga gratë që raportuan se nuk kishin punuar jashtë shtëpisë në muajin përpara intervistës, 32,6% thanë se nuk kishin mundur të gjenin punë dhe 21,7% nuk kishin mundur të gjenin dikë që të kujdesej për fëmijët (shih Tabelën 3.3). Përveç kësaj, 7,1% e tyre raportuan se nuk ishin në gjendje të punonin jashtë shtëpisë sepse nuk ishin të kualifikuara për punë, 4,7% po ndiqnin shkollën, 4,0% kishin sëmundje kronike ose aftësi të kufizuara, dhe 1,4% thanë se nuk i lejonin burrat të punonin jashtë shtëpisë. Të paktën 21,4% e grave thanë se ishin të papuna dhe po kërkonin punë në kohën e vërtetimit.

**Figura 3.3.** Gjendja e punësimit në zonat urbane kundrejt atyre rurale



*Shënim:* Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela 3.3.** Arsyet pse gratë nuk punojnë jashtë shtëpisë

|                                              | N=412 458 |      |
|----------------------------------------------|-----------|------|
|                                              | n         | %    |
| Nuk gjej dot punë                            | 134 454   | 32.6 |
| Nuk gjej dot dikë që të kujdeset për fëmijët | 89 424    | 21.7 |
| Jam duke kërkuar punë                        | 88 403    | 21.4 |
| Nuk kam kualifikimet e duhura për punë       | 29 356    | 7.1  |
| Po ndjek shkollën                            | 19 536    | 4.7  |
| Sëmundje kronike/aftësi të kufizuara         | 16 642    | 4.0  |
| Nuk dua/nuk kam nevojë të punoj              | 7 786     | 1.9  |
| Nuk më lejon burri të punoj                  | 5 679     | 1.4  |
| Jam pushuar nga puna                         | 2 861     | 0.7  |
| Nuk më lejojnë prindërit të punoj            | 1 211     | 0.3  |
| Jam kthyer nga puna si emigrante             | 1 066     | 0.3  |
| Të tjera                                     | 16 040    | 3.9  |

Shënim: Frekuencat dhe përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.



# 4

## **Dhuna në familje ndaj grave**





Dhuna në familje shpesh ndodh pas dyerve të mbyllura dhe mbetet pa u raportuar. Ky kapitull fokusohet në zbulimin e llojeve të shumta të dhunës dhe keqtrajtimit që përjetojnë gratë në martesë dhe marrëdhënie intime; duke i dhënë kështu zë grave të dhunuara që zakonisht vuajnë në heshtje (1).

Gratë mund të pësojnë dhunë në familje pavarësisht nga mosha, niveli arsimor, gjendja e punësimit, feja, dhe vendi i banimit (p.sh., urbane dhe rurale). Dhuna në familje mund të ndodhë tek çiftet e martuara apo partnerët intimë që bashkëjetojnë ose jo (2, 3, 4). Dhuna në familje ndikon jo vetëm gratë që keqtrajtohen dhe dhunohen, por ka pasoja negative edhe tek fëmijët e tyre. Studime ndërkombëtare kanë treguar se fëmijët që rriten duke parë dhunë në familje shpesh ndikohen shumë nga ky krim dhe kanë rrezik më të madh të keqtrajtohen e të lihen pas dore në familje (5). Në veçanti, të qenit shpesh dëshmitarë të dhunës në familje, i bën fëmijët të prirën të kenë probleme të shumta shoqërore, emocionale dhe zhvillimore (6, 7, 8). Po kështu, kjo u mëson fëmijëve se dhuna është mënyrë e zakonshme jetese dhe shton rrezikun që ata të bëhen brezi

tjetër i viktimave të dhunës në familje apo i dhunuesve në shoqëri (9). Edhe të afërmit, miqtë dhe persona të tjerë të pranishëm kur ndodh dhuna në familje, mund të ndikohen negativisht.

Ky kapitull paraqet të dhëna për natyrën dhe përhapjen e dhunës në familje të përjetuar nga gratë nga 18 deri 55 vjeç në Shqipëri. Ky kapitull përmban gjithashtu edhe krahasime të përvojave të grave me dhunën në familje, sipas vendbanimit (dallimet ndërmjet zonave urbane dhe atyre rurale), grupmoshës, nivelit arsimor dhe gjendjes së punësimit. Ai shqyrton gjithashtu shkallën e ashpërsisë së lëndimeve të pësuar nga gratë e keqtrajtuara si rezultat i dhunës në familje, dhe përvojat e grave me dhunën seksuale dhe rrezikimin nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme (SST-të), përfshirë edhe HIV/SIDA-n. Ky kapitull shqyrton gjithashtu marrëdhëniet ndërmjet përdorimit/abuzimit të alkoolit nga burri dhe përvojave të grave me dhunën në familje, dhe perceptimet e grave për ndikimin që ka dhuna tek fëmijët e tyre. Së fundi, ky kapitull shqyrton edhe sjelljet për kërkimin e ndihmës të grave të keqtrajtuara.

## DHUNA NË FAMILJE NDAJ GRAVE

Grave të moshës 18-55 vjeç, që ishin aktualisht të martuara ose kishin qenë të martuara dhe/ose aktualisht bashkëjetonin me një partner intim, iu bënë një numër pyetjesh për përvojat e tyre me dhunën në familje nga bashkëshorti/partneri i tyre aktual ose i fundit që kishin pasur. Më konkretisht, 87,4% e grave të anketuara (n = 646 879, në bazë të të dhënave të peshuara) u pyetën për përvojat e tyre me dhunën në familje. Përqindjet e raportuara në këtë kapitull mbështeten në kampionin e grave të cilave iu bënë pyetje për dhunën në familje; dhe jo në numrin e përgjithshëm të kampionit të plotë të grave.

Tabela 4.1 tregon se 59,4% e grave (më shumë se 1 në 2 gra) thanë se kishin pësuar dhunë në familje në martesë/marrëdhënie intime “gjatë jetës”, dhe 53,0% e grave (1 në 2 gra) po përjetonin dhunë në familje “aktualisht” (brenda 12 muajve para intervistës).

Zërat e listës së përshkallëzuar u përdorën për të krijuar variabla të reja për secilin prej llojeve të ndryshme të dhunës në familje, ndër të cilët dhuna psikologjike, dhuna fizike, dhe dhuna seksuale (secili prej këtyre llojeve të dhunës në familje përkufizohet në Kutinë 2.1, Kapitulli 2). Tabela 4.1 tregon përqindjen e grave që kanë përjetuar

secilën prej këtyre tre llojeve të ndryshme të dhunës në familje. Në veçanti, 58,2% e grave kanë përjetuar dhunë psikologjike në martesë/marrëdhënien e tyre intime “gjatë jetës”, dhe 52,8% e grave po përjetonin “aktualisht” dhunë psikologjike (brenda 12 muajve para intervistës). Me fjalë të tjera, më shumë se gjysma e grave ishin dhunuar ose po dhunohen psikologjikisht në martesë/marrëdhënien e tyre intime.

Tabela 4.1 tregon gjithashtu se 23,7% e grave (gati 1 në 4 gra) kanë përjetuar dhunë fizike në marrëdhëniet bashkëshortore/intime “gjatë jetës”, dhe 14,7% po përjetonin dhunë fizike “aktualisht” (brenda 12 muajve para intervistës). Për sa i përket dhunës seksuale, 7,9% e grave kanë përjetuar dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime “gjatë jetës”, dhe 5,0% e grave po përjetonin “aktualisht” dhunë seksuale (brenda 12 muajve para intervistës).

Tabela 4.1 tregon gjithashtu se 24,6% e grave (1 në 4 gra) kanë përjetuar *si* dhunë fizike *ashtu edhe* seksuale “gjatë jetës”, dhe 16,2% po përjetonin “aktualisht” *si* dhunë fizike *ashtu edhe* dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime.

**Tabela 4.1.** Përqindja e grave që përjetojnë dhunë në familje (18-55 vjeç)

|                                         | N=646,879   |      |            |      |
|-----------------------------------------|-------------|------|------------|------|
|                                         | Gjatë jetës |      | Aktualisht |      |
|                                         | n           | %    | n          | %    |
| Dhuna në familje (të gjitha llojet)     | 384 372     | 59,4 | 347 353    | 53,7 |
| Dhuna psikologjike                      | 376 555     | 58,2 | 341 748    | 52,8 |
| Dhuna fizike                            | 153 186     | 23,7 | 95 251     | 14,7 |
| Dhuna seksuale                          | 51 087      | 7,9  | 32 539     | 5,0  |
| Si dhuna fizike ashtu edhe ajo seksuale | 159 248     | 24,6 | 104 810    | 16,2 |

Shënim: Frekuencat dhe përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

## DHUNA PSIKOLOGJIKE

Tabelat 4.1 dhe 4.2 tregojnë se 58,2% e grave kanë përjetuar dhunë psikologjike në martesë/marrëdhënien e tyre intime “gjatë jetës”, dhe 52,8% e grave po përjetojnë dhunë psikologjike “aktualisht” (brenda 12 muajve para intervistës).

Dhuna psikologjike përfshin një gamë sjelljesh që synojnë të mbajnë nën kontroll, izolojnë, frikësojnë, shkaktojnë frikë, dhe të sulmojnë karakterin e gruas dhe të trondisin ndjenjën e saj të vetë-vlerësimit dhe vetë-besimit. Vrojtimi përfshinte 16 zëra të përshkallëzuar që matnin lloje të ndryshme dhune psikologjike që përjetojnë gratë zakonisht në martesë/marrëdhënie intime të dhunshme (shih Shtojcën, Tabela 3). Si pjesë e analizës, 16 zërat e përshkallëzuar u përdorën për të krijuar variabla të reja për katër lloje të ndryshme dhune psikologjike:

- Dhunë verbale – kur gruaja kritikohet, fyhet, poshtërohet dhe/ose i flitet në një mënyrë që i sulmon karakterin dhe trondit ndjenjën e vetë-vlerësimit dhe vetë-besimit.
- Kërcënim psikologjik – kur gruaja kërcënohet dhe asaj i shkaktohet ndjenja e frikës me anë të kërcënimeve për ta lënduar fizikisht atë vetë dhe/ose njerëz të tjerë të afërt të saj, dhe/ose për të shkatërruar diçka që është e rëndësishme për të duke i minuar kështu ndjenjën e sigurisë.
- Sjellje kontrolluese – kur një grua shpërfillet, mbahet nën kontroll dhe izohet nga sjelljet xhelozë dhe akuzimi i gruas se nuk është besnike, për t’ia tronditur ndjenjën e vetë-vlerësimit dhe vetë-besimit.
- Dhunë ekonomike – mbajtja nën kontroll e parave të shtëpisë, përfshirë edhe pagën e gruas, në rastet kur ajo është e punësuar jashtë shtëpisë.

(Shih Kapitullin 2 për një përshkrim më të hollësishëm të të gjitha llojeve të ndryshme të dhunës në familje dhe të strukturës së vrojtimit).

Tabela 4.2 tregon përqindjen e grave që kanë përjetuar secilin prej këtyre katër llojeve të ndryshme të dhunës psikologjike në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Lloji më i zakonshëm i dhunës psikologjike të përjetuar nga gratë ishte sjellja kontrolluese. Sjelljet kontrolluese janë një formë dhune psikologjike që përdoret nga burrat dhunues për t’i izoluar dhe mbajtur nën kontroll gratë, si dhe për t’u shtënë atyre ndjenjën e frikës dhe ankthit. Në veçanti, 51,4% e grave kishin përjetuar sjellje kontrolluese nga burrat/partnerët e tyre “gjatë jetës”, dhe 45,4% po përjetojnë sjellje kontrolluese “aktualisht” (brenda 12 muajve para intervistës). me fjalë të tjera, 1 në 2 gra kanë përjetuar sjellje kontrolluese nga bashkëshortët/partnerët.

Një përqindje e konsiderueshme e grave raportuan gjithashtu se kishin përjetuar dhunë verbale (d.m.th., fyerje, xhelozë, dhe poshtërime). Konkretisht, 38,7% e grave kanë përjetuar dhunë verbale “gjatë jetës” në martesë/marrëdhënien e tyre intime, dhe 31,5% e grave (pothuaj 1 në 3 gra) po përjetojnë dhunë verbale “aktualisht”. Me fjalë të tjera, më shumë se 1 në 3 gra kanë përjetuar dhunë verbale në martesë/marrëdhënien e tyre intime.

Tabela 4.2 tregon gjithashtu se 10,4% e grave 18 deri 55 vjeç kanë përjetuar dhunë ekonomike në martesë/marrëdhënien e tyre intime “gjatë jetës”, dhe 8,6% po përjetojnë “aktualisht” dhunë ekonomike.

Kërcënimi me lëndim është një formë tjetër dhune psikologjike që përdoret nga burrat dhunues për t’i shtënë frikë dhe ankth grave, dhe për t’i mbajtur ato nën kontroll. Tabela 4.2 tregon se 7,4% e grave kanë përjetuar kërcënime psikologjike në martesë/marrëdhënien e tyre intime “gjatë jetës”, dhe 4,3% e grave po përjetojnë kërcënime psikologjike “aktualisht”.


**Tabela 4.2.** Përqindja e grave që përjetojnë dhunë psikologjike (18-55 vjeç)

|                                       | N=646,879   |      |            |      |
|---------------------------------------|-------------|------|------------|------|
|                                       | Gjatë jetës |      | Aktualisht |      |
|                                       | n           | %    | n          | %    |
| Dhuna psikologjike (të gjitha llojet) | 376 555     | 58,2 | 341 748    | 52,8 |
| Dhuna verbale                         | 250 355     | 38,7 | 203 659    | 31,5 |
| Kërcënime psikologjike                | 47 662      | 7,4  | 27 515     | 4,3  |
| Sjellje kontrolluese                  | 332 771     | 51,4 | 293 571    | 45,4 |
| Dhuna ekonomike                       | 68 902      | 10,4 | 57 224     | 8,6  |

Shënim: Frekuencat dhe përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Është e rëndësishme të kuptohet se gratë e keqtrajtuara zakonisht nuk përjetojnë vetëm një lloj dhune psikologjike në martesë/marrëdhënien e tyre intime; shpesh ato përjetojnë forma të shumta të dhunës psikologjike. Figura 4.1 tregon përqindjen e grave që kanë përjetuar ndonjëherë gjatë jetës një ose më shumë nga 16 llojet e ndryshme që përbëjnë serinë e përshkallëzuar të dhunës psikologjike në këtë vërtetim. Ndonëse 58,2% e grave kishin përjetuar dhunë psikologjike në marrëdhëniet bashkëshortore/intime “gjatë jetës”, vetëm 15,7% e grave kishin përjetuar vetëm një nga llojet e dhunës psikologjike të matur nga vërtetimi. Shumica e grave të dhunuara psikologjikisht

kishin përjetuar më shumë se 1 nga 16 llojet e ndryshme të dhunës të matura në vërtetim. Më konkretisht, 12,3% e grave kishin përjetuar dy nga llojet e dhunës psikologjike të matura në vërtetim, 9,0% kishin përjetuar 3 nga llojet e dhunës psikologjike, 5,5% kishin përjetuar katër nga llojet, 4,1% kishin përjetuar pesë nga llojet, 3,6% kishin përjetuar gjashtë nga llojet, dhe 7,9% kishin përjetuar nga shtatë deri në gjashtëmbëdhjetë lloje të ndryshme dhune psikologjike të matura në vërtetim (shih Shtojcën, Tabela 4). Pasojat afatgjata të dhunës psikologjike me format e saj të shumëfishta janë mjaft të rënda për gratë e dhunuara.

**Figura 4.1.** Format e shumëfishta të dhunës psikologjike të përjetuara nga gratë (18-55 vjeç) gjatë jetës

Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Gratë që janë viktimat e dhunës psikologjike shpesh mendojnë se nuk kanë rrugëdalje nga marrëdhënia ku dhunohen psikologjikisht dhe se janë një “hiç” pa partnerin dhunues. Gratë e dhunuara psikologjikisht shpesh jetojnë me frikë, kanë ankthe dhe vështirësi në përqendrim, dhe

vazhdimisht mohojnë nevojat e veta dhe i ndryshojnë mendimet, ndjenjat dhe sjelljen e tyre, në përpjekje për të shmangur dhunën e mëtejshme (10). Gratë që vuajnë nga dhuna psikologjike në martesë/marrëdhënie intime, janë më të rrezikuara të kenë probleme të shëndetit

mendor (p.sh., sindromën e stresit post-traumatik, ankth, depresion, probleme me oreksin, mendime vetëvrasëse), probleme të shëndetit fizik (p.sh., irritim të zorrës së trashë, dhimbje koke, dhimbje kronike, sëmundje të zemrës dhe enëve të gjakut, tension të lartë të gjakut), përdorime substancash (alkool, duhan dhe droga të tjera), si dhe probleme shtatzënie/pas shtatzënisë (p.sh., lindje fëmije nën peshë, lindje të parakohshme, humbje e foshnjës) (11, 12). Studimet ndërkombëtare kanë treguar se pasojat e dhunës psikologjike mund të jenë po aq të dëmshme sa ato të dhunës fizike, dhe çojnë në ndjenja dyshimi dhe mosvlerësimi të vetes (13, 14).

## DHUNA FIZIKE

Kur flasin për dhunën në familje ndaj grave, njerëzit shpesh e kanë fjalën për aktet e dhunës fizike. Dhuna fizike është përdorimi i forcës fizike kundër dikujt tjetër në një mënyrë që e lëndon ose rrezikon atë person. Termi “dhunë fizike në rrethana familjare” përbëhet nga një gamë e gjerë sjelljesh, që përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me: goditjet, rrahjet, kapjet me forcë, goditjet me shkelm, zënia e frymës, shkuljet e flokëve dhe sulmet me armë. Sulmi apo rrahja fizike e bashkëshortes/partneres intime apo e një anëtarit të familjes është krim qoftë kur ndodh brenda apo jashtë shtëpisë.

Tabelat 4.1 dhe 4.3 tregojnë se 23,7% e grave nga 18 deri 55 vjeç kanë përjetuar dhunë fizike në martesë/marrëdhënien e tyre intime “gjatë jetës”, dhe 14,7% po përjetonin dhunë fizike “aktualisht” (brenda 12 muajve para intervistës).

Vrojtimi përbëhet nga 12 zëra të përshkallëzuar për matjen e formave të ndryshme të dhunës fizike të përjetuara zakonisht nga gratë në martesë/marrëdhënien e tyre intime (shih Shtojcën, Tabela 5). Si pjesë e analizës, këta 12 zëra të përshkallëzuar u përdorën për të krijuar variabla të reja për katër llojet e ndryshme të dhunës fizike, bazuar tek tregues si shkalla e ashpërsisë së dhunës dhe gjasat që ajo të shkaktojë lëndime fizike:

Gratë e dhunuara gjithashtu mund të reagojnë ndaj kritikave dhe poshtërimeve të bashkëshortëve/partnerëve të tyre intimë duke u përpjekur të ndryshojnë dhe/ose t'i minimizojnë sjelljet e bashkëshortëve/partnerëve të tyre intimë, duke ua vënë fajin për sjelljen e tyre faktorëve të tjerë, si konsumi i alkoolit. Por, me kalimin e kohës, shumë gra të keqtrajtuara e kuptojnë se asgjë që bëjnë nuk sjell ndonjë ndryshim, dhe kjo iu ul ndjenjën e sigurisë tek vetja dhe tek marrëdhënia e tyre (15).

- Dhuna fizike e moderuar – përfshin një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme fizike: goditjet me shkelma, hedhjet tutje, shtyrjet, tërheqjet zvarrë, goditjet me shuplakë dhe/ose shkuljet e flokëve.
- Dhuna fizike e rëndë – përfshin një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme fizike: goditjet, rrahjet, djegiet me qëllim, marrjet e frymës ose mbytjet, dhe/ose kërcënimet me armë ose përdorimi i një arme kundër personit.
- Dhuna fizike me armë – përfshin kërcënimet dhe/ose goditjet me armë ose me ndonjë objekt tjetër që mund të shkaktojë lëndime fizike.
- Dhuna fizike me lëndime të rënda – përfshin dhunën fizike që i shkakton lëndim fizik një personi tjetër.

Tabela 4.3 tregon përqindjen e grave që kanë përjetuar secilin prej katër llojeve të ndryshme të dhunës fizike në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Në veçanti, 22,0% e grave kanë përjetuar dhunë fizike të moderuar “gjatë jetës”, dhe 13,4% po përjetonin “aktualisht” dhunë fizike të moderuar (brenda 12 muajve para intervistës). Me fjalë të tjera, një nga pesë gra kanë përjetuar dhunë fizike të moderuar në martesë/marrëdhënien e tyre intime.

**Tabela 4.3.** Përqindja e grave që përjetojnë dhunë fizike (18-55 vjeç)

|                                        | N=646,879   |      |            |      |
|----------------------------------------|-------------|------|------------|------|
|                                        | Gjatë jetës |      | Aktualisht |      |
|                                        | n           | %    | n          | %    |
| <b>Dhuna fizike (të gjitha llojet)</b> | 153 186     | 23,7 | 95 251     | 14,7 |
| Dhunë fizike e moderuar                | 142 278     | 22,0 | 86 496     | 13,4 |
| Dhunë fizike e rëndë                   | 90 898      | 14,1 | 51 009     | 7,9  |
| Dhunë fizike me armë                   | 19 585      | 3,0  | 67,09      | 1,0  |
| Dhunë fizike me lëndime të rënda       | 29 871      | 18,8 | 11 570     | 7,3  |

Shënim: Frekuencat dhe përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.


Tabela 4.3 tregon gjithashtu se 14,1% e grave kanë përjetuar dhunë fizike të rëndë në marrëdhëniet bashkëshortore/intime “gjatë jetës”, dhe 7,9% po përjetonin dhunë të rëndë fizike “aktualisht”. Për sa i përket dhunës fizike me përdorim arme, 3,0% e grave kanë përjetuar dhunë fizike me përdorim arme “gjatë jetës”, dhe 1,0% thanë se brenda 12 muajve para intervistës (“aktualisht”) bashkëshorti/partneri i tyre ka kryer një akt dhune fizike me armë kundër tyre.

Dhuna fizike shpesh i shkakton lëndime dhe trauma fizike viktimës (p.sh., lëndime muskulore dhe skeletore, lëndime të indeve të buta dhe trauma gjenitale). Lëndimet e shaktuara nga dhuna në familje shpesh kanë pasoja negative në shëndetin fizik dhe mirëqenien afatshkurtër dhe afatgjatë të grave të keqtrajtuara (16, 17). Tabela 4.3 tregon se 18,8% e grave nga 18 deri 55 vjeç raportuan se kanë përjetuar dhunë fizike me lëndime të rënda “gjatë jetës”, dhe 7,3% e grave po përjetonin dhunë fizike me lëndime të rënda “aktualisht” (brenda 12 muajve para intervistës).

Zakonisht, gratë e dhunuara përjetojnë më shumë se një

formë të dhunës fizike në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Figura 4.2 tregon përqindjen e grave që kanë përjetuar “gjatë jetës” një ose më shumë nga 12 format e ndryshme të dhunës fizike të matura në këtë vërtetim. Ndërsa 23,7% e grave kanë përjetuar dhunë fizike në martesë/marrëdhënien e tyre intime “gjatë jetës”, vetëm 10,0% e tyre kanë përjetuar vetëm një nga format e dhunës fizike të matura në këtë vërtetim. Më shumë se gjysma e grave të keqtrajtuara kishin përjetuar më shumë se një nga 12 format e ndryshme të dhunës fizike të matura në këtë vërtetim. Më konkretisht, 5,6% e grave kishin përjetuar dy nga format e dhunës fizike të matura në këtë vërtetim, 3,0% kishin përjetuar tre nga format e dhunës fizike, 1,8% kishin përjetuar katër nga format, 1,1% kishin përjetuar pesë nga format, 0,9% kishin përjetuar gjashtë nga format, dhe 1,4% kishin përjetuar shtatë deri në dymbëdhjetë nga format e ndryshme të dhunës fizike të matura në këtë vërtetim (shih Shtojcën, Tabela 6). Pasojat e dhunës fizike me format e saj të shumëfishta tek gratë e dhunuara shpesh mund të jenë shumë të rënda, dhe të sjellin probleme afatshkurtra dhe afatgjata të shëndetit fizik, aftësi të kufizuara, dhe madje edhe vdekje si rezultat i vrasjes ose vetëvrasjes (16, 17).

**Figura 4.2.** Format e shumëfishta të dhunës fizike të përjetuara “gjatë jetës” nga gratë (18-55 vjeç)



Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

## DHUNA SEKSUALE

Dhuna seksuale është një lloj tjetër i dhunës në familje që u mat në këtë vërtetim. Dhuna seksuale është çdo rrethanë në të cilën gruaja detyrohet të marrë pjesë apo të kryejë veprimtari seksuale të padëshiruara, të pasigurta, degraduese dhe/ose poshtëruese; kjo përfshin marrëdhënie seksuale me detyrim nga bashkëshorti/partneri me të cilin gruaja ka marrëdhënie seksuale me

pëlqimin e saj (dhuna seksuale bashkëshortore). Tabelat 4.1 dhe 4.4 tregojnë se 7,9% e grave nga 18 deri 55 vjeç thanë se kanë përjetuar dhunë seksuale “gjatë jetës” në martesë/marrëdhënien e tyre intime, dhe 5,0% po përjetonin dhunë seksuale “aktualisht” (brenda 12 muajve para intervistës).

**Tabela 4.4.** Përqindja e grave që përjetojnë dhunë seksuale (18-55 vjeç)

|                                                             | N=646,879   |     |            |     |
|-------------------------------------------------------------|-------------|-----|------------|-----|
|                                                             | Gjatë jetës |     | Aktualisht |     |
|                                                             | n           | %   | n          | %   |
| Dhuna seksuale (të gjitha llojet)                           | 51 087      | 7,9 | 32 539     | 5,0 |
| Është detyruar të bëjë marrëdhënie seksuale                 | 48 291      | 7,5 | 30 340     | 4,7 |
| Është detyruar të bëjë akte seksuale degraduese/poshtëruese | 22 435      | 3,5 | 7 438      | 1,1 |


Shënim: Frekuencat dhe përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Tabela 4.4 tregon gjithashtu se 7,5% e grave raportuan se bashkëshorti/partneri intim i kishte detyruar të kryenin marrëdhënie seksuale me të edhe kur nuk kishin dashur “gjatë jetës”, ndërsa 4,7% e grave po dhunoheshin seksualisht në këtë mënyrë edhe aktualisht. Përveç kësaj, 3,5% e grave raportoi se “gjatë jetës” bashkëshorti/partneri i ka detyruar të kryejnë akte degraduese dhe poshtëruese seksuale që ato nuk donin t’i bënin, dhe 1,1% po përjetonin “aktualisht” një dhunë seksuale të tillë.

Fakti që vetëm 7,9% e grave raportuan se kishin përjetuar dhunë seksuale në martesën e tyre ka të ngjarë të jetë pasqyrim i faktit se dhunimet e trupit të gruas shpesh përligjen brenda kontekstit të martesës, përmes vlerave tradicionale dhe fetare që i quajnë gratë prona të meshkujve dhe seksin si një detyrim bashkëshortor të grave. Për më tepër, zhvirgjërimi me forcë i nuseve të reja natën e martesës dhe marrëdhënia seksuale e detyruar nga burri që vijon, i bëjnë gratë t’i durojnë marrëdhëniet

e padëshiruara seksuale gjatë gjithë martesës. Me kalimin e kohës shumë gra bëhen të nënshtruara dhe i durojnë marrëdhëniet e padëshiruara seksuale me bashkëshortët e tyre (18, 19, 20, 21). Kështu, gratë janë më pak të prira ta quajnë agresionin seksual të bashkëshortit apo sjelljet e tij dhunuese seksuale si dhunë seksuale apo përdhunim bashkëshortor, gjë që shpjegon, pjesërisht, se pse një përqindje aq e madhe e grave, 92,1%, raportuan se nuk kishin përjetuar dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime.

Figura 4.3 tregon se 7,9% e grave që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë jetës në martesë/marrëdhënien e tyre intime; 4,9% e grave kishin përjetuar vetëm një nga format e dhunës seksuale nga ato të identifikuar në Tabelën 4.4, ndërsa 3,0% kishin përjetuar të dy format e ndryshme të dhunës seksuale të identifikuar në Tabelën 4.4 (shih Shtojcën, Tabela 7).

**Figura 4.3.** Format e ndryshme të dhunës seksuale të përjetuara nga gratë (18-55 vjeç) “gjatë jetës”


Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë



Gratë u pyetën për shpeshtësinë e dhunës seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime, sidomos se sa herë kishte ndodhur kjo në 12 muajt para intervistës. Figura 4.4 tregon se gratë e dhunuara seksualisht kishin shumë më tepër gjasa të raportonin se kishin bërë marrëdhënie seksuale me detyrim me bashkëshortin/partnerin, krahasuar me gratë që nuk ishin dhunuar seksualisht. Më konkretisht, 78,2% e grave që nuk ishin dhunuar seksualisht raportuan se nuk ishin detyruar asnjëherë të bënin marrëdhënie seksuale (pa pëlqimin e tyre) me bashkëshortin/partnerin e tyre gjatë vitit të kaluar, krahasuar me vetëm 34,8% të grave që ishin dhunuar seksualisht. Krahasuar me këtë, 61,9% e grave që ishin dhunuar seksualisht thanë se kishin

bërë marrëdhënie seksuale me detyrim me bashkëshortin/partnerin (pa pëlqimin e tyre) gjatë 12 muajve para intervistës. Në veçanti, 16,4% e grave të dhunuara seksualisht raportuan se kishin bërë “shpesh” marrëdhënie seksuale me detyrim me bashkëshortin/partnerin e tyre gjatë vitit të kaluar, krahasuar me 5,5% të grave që nuk ishin dhunuar seksualisht. Përveç kësaj, 2,5% e grave të dhunuara seksualisht raportuan se kishin pasur “shpesh” marrëdhënie seksuale të detyruara me bashkëshortin/partnerin e tyre gjatë vitit të kaluar, krahasuar me 0,4% të grave që nuk ishin dhunuar seksualisht (shih Shtojcën, Tabela 8).

**Figura 4.4.** Shpeshtësia e dhunës seksuale



Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

Studimet ndërkombëtare tregojnë se dhuna seksuale brenda martesës (përdhunimi bashkëshortor) dhe në marrëdhëniet intime shpesh ka pasojë të rënda dhe afatgjata për gratë, përfshirë lëndimet që u bëjnë organeve riprodhuese dhe gjenitale të grave (plasje të lëkurës, lëndime, nxirje, dhe këputje muskujsh) dhe lëndime të tjera fizike (p.sh., lëndime muskulore-skeletore dhe të indeve të buta) që shkaktohen gjatë dhunës seksuale. Ato gjithashtu pësojnë probleme seksuale dhe të shëndetit riprodhues, si probleme gjinekologjike (p.sh., zgjerim vaginal, çarje anale, dhimbje të pelvisit, infeksione të rrugëve urinare, dështime, lindje foshnjash të vdekura, dhe mungesë fertiliteti) (22, 23). Gratë që përfshihen në dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime shpesh nuk lejohen nga bashkëshorti/partneri i tyre dhunues të përdorin mjete kontraceptive, ndaj edhe janë më të rrezikuara të

kenë shtatzëni të padëshiruara dhe sëmundje seksualisht të transmetueshme, përfshirë edhe HIV/SIDA-n (24, 25).

Së fundi, gratë që dhunohen seksualisht apo përdhunohen nga bashkëshorti/partneri i tyre kanë gjasa të pësojnë sulme të shumëfishta dhe sulme seksuale të plota. Duke qenë se përdhunohen nga një person të cilin e duan dhe tek i cili kanë besim, nuk është për t'u çuditur që gratë që i mbijetojnë përdhunimit bashkëshortor shpesh vuajnë nga probleme të rënda dhe afatgjata të shëndetit mendor (p.sh., sindroma e stresit post-traumatik, frikë e madhe, tronditje, ankth, depresion, mendime vetëvrasjeje, si dhe çrregullime të oreksit dhe gjumit) (26, 27). Disa gra që kanë pësuar përdhunim bashkëshortor thonë se u faniten kujtime të këqija, kanë tronditje dhe mosfunksionim seksual, dhe dhimbje emocionale për vite të tëra pas dhunës (28).


## LLOJET E NDRYSHME TË DHUNËS NË FAMILJE

Është e mirë-dokumentuar se gratë e keqtrajtuara nuk përjetojnë vetëm një nga llojet e dhunës në familje – dhunë psikologjike, dhunë fizike, apo dhunë seksuale – por shpesh pësojnë shumë lloje dhune në të njëjtën kohë (29, 30). Figura 4.5 na tregon se gratë e dhunuara zakonisht nuk pësojnë vetëm një lloj dhune në familje – vetëm psikologjike, fizike, apo seksuale – në martesë/marrëdhënien e tyre intime; përkundrazi, ato përjetojnë lloje të shumëfishta dhune.

Ndër ato 59,4% gra që kanë përjetuar dhunë në familje në

martesë/marrëdhënien e tyre intime “gjatë jetës”, 35,9% e tyre kanë përjetuar vetëm një nga llojet e dhunës në familje – dhunë psikologjike, fizike, ose seksuale – gjatë martesës/marrëdhënies së tyre intime. Ndërsa 16,7% e grave kanë përjetuar dy nga këto lloje të dhunës në familje, dhe 6,8% e grave kanë përjetuar çdonjërin prej këtyre tre llojeve të dhunës në familje (shih Shtojcën, Tabela 9). Për gratë e dhunuara, pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të dhunës në familje në format e saj të shumëfishta, janë shumë të rënda (31, 32).

**Figura 4.5.** Llojet e ndryshme të dhunës në familje të përjetuara nga gratë “gjatë jetës” (18-55 vjeç)



Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

U zhvillua gjithashtu edhe një analizë për të shqyrtuar marrëdhëniet midis secilit prej tre llojeve të dhunës në familje –psikologjike, fizike, dhe seksuale. Tabela 4.5 tregon se ekzistojnë lidhje të konsiderueshme ndërmjet të tre llojeve të dhunës në familje. Në veçanti, 38,9% e grave që kishin përjetuar dhunë psikologjike në martesë/marrëdhënien e tyre intime kishin përjetuar edhe dhunë fizike, dhe 13,0% e grave të dhunuara psikologjikisht kishin përjetuar edhe dhunë seksuale. Me fjalë të tjera,

gratë që ishin dhunuar psikologjikisht nga bashkëshortët/partnerët e tyre, kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin dhunë fizike dhe seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime, krahasuar me gratë që nuk ishin dhunuar psikologjikisht nga bashkëshorti/partneri. Këto të dhëna tregojnë se ekzistenca e dhunës psikologjike në martesë/marrëdhënien intime të një gruaje është një parashikues i fortë se në martesën/marrëdhënien e tyre intime ekzistojnë edhe llojet e tjera të dhunës (shih Shtojcën, Tabela 10).

**Tabela 4.5.** Marrëdhëniet ndërmjet llojeve të dhunës në familje

|                    | N=646,879          |                   |              |                   |                |                   |
|--------------------|--------------------|-------------------|--------------|-------------------|----------------|-------------------|
|                    | Dhuna psikologjike |                   | Dhuna fizike |                   | Dhuna seksuale |                   |
|                    | n                  | %                 | n            | %                 | n              | %                 |
| Dhuna psikologjike | ---                | ---               | 146 526      | 38,9 <sup>a</sup> | 49 006         | 13,0 <sup>a</sup> |
| Dhuna fizike       | 146 526            | 95,7 <sup>a</sup> | ---          | ---               | 45 025         | 29,4 <sup>a</sup> |
| Dhuna seksuale     | 49 006             | 95,9 <sup>a</sup> | 45 025       | 88,1 <sup>a</sup> | ---            | ---               |

Shënim: Frekuencat dhe përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

<sup>a</sup> Vlera e  $X^2 < .01$

Tabela 4.5 zbulon gjithashtu edhe marrëdhënien midis dhunës fizike dhe llojeve të tjera të dhunës në familje. Në veçanti, 95,7% e grave që kishin përjetuar dhunë fizike në martesë/marrëdhënien e tyre intime kishin përjetuar edhe dhunë psikologjike, ndërsa 29,4% e grave të keqtrajtuara ishin dhunuar edhe seksualisht. Me fjalë të tjera, gratë që kanë përjetuar keqtrajtim fizik nga bashkëshorti/partneri i tyre, kanë shumë më tepër gjasa të përjetojnë dhunë psikologjike dhe dhunë seksuale, krahasuar me gratë që nuk janë keqtrajtuar fizikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre. Pra, prania e dhunës fizike në martesën/marrëdhënien intime të një gruaje është një parashikues shumë i fortë se në martesën/marrëdhënien e saj intime po ndodhin edhe llojet e tjera të dhunës (shih Shtojcën, Tabela 11).

Së fundi, Tabela 4.5 tregon marrëdhënien midis dhunës seksuale dhe llojeve të tjera të dhunës në familje. Në konkretisht, 95,9% e grave që kishin përjetuar dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime kishin përjetuar edhe dhunë psikologjike, dhe 88,1% kishin përjetuar dhunë fizike. Me fjalë të tjera, gratë e dhunuara seksualisht prej bashkëshortit/partnerit të tyre kanë shumë më tepër gjasa të përjetojnë dhunë psikologjike dhe fizike, krahasuar me gratë që nuk janë dhunuar seksualisht nga bashkëshorti/partneri i tyre. Këto të dhëna tregojnë se prania e dhunës seksuale është një parashikues shumë i fortë se në martesë/marrëdhënien intime ekzistojnë edhe

llojet e tjera të dhunës (shih Shtojcën, Tabela 11).

Figura 4.3 dhe Tabela 4.5 hedhin poshtë perceptimin e gabuar se gratë përjetojnë vetëm një formë dhune në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Sa herë vërejmë ose dëgjojmë për një situatë kur gruaja keqtrajtohet me fjalë, poshtërohet, dhe/ose kërcënohet nga bashkëshorti/partneri i saj, mund të jemi rreth 40% të sigurt se ajo grua përjeton edhe dhunë fizike, dhe 13% të sigurt se ajo po dhunohet seksualisht në martesë/marrëdhënien intime. Ndërsa sa herë vërejmë ose dëgjojmë për një grua që dhunohet fizikisht nga bashkëshorti/partneri i saj, apo shohim një grua me lëndime fizike dhe/ose shenja lëndimesh nga dhuna fizike, mund të jemi rreth 96% të sigurt se ajo grua e keqtrajtuar fizikisht po dhunohet edhe psikologjikisht, si dhe afërsisht 30% të sigurt se ajo po dhunohet edhe seksualisht në martesë/marrëdhënien intime. Së fundi, nëse dëgjojmë për një grua se po përjeton dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e saj intime, mund të jemi pothuaj 96% të sigurt se ajo po dhunohet edhe psikologjikisht, dhe 88% të sigurt se po dhunohet fizikisht në martesë/marrëdhënien e saj intime.

Pavarësisht nga shtresëzimet e shumëfishta të viktimizimit në jetën e shumë grave, një pjesë e madhe e tyre e durojnë dhunën dhe keqtrajtimin dhe vuajnë në heshtje. Dhuna në familje është pa dyshim një formë serioze e dhunës kundër grave, që ka pasoja të vërteta në jetën e grave dhe në shëndetin dhe mirëqenien e tyre (33, 34).

## KUR FILLON DHUNA NË FAMILJE NË MARTESË

Gratë u pyetën se kur kishte filluar dhuna në familje në martesën e tyre. Tabela 4.6 tregon se tri të katërtat e grave të anketuara raportuan se dhuna në familje kishte filluar brenda 3 viteve të para pas martesës. Ndër gratë e dhunuara seksualisht, 3,4% raportuan se dhuna seksuale

kishte filluar përpara se të martoheshin, 29,6% raportuan se dhuna seksuale kishte filluar brenda vitit të parë të martesës, ndërsa 51,9% raportuan se dhuna seksuale kishte filluar brenda vitit të dytë ose të tretë të martesës.

**Tabela 4.6.** Vitet pas martesës/bashkëjetesës kur fillon dhuna në familje, sipas llojit të dhunës

|                              | N=646,879                                       |      |                    |      |              |      |                |      |
|------------------------------|-------------------------------------------------|------|--------------------|------|--------------|------|----------------|------|
|                              | Dhuna në familje (të gjitha llojet-gjatë jetës) |      | Dhuna psikologjike |      | Dhuna fizike |      | Dhuna seksuale |      |
| Kur ka filluar dhuna:        | n                                               | %    | n                  | %    | n            | %    | n              | %    |
| Përpara martesës             | 2 903                                           | 1,8  | 2 903              | 1,9  | 2 903        | 1,9  | 1 713          | 3,4  |
| Brenda vitit të parë         | 43 965                                          | 27,6 | 42 561             | 28,1 | 41 744       | 27,3 | 15 132         | 29,6 |
| Në vitin e dytë ose të tretë | 79 868                                          | 50,2 | 74 497             | 49,2 | 77 285       | 50,5 | 26 524         | 51,9 |
| Vitin e katërt ose të pestë  | 23 618                                          | 14,8 | 22 798             | 15,1 | 22 465       | 14,7 | 5 845          | 11,4 |
| Pas vitit të gjashtë         | 8 894                                           | 5,6  | 8 673              | 5,7  | 8 789        | 5,7  | 1 873          | 3,7  |

Shënim: Frekuencat dhe përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

## DHUNA FIZIKE GJATË SHTATZËNISË

Gratë u pyetën gjithashtu nëse ishin dhunuar ose keqtrajtuar nga bashkëshorti gjatë shtatzënisë. Figura 4.7 tregon se 83,4% e grave të anketuara kishin pasur shtatzëni në jetën e tyre. Ndër gratë që kishin pasur shtatzëni në jetën e tyre, 1,3% raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre i kishte goditur, goditur me shuplakë, me shkelma, ose i kishte lënduar fizikisht gjatë kohës që ishin shtatzëna.

**Tabela 4.7.** Dhuna fizike gjatë shtatzënisë

|                                                                                | N=739 758 |      |
|--------------------------------------------------------------------------------|-----------|------|
|                                                                                | n         | %    |
| Kanë qenë shtatzëna                                                            | 616 738   | 83,4 |
|                                                                                | N=616 738 |      |
|                                                                                | n         | %    |
| Goditur, goditur me shuplakë, shkelma, ose lënduar fizikisht gjatë shtatzënisë | 9 449     | 1,3  |

## LËNDIMET E SHKAKTUARA NGA DHUNA NË FAMILJE

Gratë e keqtrajtuara shpesh pësojnë lëndime fizike që lidhen me dhunën fizike dhe seksuale objekt i së cilës janë. Lëndimet fizike shpesh ekzistojnë në seri, duke filluar nga lëndime të lehta deri tek ato shumë të rënda; skaji më i rëndë i serisë është vdekja nga dhuna. Në fakt Departamenti i Sigurisë Publike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka raportuar se në vitet 2010 dhe 2011, 83% e grave të vrara ishin vrarë nga bashkëshortët/partnerët e tyre; ndërsa në vitin 2012, 62% e grave të vrara ishin vrarë nga bashkëshortët/partnerët (16 nga 26 gjithsej një vitin 2012). Është e rëndësishme të kuptohet se gratë e dhunuara fizikisht shpesh ngurrojnë t'i raportojnë lëndimet që pësojnë për shkak të dhunës në familje, madje ngurrojnë t'i tregojnë edhe punonjësve të shëndetësisë dhe mjekëve (35, 36).

Ndonëse është mjaft e vështirë t'i bësh gratë të flasin për lëndimet e tyre, ky vërtetim u hartua në mënyrë të tillë që të maste lëndimet e grave të lidhura me incidente të dhunës në familje. Megjithatë, duke marrë parasysh ngurrimin e grave për të raportuar lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje, nuk është për t'u çuditur se ndër 59,4% të grave që kishin përjetuar dhunë në familje gjatë jetës, vetëm

41,4% iu përgjigjën pyetjeve që lidheshin me lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje; 58,6% e grave që kishin pësuar dhunë në familje "gjatë jetës" nuk i dhanë përgjigje kësaj pjese të pyetjeve të pyetësorit.

Tabela 4.8 tregon se ndër gratë e dhunuara fizikisht që iu përgjigjën pyetjeve për lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje, 18,8% raportuan se kishin pësuar lëndime fizike "gjatë jetës" dhe 7,4% ishin lënduar fizikisht në rrethana të dhunës në familje brenda periudhës 12-mujore para intervistës. Për sa i përket llojeve të lëndimeve, gratë e dhunuara raportuan se më shpesh kishin pësuar: çarje/prerje, nxirje, ose dhimbje (12,1% "gjatë jetës" dhe 7,4% "aktuale"); si dhe lëndime të syve, djegie, ndrydhje ose nxjerrje kyçesh (6,3% "gjatë jetës" dhe 2,4% "aktuale"); dhe lëndime në kokë (6,5% "gjatë jetës" dhe 2,3% "aktuale"). Gratë tjera të keqtrajtuara kishin pësuar lëndime abdominale (4,4% "gjatë jetës" dhe 1,5% "aktuale"); plagë të thella, eshtra të thyera, dhëmbë të thyer, dhe lëndime të tjera të rënda (2,2% "gjatë jetës" dhe ,6% "aktuale"); dhe kishin humbur ndjenjat si pasojë e dhunës në familje (1,1% "gjatë jetës" dhe 0,2% "aktuale").

**Tabela 4.8.** Gratë e dhunuara fizikisht që kanë pësuar lëndime të shkaktuara nga dhuna në familje


|                                                                                   | N=159 248   |      |            |     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------|------|------------|-----|
|                                                                                   | Gjatë jetës |      | Aktualisht |     |
|                                                                                   | n           | %    | n          | %   |
| Lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje (të gjitha llojet - gjatë jetës)       | 29 871      | 18,8 | 11 768     | 7,4 |
| Çarje, nxirje, ose dhimbje                                                        | 19 252      | 12,1 | 8 422      | 5,3 |
| Lëndime në sy, djegie, ndrydhje ose nxjerrje kyçesh                               | 10 077      | 6,3  | 3 746      | 2,4 |
| Plagë të thella, eshtra të thyera, dhëmbë të thyer, ose lëndime të tjera të rënda | 3 510       | 2,2  | 1 026      | ,6  |
| Humbje ndjenjash                                                                  | 1 731       | 1,1  | 352        | ,2  |
| Lëndime në kokë                                                                   | 10 391      | 6,5  | 3 593      | 2,3 |
| Lëndime abdominale                                                                | 7 073       | 4,4  | 2 350      | 1,5 |

*Shënim:* Frekuencat dhe krahasimet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Shpesh gratë e dhunuara përjetojnë më shumë se një lloj lëndimi fizik dhe lëndimet e tyre mund të mbivendosen, pra me kalimin e kohës ndodhin incidente të tjera të dhunës në familje (37). Në fakt, figura 4.6 tregon se ndër 18,8% të grave të dhunuara që kishin pësuar lëndime të shkaktuara nga dhuna, 12,4% kishin përjetuar vetëm një prej gjashtë kategorive të lëndimeve të identifikuara në Tabelën 4.7. Ndërsa 3,0% kishin përjetuar dy prej

kategorive të lëndimeve, 1,5% kishin përjetuar tri kategori lëndimesh, ndërsa 1,8% kishin përjetuar katër deri në gjashtë kategori lëndimesh të identifikuara në Tabelën 4.7 (shih Shtojcën, Tabela 12). Incidentet e përsëritura të dhunës në familje mund të sjellin si pasojë lëndime të shumëfishta që kanë ndikim negativ afatgjatë në gjendjen shëndetësore dhe mirëqenien e grave (38, 39).

**Figura 4.6.** Lëndimet nga dhuna në familje të pësuar nga gratë e dhunuara (18-55 vjeç)




*Shënim:* Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

Figura 4.7 tregon se gratë e dhunuara fizikisht dhe seksualisht nga bashkëshortët/partnerët kishin pësuar lëndime me shkallë të ndryshme ashpërsie (shih Shtojcën, Tabela 10). Por, gratë e dhunuara seksualisht kishin më tepër gjasa se ato të dhunuara fizikisht të kishin përjetuar çdonjërin prej llojeve të ndryshme të lëndimeve fizike të renditura në Figurën 4.7. Është e rëndësishme të theksohet se Tabela 4.5 tregoi se 29,4% e grave të dhunuara fizikisht

thanë se ishin dhunuar edhe seksualisht në martesë/marrëdhënien e tyre intime, dhe 88,1% e grave të dhunuara seksualisht raportuan se ishin dhunuar edhe fizikisht në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Në përgjithësi, Tabela 4.1 tregoi se 24,6% (ose 1 në 4 gra) kishin përjetuar edhe dhunë fizike edhe dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime.

**Figura 4.7.** Lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje të përjetuara nga gratë e dhunuara, sipas llojit të dhunës



*Shënim:* Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

Figura 4.7 tregon gjithashtu se gratë që kishin përjetuar dhunë të rëndë fizike në martesë/marrëdhënien e tyre intime kishin më tepër gjasa të përjetonin çdonjërin prej llojeve të ndryshme të lëndimeve fizike, krahasuar me gratë që kishin përjetuar dhunë fizike të moderuar; ndërsa gratë që kishin përjetuar dhunë fizike me përdorim arme, kishin shumë më tepër gjasa të pësonin lëndime fizike, përfshirë edhe lëndimet fizike më të rënda e serioze. Në veçanti, ndër gratë që kishin përjetuar dhunë fizike me përdorim arme: 41,0% kishin pësuar çarje/prerje, nxirje dhe/ose dhimbje; 30,7% kishin pësuar lëndime në kokë; 24,0% kishin pësuar lëndime abdominale; 22,0% kishin pësuar lëndime në sy, djegie, ndrydhje, dhe/ose nxjerrje kyçesh/eshttrash; 15,3% kishin pësuar plagë të thella, eshtra të thyera, dhëmbë të thyer, ose ndonjë lëndim të rëndë; dhe 8,1% kishin humbur ndjenjat (shih Shtojcën Tabela 10).

Gjithashtu u analizuan të dhënat për të parë se deri në çfarë mase kishin ndikuar negativisht lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje në aftësinë e grave për të kryer përgjegjësitë e tyre të punëve të shtëpisë dhe të përkujdesit për fëmijët, ose kishin bërë që ato të mungonin në punë. Tabela 4.9 tregon se 9,4% e grave që kishin pësuar lëndime të shkaktuara nga dhuna në familje thanë se nuk kishin qenë në gjendje të bënin punët e

shtëpisë dhe të kujdeseshin për fëmijët, ndërsa 5,1% nuk kishin qenë në gjendje të shkonin në punë për shkak të lëndimeve. Ndër gratë që raportuan se nuk kishin mundur të kryenin përgjegjësitë e tyre për punët e shtëpisë dhe kujdesit për fëmijët, 75,5% thanë se nuk kishin mundur t'i bënin këto punë për 1-3 ditë, 14,7% nuk kishin mundur t'i bënin për 4-6 ditë, dhe 9,7% nuk kishin mundur t'i bënin për 7 ose më shumë ditë. Ndër gratë që nuk kishin mundur të shkonin në punë për shkak të lëndimeve të shkaktuara nga dhuna në familje, 65,9% kishin humbur 1-3 ditë pune, 18,0% kishin humbur 4-6 ditë pune, dhe 16,1% kishin humbur 7 ose më shumë ditë pune.

Tabela 4.8 tregon se gratë e dhunuara kishin humbur më shumë ditë pune krahasuar me ditët kur nuk kishin mundur të kryenin punët e shtëpisë apo të kujdeseshin për fëmijët, si pasojë e lëndimeve nga dhuna në familje. Një shpjegim i mundshëm për këtë është se gratë e dhunuara nuk dëshironin të ktheheshin në punë me lëndime të shkaktuara nga dhuna në familje, sepse puna kryhet në mjedise publike dhe nuk duan t'u shohin të tjerët lëndimet; kurse punët e shtëpisë dhe kujdesi për fëmijët bëhet në shtëpi, larg syve të njerëzve. Si pasojë, ka më shumë gjasa që gratë të mungojnë në punë derisa t'u shërohen plagët (shih Shtojcën, Tabelat 12 dhe 13).

**Tabela 4.9.** Lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje dhe pengimi i punës së gruas

|                                                                      |        |     | Numri i ditëve të humbura |      |          |      |            |      |
|----------------------------------------------------------------------|--------|-----|---------------------------|------|----------|------|------------|------|
|                                                                      |        |     | 1-3 ditë                  |      | 4-6 ditë |      | Mbi 7 ditë |      |
|                                                                      | n      | %   | n                         | %    | n        | %    | n          | %    |
| <b>Pasojat e dhunës ju penguan të kujdeseni për shtëpinë/fëmijët</b> | 15,024 | 9.4 | 11,350                    | 75.5 | 2,212    | 14.7 | 1,463      | 9.7  |
| <b>Pasojat e dhunës ju penguan të shkoni në punë</b>                 | 8,058  | 5.1 | 5,310                     | 65.9 | 1,453    | 18.0 | 1,294      | 16.1 |

*Shënim:* Frekuencat dhe përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Lëndimet dhe shenjat e shkaktuara nga dhuna fizike të grave të dhunuara janë reale, dhe gratë shpesh përpiqen t'i mbulojnë dhe fshehin lëndimet dhe shenjat fizike ngaqë iu vjen turp. Megjithatë, dhunimi fizik dhe lëndimet fizike që lidhen me të janë shpesh mbivendosjen dhe çojnë në probleme të tjera afatshkurtra dhe afatgjata të shëndetit


fizik të grave (40). Në zonat dhe krahinat rurale ku shërbimi i urgjencës mjekësore ose nuk ekziston, ose nuk ofrohet me shpejtësinë e duhur, gratë e dhunuara fizikisht janë më të rrezikuara të pësojnë lëndime dhe paaftësi të përhershme, madje edhe të humbin jetën nga lëndimet e tyre (41).

## DHUNA SEKSUALE, PËRDORIMI I KONTRACEPTIVËVE, DHE RREZIKU I SST-VE

Studimet ndërkombëtare kanë treguar se gratë që përjetojnë dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime shpesh pengohen nga bashkëshortët/partnerët e tyre dhunues të përdorin mjete kontraceptive dhe përballen me një rrezik më të madh të shtatzënive të padëshiruara dhe të marrjes së sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (SST-të), përfshirë edhe HIV/SIDA-n (42, 43). Për këtë arsye, u analizuan të dhëna për të kuptuar marrëdhënien midis dhunës seksuale, mundësisë së grave për të përdorur mjete kontraceptive, dhe rrezikut të tyre për të marrë sëmundje seksualisht të transmetueshme (SST), përfshirë edhe HIV/SIDA-n. Figura 4.8 tregon se gratë e dhunuara seksualisht (15,7%) kishin gati 3 herë më shumë gjasa të thoshin se bashkëshortët nuk i linin të përdornin mjete kontraceptive për të shmangur shtatzënitë, krahasuar me gratë që nuk ishin dhunuar seksualisht (5,8%). Përveç kësaj, gratë e dhunuara seksualisht (47,0%) kishin dy herë më shumë gjasa të thoshin se bashkëshorti/partneri i tyre nuk kishte dijeni kur ato përdornin kontraceptivë, në krahasim me gratë që nuk ishin dhunuar seksualisht (21,2%) (Shih Shtojcën, Tabela 15).


Për sa i përket rrezikut nga SST-të, Figura 4.9 tregon se ndërsa vetëm 2,3% e grave të dhunuara seksualisht ishin të shqetësuara për rrezikun e marrjes së ndonjë SST-je, përfshirë HIV/SIDA-n, ndërsa 43,5% e grave të dhunuara seksualisht raportuan se kishin SST. Përveç kësaj, gratë e dhunuara seksualisht kishin dy herë më shumë gjasa të kishin pasur një SST në të kaluarën, krahasuar me gratë që nuk ishin dhunuar seksualisht në martesë/marrëdhënien e tyre intime (21,2%; shih Shtojcën, Tabela 15). Kështu, mungesa e shqetësimit të grave në lidhje me rrezikun e marrjes së ndonjë SST-je, mund të ketë të bëjë me faktin se ato kanë pasur SST në të kaluarën.

**Figura 4.8.** Dhuna seksuale dhe përdorimi i kontraceptivëve



Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

**Figura 4.9.** Dhuna seksuale dhe rreziku i SST-ve



Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë



## ALKOOLI DHE DHUNA NË FAMILJE

Marrëdhënia midis përdorimit/abuzimit të alkoolit dhe dhunës në familje është e ndërlikuar. Një nga mitet – idetë e rreme që i kanë shumë njerëz – për dhunën në familje është se alkooli është një shkaktar madhor i dhunës në familje. Në të vërtetë, nuk është alkooli ai që shkakton dhunë në familje, ndonëse disa bashkëshortë/partnerë dhunues e përdorin alkoolin si pretext për t'u bërë të dhunshëm (44). Ndonëse përdorimi/abuzimi i alkoolit nga dhunuesi mund të ndikojë në atë se sa e rëndë është dhuna në familje, apo në lehtësinë me të cilën bashkëshorti/partneri dhunues i justifikon veprimet e veta, bashkëshorti/partneri dhunues nuk bëhet i dhunshëm për shkak të alkoolit. Me fjalë të

tjera, të pirët e alkoolit nuk bën që bashkëshorti/partneri dhunues të humbasë kontrollin. Përkundrazi, dhuna në familje përdoret për të ushtruar pushtet dhe kontroll mbi një person tjetër, pra nuk përfaqëson humbje të kontrollit (45).

Tabela 4.10 tregon se ndër gratë e anketuara, 39,7% thanë se bashkëshorti/partneri i tyre pinte alkool. Ndër ato gra bashkëshortët/partnerët e të cilave pinin alkool, 69,1% thanë se bashkëshorti/partneri i tyre dehet (61,9% thanë se bashkëshorti/partneri dehet “ndonjëherë”, dhe 7,2% thanë se bashkëshorti/partneri dehet “shpesh”).


**Tabela 4.10.** Konsumi i alkoolit nga bashkëshortët/partnerët intimë

|                                             | N=739 758 |      |
|---------------------------------------------|-----------|------|
|                                             | n         | %    |
| Bashkëshorti/partneri pi alkool             | 616 738   | 83,4 |
| Sa shpesh dehet bashkëshorti/partneri juaj? | N=262 802 |      |
|                                             | n         | %    |
| Asnjëherë                                   | 81 203    | 30,9 |
| Ndonjëherë                                  | 162 611   | 61,9 |
| Shpesh                                      | 18 987    | 7,2  |

Figura 4.10 tregon se gratë, bashkëshortët/partnerët e të cilave pinë alkool (76,7%) kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin dhunë në familje – dhunë psikologjike, fizike dhe/ose seksuale – krahasuar me gratë bashkëshortët/partnerët e të cilave nuk pinin alkool (47,8%). Më konkretisht, gratë bashkëshortët/partnerët e të cilave pinin alkool (74,9%) kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin dhunë psikologjike se sa gratë bashkëshortët/partnerët

e të cilave nuk pinin alkool (46,9%). Për më tepër, gratë bashkëshortët/partnerët e të cilave pinin alkool kishin pothuaj tri herë më shumë gjasa të përjetonin dhunë fizike, dhe gjashtë herë më shumë gjasa të përjetonin dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime, në krahasim me gratë bashkëshortët/partnerët e të cilave nuk pinin alkool (shih Shtojcën, Tabela 16).

**Figura 4.10.** Konsumi i alkoolit nga bashkëshorti/partneri sipas llojeve të dhunës në familje




*Shënim:* Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë



Po kështu, mund të supozohet se konsumi i alkoolit nga bashkëshortët/partnerët ka ndikim tek shkalla e ashpërsisë së dhunës dhe e lëndimeve fizike që pësojnë gratë si rezultat i dhunës në familje. Figura 4.11 tregon se ndër gratë e dhunuara fizikisht dhe/ose seksualisht, gratë që thoshin se bashkëshortët/partnerët e tyre pinë alkool kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin lëndime të shkaktuara nga dhuna në familje (shih Shtojcën, Tabela 18). Në veçanti, gratë e dhunuara, bashkëshortët/partnerët e të cilave pinin

alkool kishin më shumë gjasa të pësonin çarje/prerje, nxirje dhe/ose dhimbje të shkaktuara nga dhuna në familje. Ato kishin pothuaj dy herë më shumë gjasa të pësonin lëndime në sy, djegie, ndrydhje, dhe/ose nxjerrje kyçesh/eshttrash nga dhuna në familje. Përveç kësaj, ato kishin dy herë më shumë gjasa të pësonin plagë të thella, eshtra të thyera, dhëmbë të thyer, dhe/ose lëndime të rënda, dhe dy herë më shumë gjasa të pësonin humbje ndjenjash dhe lëndime abdominale (shih Shtojcën, Tabela 18).

**Figura 4.11.** Lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje (gjatë jetës) sipas konsumit të alkoolit nga bashkëshorti/partneri



Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

## NDIKIMET DEMOGRAFIKE TË DHUNËS NË FAMILJE


Për të kuptuar dallimet demografike në përvojat e grave me dhunën në familje në martesë/marrëdhënien e tyre intime, u hartuan tabela të kombinuara për të përcaktuar nëse kishte dallime statistikisht të rëndësishme sipas

faktorëve si gjendja civile, grupmosha, niveli arsimor, gjendja e punësimit, dhe vendbanimi (dallimi urban-rural) i grave.

### Gjendja civile e grave dhe dhuna në familje

Figura 4.12 tregon se gratë në secilën kategori – të martuara, të divorcuara/ndara, dhe beqare (që jetojnë me një partner) – kanë përjetuar dhunë në familje “gjatë jetës”; megjithatë, gratë e divorcuara/ndara (78,4%) kishin shumë më tepër gjasa të kishin përjetuar “gjatë jetës” dhunë në familje të të gjitha llojeve në martesën/marrëdhënien e tyre më të fundit intime, krahasuar me gratë e martuara


(59,1%) dhe beqare (46,6%). Përveç kësaj, gratë e divorcuara/ndara kishin shumë më tepër gjasa të kishin përjetuar “gjatë jetës” dhunë psikologjike (78,4%), dhunë fizike (53,3%), dhe dhunë seksuale (28,2%), krahasuar me gratë e martuara (përkatësisht 57,8%, 23,0%, dhe 7,5%) dhe gratë beqare (përkatësisht 46,6%, 28,4%, dhe 4,2%); (shih Shtojcën, Tabelat 19 dhe 20).

**Figura 4.12.** Llojet e dhunës në familje ndaj grave sipas gjendjes civile të grave (gjatë jetës)

Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

Krahasuar me këtë, Figura 4.13 tregon se gratë e martuara (54,2%) kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin dhunë në familje të të gjitha llojeve “aktualisht”, krahasuar me gratë e divorcuara/ndara (34,0%) dhe gratë beqare (31,0%). Më konkretisht, gratë e martuara (53,3%) kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin dhunë psikologjike dhe dhunë fizike (14,8%) “aktualisht”, krahasuar me gratë e divorcuara/ndara (përkatesisht 34,0% dhe 13,7%) dhe gratë beqare (përkatesisht 31,0% dhe 12,8%).

Për sa i përket dhunës seksuale, gratë e martuara (5,1%) dhe gratë beqare që bashkëjetojnë me një partner intim (4,2%) kishin gjasa pothuaj të barabarta të përjetonin dhunë seksuale “aktualisht” në martesë/marrëdhënien e tyre intime, por si gratë e martuara ashtu edhe ato beqare kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin dhunë seksuale “aktualisht”, krahasuar me gratë e divorcuara/ndara (2,7%; shih Shtojcën, Tabelat 19 dhe 20).

**Figura 4.13.** Gjendja civile e grave, sipas llojit të dhunës në familje (aktuale)

Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë


## Mosha e grave dhe dhuna në familje

Gjithashtu u kryen analiza për të përcaktuar nëse kishte dallime statistikisht domethënëse në përvojat e grave me dhunën në familje sipas moshës. Figura 4.14 tregon se shumica e grave në të gjitha grupmoshat kishin përjetuar dhunë në familje “gjatë jetës”; megjithatë, gratë 18-24 vjeç (64,0%) kishin pak më tepër gjasa të kishin përjetuar dhunë në familje “gjatë jetës” krahasuar me gratë 25-34 vjeç (60,3%), 35-44 vjeç (59,8%), dhe ato të moshës 45-55 vjeç (58,0%). Në veçanti, gratë e moshës 18-24 (62,5%) kishin shumë më tepër gjasa të kishin përjetuar dhunë psikologjike “gjatë jetës” në martesë/marrëdhënien e tyre intime krahasuar me gratë 25-34 vjeç (59,8%), 35-44 vjeç (58,7%), dhe ato 45-55 vjeç (56,4%). Sidoqoftë, në krahasim me këtë, gratë e moshës 18-24 vjeç (17,1%) kishin shumë më pak gjasa të kishin përjetuar “gjatë jetës” dhunë fizike në martesë/marrëdhënien e tyre intime, krahasuar me

gratë 25-34 vjeç (23,4%), 35-44 vjeç (24,0%), dhe 45-55 vjeç (24,2%). Ky dallim mund të shpjegohet pjesërisht me faktin se gratë e moshës 25 vjeç e lart kishin shumë më tepër gjasa të ishin të martuara dhe të jetonin me një partner intim se sa gratë e vajzat nën 25 vjeç, dhe se dhuna fizike në jetën e grave ndodh në pjesën më të madhe brenda kontekstit të martesës dhe të marrëdhënieve intime.

Për sa i përket dhunës seksuale, gratë e moshës 35-44 vjeç (9,5%) kishin më tepër gjasa të kishin përjetuar dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime ndonjëherë “gjatë jetës”; ndërsa gratë e moshës 45-55 vjeç (6,3%) kishin më pak gjasa të përjetonin dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime “gjatë jetës” (shih Shtojcën, Tabelat 21 dhe 22).


**Figura 4.14.** Statusi i grupmoshës së grave sipas llojeve të dhunës në familje (gjatë jetës)



*Shënim:* Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

Figura 4.15 tregon se megjithëse shumica e grave në të gjitha grupmoshat po përjetonin “aktualisht” dhunë në familje, gratë e moshës 45-55 vjeç (49,8%) kishin shumë më pak gjasa të përjetonin dhunë në familje të të gjitha llojeve “aktualisht”, krahasuar me gratë nga 18-24 vjeç (58,7%), 25-34 vjeç (58,1%) dhe 35-44 vjeç (54,7%). Përveç kësaj, gratë 18-24 vjeç (57,2%), 25-34 vjeç (57,7%) dhe 35-44 vjeç (54,1%) kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin “aktualisht” dhunë psikologjike në martesë/marrëdhënien e tyre intime, krahasuar me gratë 45-55

vjeç (48,5%). Për sa i përket dhunës fizike, gratë e moshës 25-34 vjeç (16,8%) dhe 35-44 vjeç (16,2%) kishin pak më shumë gjasa të përjetonin “aktualisht” dhunë fizike në martesë/marrëdhënien e tyre intime, krahasuar me gratë e moshës 18-24 vjeç (13,2%) dhe 45-55 vjeç (12,4%). Së fundi, gratë e moshës 18-24 vjeç (6,6%), 35-44 vjeç (6,2%), 25-34 vjeç (5,5%) kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin “aktualisht” dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime, krahasuar me gratë e moshës 45-55 vjeç (3,6%; shih Shtojcën, Tabelat 21 dhe 22).

**Figura 4.15.** Llojet e dhunës në familje ndaj grave sipas grupmoshës (aktuale)


Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

### Niveli arsimor i grave dhe dhuna në familje

U kryen gjithashtu edhe analiza për të përcaktuar nëse kishte dallime statistike domethënëse në përvojat e grave me dhunë në familje sipas nivelit arsimor. Figura 4.16 tregon se ndonëse një pjesë e konsiderueshme e grave në secilën kategori të nivelit arsimor kishin përjetuar dhunë në familje gjatë jetës, gratë me arsim tetëvjeçar (66,7%) kishin shumë më tepër gjasa të kishin përjetuar “gjatë jetës” dhunë në familje të të gjitha llojeve, krahasuar me gratë me arsim fillor ose më të ulët (58,5%), ato me arsim të mesëm (56,4%), dhe arsim universitar/pasuniversitar (43,2%). Përveç kësaj, gratë me arsim tetëvjeçar kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin dhunë psikologjike (65,1%), dhunë fizike (31,0%),

dhe dhunë seksuale (11,3%), krahasuar me gratë me arsim fillor ose më të ulët (përkatësisht 57,7%, 23,3%, dhe 6,1%), arsim të mesëm (përkatësisht 55,3%, 19,5%, dhe 5,1%), dhe/ose arsim universitar/pasuniversitar (përkatësisht 42,6%, 10,4%, dhe 5,3%).

Gratë me arsim universitar/pasuniversitar kishin më pak gjasa nga të gjitha të përjetonin “gjatë jetës” dhunë në familje të të gjitha llojeve; megjithatë, ato nuk ishin të përjashtuara nga përjetimi i dhunës në familje në martesë/marrëdhënien e tyre intime “gjatë jetës” thjesht për faktin se ishin me arsim të lartë (shih Shtojcën, Tabelat 23 dhe 24).


**Figura 4.16.** Niveli arsimor i grave sipas llojeve të dhunës në familje (gjatë jetës)

Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

Figura 4.17 tregon se një pjesë e konsiderueshme e grave në secilën kategori të nivelit arsimor po përjetonin “aktualisht” dhunë në familje; megjithatë, gratë me arsim tetëvjeçar (61,2%) kishin më shumë gjasa të përjetonin “aktualisht” dhunë të të gjitha llojeve në familje, krahasuar me gratë me arsim fillor ose më të ulët (53,2%), arsim të mesëm (50,1%), dhe arsim universitar/pasuniversitar (37,8%). Përveç kësaj, gratë me arsim tetëvjeçar kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin dhunë psikologjike (59,9%), dhunë fizike (21,5%), dhe dhunë seksuale (7,7%), krahasuar me gratë

me arsim fillor ose më të ulët (përkatësisht 52,3%, 14,9%, dhe 3,3%), ato me arsim të mesëm (përkatësisht 49,5%, 10,9%, dhe 2,8%), dhe/ose gratë me arsim universitar/pasuniversitar (përkatësisht 37,7%, 3,2%, dhe 33%). Është e rëndësishme të vihet në dukje se, ndonëse gratë me arsim universitar/pas-universitar kishin më pak gjasa nga të gjitha gratë të përjetonin “aktualisht” dhunë, ato nuk ishin të përjashtuara nga dhuna në familje thjesht për faktin se ishin me arsim të lartë (shih Shtojcën, Tabelat 23 dhe 24).

**Figura 4.17.** Niveli arsimor i grave sipas llojeve të dhunës në familje (aktuale)




*Shënim:* Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

## Statusi i punësimit të grave dhe dhuna në familje

U kryen analiza për të shqyrtuar marrëdhënien midis statusit të punësimit të grave dhe dhunës në familje. Figura 4.18 tregon se gratë që nuk punojnë jashtë shtëpisë (64,2%) kishin shumë më tepër gjasa të kishin përjetuar “gjatë jetës” dhunë në familje të të gjitha llojeve krahasuar me gratë që punojnë jashtë shtëpisë (52,9%); megjithatë, gratë me leje lindjeje (77,9% ose 3 në 4 gra) kishin më shumë gjasa të kishin përjetuar “gjatë jetës” të gjitha llojet e dhunës në familje. Megjithatë, duhet pasur parasysh se gratë me leje lindjeje përbënin vetëm 0,8% të kampionit.


Më konkretisht, gratë që nuk punojnë jashtë shtëpisë kishin shumë më tepër gjasa të kishin përjetuar “gjatë jetës” dhunë psikologjike (63,2%), dhunë fizike (26,3%), dhe dhunë seksuale (9,7%), krahasuar me gratë që punojnë jashtë shtëpisë (përkatësisht 35,4%, 19,9%, dhe 5,5%). Po kështu, gratë me leje lindjeje kishin më shumë gjasa të kishin përjetuar “gjatë jetës” dhunë psikologjike (75,8%), dhunë fizike (44,2%), dhe dhunë seksuale (10,1%; shih Shtojcën, Tabelat 25 dhe 26).

**Figura 4.18.** Statusi i punësimit të grave sipas llojeve të dhunës në familje (gjatë jetës)

Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

Figura 4.19 tregon marrëdhënien ndërmjet statusit të punësimit të grave dhe përvojave të tyre "aktuale" (brenda 12 muajsh para intervistës) me dhunën në familje. Kjo shifër tregon se gratë që nuk punojnë jashtë shtëpisë (58,8%) kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin "aktualisht" dhunë në familje, të të gjitha llojeve, krahasuar me gratë që punojnë jashtë shtëpisë (46,7%); megjithatë, gratë me leje lindjeje (73,5%, ose tri nga katër) kishin më shumë gjasa të përjetonin "aktualisht" të gjitha llojet e dhunës në familje (brenda 12 muajsh para intervistës). Ky rezultat tregon se dhuna në familje është një realitet më se i vërtetë në jetën e grave shtatzëna dhe të grave me foshnja të sapolindura.

Më në veçanti, gratë që nuk punojnë jashtë shtëpisë kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin "aktualisht" dhunë psikologjike (58,1%), dhunë fizike (16,0%), dhe dhunë seksuale (6,5%), krahasuar me gratë që punojnë jashtë shtëpisë (përkatësisht 45,6%, 12,6%, dhe 3,1%). Po kështu, gratë me leje lindjeje kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë psikologjike (75,8%, ose tre të katërtat), dhunë fizike (38,8%, ose më shumë se një e treta), dhe dhunë seksuale (7,2%; shih Shtojcën Tabelat 25 dhe 26). Përsëri, këto rezultate janë shumë domethënëse, sepse tregojnë që periodha e shtatzënisë dhe menjëherë pas saj, janë periodha me rrezikshmëri të lartë për gratë (46).

**Figura 4.19.** Statusi i punësimit të grave sipas llojeve të dhunës në familje (aktualisht)


Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

## Vendbanimi i grave (urban kundrejt rural) dhe dhuna në familje

U krye gjithashtu një analizë për të kuptuar nëse kishte dallime midis grave që jetonin në zona urbane kundrejt atyre që jetonin në zona rurale në lidhje me përvojat e tyre me dhunën në familje. Figura 4.20 tregon se gratë në zonat rurale (66,9%, ose dy të tretat) kishin shumë më tepër gjasa të kishin përjetuar dhunë në familje të të gjitha llojeve “gjatë jetës”, krahasuar me gratë në zonat urbane (53,0%, ose më

shumë se gjysma e tyre). Më konkretisht, gratë në zonat rurale kishin shumë më tepër gjasa të përjetuar përjetonin dhunë psikologjike (65,3%), dhunë fizike (27,2%), dhe dhunë seksuale (9,1%) “gjatë jetës”, krahasuar me gratë në zonat urbane (përkatësisht 52,1%, 20,7%, dhe 6,8%; shih Shtojcën, Tabelat 27 dhe 28).

**Figura 4.20.** Vendbanimet e grave (urbane kundrejt rurale) sipas llojeve të dhunës në familje (gjatë jetës)




*Shënim:* Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

Figura 4.21 tregon se gratë në zonat rurale (60,8%) kishin gjithashtu shumë më tepër gjasa të përjetonin “aktualisht” dhunë në familje të të gjitha llojeve, krahasuar me gratë në zonat urbane (47,6%). Gratë në zonat rurale kishin shumë

më tepër gjasa të përjetonin dhunë psikologjike (59,6%), dhunë fizike (17,6%), dhe dhunë seksuale “aktualisht” (5,9%), krahasuar me gratë në zonat urbane (përkatësisht 47,0%, 12,2%, dhe 4,3%; shih Shtojcën, Tabela 27 dhe 28).

**Figura 4.21.** Vendbanimet e grave (urbane kundrejt rurale) sipas llojeve të dhunës në familje (aktuale)



*Shënim:* Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

## DHUNA E USHTRUAR NGA ANËTARË TË TJERË TË FAMILJES

Dhuna në familje ndaj grave nuk ushtrohet vetëm nga bashkëshortët/partnerët; shpesh, anëtarë të tjerë të familjes, (p.sh. prindër, vëllezër, motra, njerëzit e burrit dhe të afërm të tjerë) kryejnë akte dhune fizike ndaj grave dhe vajzave. Si pjesë e vërtetimit, gratë u pyetën nëse ishin goditur, goditur me shuplakë, me shkelm, apo lënduar fizikisht që nga mosha 15-vjeçare nga anëtarë të tjerë të familjes.

Tabela 4.11 tregon se vetëm 6,9% e grave të anketuara raportuan se që nga mosha 15 vjeçare, ishin goditur, goditur me shuplakë, shkelm, apo lënduar fizikisht nga një person tjetër që nuk ishte bashkëshorti/partneri i tyre. Kur u pyetën se cilët anëtarë të familjes i kishin keqtrajtuar, 4,1% e grave/vajzave thanë babai/njerku, 3,6% thanë nëna/njerka, dhe 2,3% thanë vëllai/motra. Disa gra/vajza identifikuan edhe persona të tjerë të afërt dhe të familjes së burrit, si dhe mësues dhe policë/ushtarë, si personat që i kishin dhunuar ato fizikisht, megjithatë, përqindjet ishin të vogla.

U bënë analiza për të shqyrtuar marrëdhënien midis viktimizimit të grave nga anëtarë të tjerë të familjes dhe dhunës në familje në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Tabela 4.12 tregon se gratë/vajzat që janë dhunuar fizikisht nga një person tjetër përveç bashkëshortit të tyre që nga mosha 15 vjeçare kishin më tepër gjasa të raportonin përjetime të dhunës në familje "gjatë jetës" (93,8%) dhe "aktualisht" (86,4%), krahasuar me gratë që nuk ishin dhunuar fizikisht nga një person tjetër që nuk ishte bashkëshorti i tyre që nga mosha 15 vjeçare (përkatesisht 56,8% dhe 51,1%). Si pasojë, shumë gra të dhunuara pësojnë forma të shumëfishta viktimizimi nga persona që janë ose jo anëtarë të familjeve të tyre gjatë jetës. Përvojat

**Tabela 4.11.** Përvojat e grave/vajzave me dhunën fizike nga anëtarë të familjes

|                                                                                                                                        | N=739 758 |     |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-----|
|                                                                                                                                        | n         | %   |
| <b>Që nga mosha 15-vjeçare dikush përveç bashkëshortit/partnerit ju ka goditur, goditur me shuplakë, shkelm, ose lënduar fizikisht</b> | 50 903    | 6,9 |
| <b>Anëtarë të tjerë të familjes që i kanë dhunuar gratë fizikisht:</b>                                                                 |           |     |
| Nëna/njerka                                                                                                                            | 26 294    | 3,6 |
| Babai/njerku                                                                                                                           | 30 625    | 4,1 |
| Motra/vëllai                                                                                                                           | 17 340    | 2,3 |
| Djali/vajza                                                                                                                            | 383       | 0,1 |
| Të afërm të tjerët                                                                                                                     | 592       | 0,1 |
| Vjehrra                                                                                                                                | 1 227     | 0,2 |
| Vjehri                                                                                                                                 | 1 337     | 0,2 |
| Kunati                                                                                                                                 | 124       | 0,1 |
| Mësuesi/mësuesja                                                                                                                       | 2 703     | 0,4 |
| Polic/ushtar                                                                                                                           | 124       | 0,1 |
| Person i panjohur                                                                                                                      | 157       | 0,1 |

e grave dhe vajzave me dhunën nga prindërit, vëllezërit dhe motrat, dhe/ose anëtarë të tjerë të familjes përpara martesës, ka shumë gjasa që ta shtojnë rrezikun që ato të viktimizohen nga bashkëshorti/partneri i tyre dhe/ose njerëzit e burrit pas martesës.

**Tabela 4.12.** Përvojat e grave me dhunën fizike të ushtruar nga anëtarë të tjerë të familjes, sipas përvojave "gjatë jetës" dhe "aktualisht" me dhunën në familje

|                                                                                                                                                    | N=646 878   |                   |            |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|-------------------|------------|-------------------|
|                                                                                                                                                    | Gjatë jetës |                   | Aktualisht |                   |
|                                                                                                                                                    | n           | %                 | n          | %                 |
| <b>Që nga mosha 15 vjeçare dikush tjetër që nuk është bashkëshorti/ partneri ju ka goditur, goditur me shuplakë, shkelm, ose lënduar fizikisht</b> |             |                   |            |                   |
| <b>Po</b>                                                                                                                                          | 39 582      | 93,8 <sup>a</sup> | 36 445     | 86,4 <sup>a</sup> |
| <b>Jo</b>                                                                                                                                          | 340 111     | 56,8              | 306 392    | 51,1              |

*Shënim:* Frekuencat dhe krahasimet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

Vlera e  $\chi^2 < .01$



## NDIKIMI I DHUNËS NË FAMILJE TEK FËMIJËT

Fëmijët janë shpesh viktimë të harruara të dhunës në familje ndaj grave, por, në fakt, fëmijët shpesh janë dëshmitarë të dhunës ose e dinë se po ndodh dhunë në shtëpi sepse dëgjojnë britmat dhe grindjet, shohin lëndimet dhe dëmet materiale të shkaktuara. Përveç kësaj, fëmijët e të gjitha moshave, por sidomos fëmijët e vegjël, janë mjaft të rrezikuar nga dhuna në familje dhe mund të lëndohen ose drejtpërdrejt ose tërthorazi nga dhuna në shtëpinë e tyre (47, 48). Edhe nëse nuk janë viktimë të drejtpërdrejta të dhunës në familje, fëmijët shpesh vuajnë nga të njëjtat probleme të sjelljes dhe probleme psikologjike si fëmijët e dhunuar dhe ata të lënë pas dore (49, 50). Në veçanti, fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në shtëpinë e tyre shpesh vuajnë nga probleme fizike, shoqërore dhe zhvillimore

(p.sh., probleme të të nxënës, aftësi shoqërore të kufizuara, depresioni ose ankthi i skajshëm, dhe/ose shfaqin sjellje të dhunshme, të rrezikshme ose të paligjshme).

Gratë që kanë përjetuar dhunë në familje “gjatë jetës” u pyetën nëse dhuna në familje ndikonte tek fëmijët. Ndër gratë që mendonin se dhuna në familje ndikonte tek fëmijët e tyre, 86,4% e grave mendonin se fëmijët ishin dëshmitarë të dhunës në familje, 42,8% thanë se dhuna në familje kishte shkaktuar probleme të të nxënës tek fëmijët e tyre, 31,2% thanë se fëmijët e tyre jetonin me frikë, 19,2% thanë se fëmijët ishin lënduar ose dëmtuar për shkak të dhunës në familje dhe 5,5% thanë se fëmijët e tyre ishin larguar nga shtëpia për të jetuar me të afërm të tjerë, për shkak të dhunës në familje.

**Tabela 4.13.** Ndikimi i dhunës në familje tek fëmijët

|                                                                                        | N=646 878 |      |
|----------------------------------------------------------------------------------------|-----------|------|
|                                                                                        | n         | %    |
| <b>Dhuna në familje ka ndikuar tek fëmijët e mi</b>                                    | 24 409    | 14,0 |
|                                                                                        | N=646 878 |      |
|                                                                                        | n         | %    |
| Fëmijët kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje                                      | 21 096    | 86,4 |
| Fëmijët jetojnë me frikë                                                               | 7 605     | 31,2 |
| Fëmijët u lënduan ose dëmtuan                                                          | 4 682     | 19,2 |
| Fëmijët kanë ikur nga shtëpia për të jetuar me të afërm për shkak të dhunës në familje | 1 349     | 5,5  |
| Dhuna në familje u ka shkaktuar fëmijëve të mi probleme të të nxënës                   | 10 450    | 42,8 |

Tabela 29 tek Shtojca tregon se gratë që kishin përjetuar “gjatë jetës” dhunë seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime (19,6%) kishin më shumë gjasa të besonin se dhuna në familje kishte ndikuar tek fëmijët e tyre, krahasuar me gratë që kishin pësuar dhunë psikologjike (14,5%) apo fizike (14,4%). Në fakt, 49,9% e grave që kishin përjetuar

dhunë seksuale “gjatë jetës” thanë se fëmijët e tyre jetonin me frikë, 22,3% thanë se fëmijët e tyre ishin lënduar ose dëmtuar si rezultat i dhunës në familje, dhe 57,1% thanë se dhuna në familje u kishte shkaktuar fëmijëve të tyre probleme në të nxënës.

## SJELLJET E GRAVE TË DHUNUARA NË KËRKIMIN E NDIHMËS

Gratë e dhunuara shpesh ngurrojnë të kërkojnë ndihmë për dhunën në familje. Në fakt, Tabela 4.14 tregon se vetëm 8,4% e grave që kishin përjetuar dhunë në familje “gjatë jetës”, dhe 7,1% e atyre që po përjetonin “aktualisht” dhunë në familje kishin kërkuar ndonjëherë ndihmë për dhunën në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Kjo shifër tregon se shumica e grave të dhunuara në Shqipëri vazhdojnë të vuajnë në heshtje me gjithë përpjekjet e vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin publik për problemet e dhunës në familje dhe shërbimet legjislative dhe sociale të krijuara rishtas për viktimat e dhunës në familje. Kështu, gratë e dhunuara nuk po marrin mbrojtjen, shërbimet e

mbështetjes, dhe qasjen në drejtësi që është e drejta e tyre ligjore dhe njerëzore.

Arsyet pse gratë e dhunuara nuk kërkojnë ndihmë për dhunën në familje janë të shumta, ndër të cilat:

- ato nuk besojnë se mund të përmirësohet gjë;
- ato nuk dinë ku të kërkojnë ndihmë; kanë frikë se po të raportojnë, kjo mund t'i dëmtojë emrin e mirë familjes;
- ato kanë frikë se dhunuesi(t) do t'i rrahin edhe më shumë;
- ato mendojnë, ose e dinë nga përvoja, se do t'ju vihet

faji për viktimizimin e tyre;

- ato kanë frikë se po të kërkojnë ndihmë, kjo do të çojë në zgjidhjen e martesës ose do t'i japë fund martesës/marrëdhënies;
- ato mendojnë se nuk do t'u besojnë e nuk do t'i marrin seriozisht, madje edhe mund t'i përqeshin;
- ato kanë frikë se do të humbin fëmijët dhe e perceptojnë dhunën si pjesë normale të martesës, prandaj nuk kanë arsye të ankohen;
- ato nuk ndihen të qeta kur kërkojnë ndihmë sepse aftësitë e tyre për të kuptuar të drejtat e tyre ligjore janë të kufizuara.

Është e rëndësishme të kuptohet se kur gratë e ndërmarrin hapin për të kërkuar ndihmë për dhunën në familje,

shumica e tyre e kërkojnë atë në familje. Tabela 4.14 tregon se shumica e grave të dhunuara "gjatë jetës" dhe "aktualisht" që kanë kërkuar ndihmë, e kanë kërkuar këtë nga familja e tyre (përkatesisht 91,8% dhe 89,5%) dhe/ose nga familja e bashkëshortit/partnerit (përkatesisht 60,9% dhe 58,7%). Një pjesë e mirë e grave të dhunuara "gjatë jetës" dhe "aktualisht" gjithashtu kanë kërkuar ndihmë nga shoqëria (përkatesisht 29,0% dhe 27,5%). Vetëm një përqindje e vogël e grave të dhunuara "gjatë jetës" dhe "aktualisht" kanë kërkuar ndihmë nga një mjek/punonjës i shëndetësisë (përkatesisht 14,8% dhe 15,6%), policia (përkatesisht 16,8% dhe 14,1%), avokat (përkatesisht 14,8% dhe 7,8%), apo gjykatës (përkatesisht 11,2% dhe 6,2%). Po kështu, vetëm 11,2% e grave të dhunuara "gjatë jetës" dhe 1,1% e atyre të dhunuara "aktualisht" kishin kërkuar ndihmë nga shërbimet sociale.

**Tabela 4.14.** Sjelljet e viktimave të dhunës në familje në kërkimin e ndihmës

|                                                                               | N=384 372       |      | N=384 372       |      |
|-------------------------------------------------------------------------------|-----------------|------|-----------------|------|
|                                                                               | Gjatë jetës     |      | Aktualisht      |      |
|                                                                               | n               | %    | n               | %    |
| Është përpjekur ndonjëherë të kërkojë ndihmë për të ndaluar dhunën në familje | 14 570          | 8,4  | 11 373          | 7,1  |
| <b>Kush kërkoi ndihmë nga:</b>                                                | <b>N=14 570</b> |      | <b>N=11 373</b> |      |
| Familja e tyre                                                                | 13 370          | 91,8 | 10 174          | 89,5 |
| Familja e bashkëshortit/partnerit                                             | 8 877           | 60,9 | 6 674           | 58,7 |
| Ish bashkëshorti/partneri                                                     | 851             | 5,8  | 558             | 4,9  |
| Ish i dashuri                                                                 | 434             | 3,0  | 434             | 3,8  |
| Shoqet/shokët                                                                 | 4 232           | 29,0 | 3 127           | 27,5 |
| Të afërm të tjerë                                                             | 2 880           | 19,8 | 1 972           | 17,3 |
| Udhëheqës fetarë                                                              | 0               | ,0   | 0               | ,0   |
| Mjek/personel shëndetësor                                                     | 2 161           | 14,8 | 1 772           | 15,6 |
| Policia                                                                       | 2 443           | 16,8 | 1 603           | 14,1 |
| Avokat                                                                        | 2 151           | 14,8 | 882             | 7,8  |
| Gjykatës                                                                      | 1 638           | 11,2 | 711             | 6,2  |
| Shërbimet sociale                                                             | 1 634           | 11,2 | 129             | 1,1  |

Tabela 30 tek Shtojca tregon se gratë që kanë përjetuar dhunë fizike (9,2%) dhe/ose dhunë seksuale (12,2%) "gjatë jetës" kishin më shumë gjasa të kërkonin ndihmë në krahasim me gratë që kishin përjetuar dhunë psikologjike "gjatë jetës" (3,8%). Po kështu, gratë që po përjetonin dhunë fizike (7,7%) dhe/ose dhunë seksuale (7,1%) "aktualisht" kishin më shumë gjasa të kërkonin ndihmë në krahasim me gratë që po përjetonin dhunë psikologjike "aktualisht" (3,3%). Këto shifra tregojnë se lloji i dhunës në familje që përjetojnë gratë, dhe sidomos ashpërsia e dhunës, ndikon tek gatishmëria e grave për të kërkuar ndihmë. Megjithatë, shenjat e dhunës psikologjike tek gratë e dhunuara janë të vërteta dhe shpesh shumë të thella; për këtë arsye, gratë e dhunuara psikologjikisht shpesh e kanë të vështirë të kërkojnë ndihmë, të shohin opsionet që kanë përpara, dhe të organizojnë burimet që u duhen për t'u larguar nga


marrëdhënia dhunuese. Për më tepër, dhuna psikologjike zakonisht përqësohet me kalimin e kohës dhe, në shumë raste, përshkallëzohet në dhunë fizike.

Viktimat e dhunës në familje që kanë kërkuar ndihmën e shërbimeve shëndetësore dhe/ose ligjore u pyetën nëse u është dashur ndonjëherë të paguajnë (qoftë edhe para nën dorë) për ndonjë nga shërbimet shëndetësore /ligjore që u është ofruar. Gratë u pyetën se sa u ishte dashur të paguanin në lekë të vjetra, për shërbimet mjekësore dhe/ose ligjore nga mjekët/personeli mjekësor, policia, avokatët dhe gjykatësit. Figura 4.22 tregon se shumica e grave që kishin kërkuar ndihmë nga shërbimet mjekësore dhe/ose ligjore për dhunën në familje kishin paguar më pak se 1 mijë lekë të vjetra (<1 USD). Një pjesë e mirë e grave që kishin kërkuar ndihmë nga mjekët dhe avokatët po kështu kishin paguar 1 mijë-10 mijë lekë të vjetra (1-10 USD), dhe 18,7% e viktimave

të dhunës në familje që kishin kërkuar ndihmë nga gjykatësit dhe 21,3% që kishin kërkuar ndihmë nga avokatët kishin paguar 11 mijë-30 mijë lekë të vjetra (11-30 USD). Për shumë gra të dhunuara, pagesat për këto shërbime (edhe në para

nën dorë) përbëjnë barrierë të konsiderueshme në aftësinë e tyre për të pasur qasje në shërbimet shëndetësore dhe ato të mbrojtjes dhe mbështetjes, si dhe qasje në drejtësi (shih edhe Shtojcën, Tabela 31).

**Figura 4.22.** Sasia e parave që është dashur të paguajnë viktimat e dhunës në familje për shërbime të përkujdesit shëndetësor dhe shërbime ligjore



Shënim: Përqindjet janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë

Ndonëse vetëm 3,8% e grave të dhunuara “gjatë jetës” kishin kërkuar ndihmë për dhunën në familje, u bë analizë për të përcaktuar nëse karakteristikat demografike (p.sh., niveli arsimor i grave, mosha, gjendja e punësimit, dhe vendbanimi urban kundrejt atij rural) kishin ndikim në sjelljet e grave për kërkimin e ndihmës. Tabela 4.15 tregon se gratë në grupmoshat 35-44 vjeç (9,4%) dhe 45-55 vjeç (8,0%) kishin më shumë gjasa të kërkonin ndihmë për dhunën në familje, krahasuar me gratë në grupmoshat 18-24 vjeç (4,3%) dhe 25-34 vjeç (5,8%; shih edhe Shtojcën, Tabela 32).

Për sa i përket arsimit, gratë me arsim fillor ose më të ulët (12,4%) kishin më shumë gjasa të kërkonin ndihmë për dhunën në familje, krahasuar me gratë me arsim tetëvjeçar (8,3%), arsim të mesëm/profesional (7,4%), or ose arsim universitar/pasuniversitar (2,2%). Çuditërisht, gratë me arsim universitar/pasuniversitar kishin shumë më pak gjasa të kërkonin ndihmë për dhunën në familje (shih edhe Shtojcën, Tabela 32).

Për sa i përket gjendjes së punësimit, Tabela 4.15 tregon se gratë që nuk punonin jashtë shtepisë (10,3%) kishin më shumë gjasa të kërkonin ndihmë për dhunën në familje, krahasuar me gratë që punonin jashtë shtepisë (3,8%). Çuditërisht, ndonëse gratë me leje lindjeje kishin më shumë gjasa të përjetonin “aktualisht” dhunë në familje asnjë grua me leje lindjeje nuk kishte kërkuar ndihmë për

**Tabela 4.15.** Sjelljet e grave të dhunuara në kërkim të ndihmës sipas demografisë së grave

|                               | Ka kërkuar ndihmë për dhunë në familje |      |
|-------------------------------|----------------------------------------|------|
|                               | n                                      | %    |
| <b>Mosha</b>                  |                                        |      |
| 18-24 vjeç                    | 489                                    | 4,3  |
| 25-34 vjeç                    | 2 437                                  | 5,8  |
| 35-44 vjeç                    | 5 886                                  | 9,4  |
| 45-55 vjeç                    | 5 759                                  | 8,0  |
| <b>Niveli arsimor</b>         |                                        |      |
| Fillor ose më i ulët (4 vjet) | 1 026                                  | 12,4 |
| Tetëvjeçar                    | 8 139                                  | 8,3  |
| I mesëm/profesional           | 4 723                                  | 7,4  |
| Universitar/pasuniversitar    | 293                                    | 2,2  |
| <b>Gjendja e punësimit</b>    |                                        |      |
| Punon jashtë shtepisë         | 2 569                                  | 3,8  |
| Me leje lindjeje              | 0                                      | 0,0  |
| Nuk punon jashtë shtepisë     | 12 001                                 | 10,3 |
| <b>Vendbanimi</b>             |                                        |      |
| Urban                         | 9 764                                  | 10,9 |
| Rural                         | 4 807                                  | 4,9  |

dhunën në familje. Kjo tregon se duhen bërë shumë më tepër përpjekje nga mjekët/punonjësit e shëndetësisë për të kontrolluar nëse gratë shtatzëna apo që sapo kanë lindur kanë pësuar dhunë në familje (shih edhe Shtojcën, Tabela 32).

Së fundi, Tabela 4.15 tregon gjithashtu se gratë në zonat urbane (10,9%) kishin shumë më tepër gjasa të kërkonin ndihmë për dhunën në familje, se sa gratë në zonat rurale (4,9%). Në zonat rurale ku shërbimet për mbështetjen e viktimave ose nuk ekzistojnë, ose janë të kufizuara, gratë e dhunuara kanë më tepër gjasa të kenë një ndjenjë izolimi

dhe më pak gjasa të marrin ndihmën për të cilën kanë aq shumë nevojë (shih edhe Shtojcën, Tabela 31).

Tabelat 4.14 dhe 4.15, së bashku me Figurën 4.22, tregojnë se shumica e viktimave të dhunës në familje e kanë të vështirë të kërkojnë ndihmë, të shqyrtojnë opsionet që kanë dhe të organizojnë burimet që u duhen për të pasur qasje në shërbimet shëndetësore, ligjore dhe ato të mbështetjes, dhe për t'u larguar nga martesë/marrëdhënia dhunuese, pavarësisht nga moshë, niveli arsimor, gjendja e punësimit, dhe/ose vendbanimi (urban kundrejt rural).

## INTERVISTAT E NDËRPRERA

Në fund të intervistës, intervistuesve iu kërkua të raportonin nëse u ishte dashur ta ndërprisnin intervistën për shkak se bashkëshorti apo një anëtar tjetër i rritur i familjes po përpiqej të dëgjonte çfarë po thuhej, kishte hyrë në dhomë, apo kishte ndërhyrë në ndonjë mënyrë tjetër në intervistë. Tabela 4.16 tregon se 17,3% e intervistuesve raportuan se intervista ishte ndërprerë nga bashkëshorti apo një anëtar tjetër i rritur i familjes. Më konkretisht, 7,7% e intervistuesve raportuan se intervista ishte ndërprerë nga bashkëshorti i gruas, 5,3% raportuan se intervista ishte ndërprerë nga një mashkull tjetër i rritur, ndërsa 11,2% raportuan se intervista ishte ndërprerë nga një femër në moshë të rritur.


Mund të supozohet se gratë që ishin viktimat të dhunës në familje kishin më shumë gjasa që intervista e tyre të ndërpritej nga bashkëshorti apo anëtar tjetër i rritur i familjes. Në fakt, Figura 4.23 tregon se gratë që kishin përjetuar dhunë në familje "gjatë jetës" (24,0%) dhe po përjetonin "aktualisht" dhunë në familje (24,2%) kishin më shumë gjasa t'u ndërpritej intervista nga bashkëshorti ose anëtarë të tjerë të rritur të familjes, krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar asnjëherë dhunë në familje (9,2%; shih edhe Shtojcën, Tabela 33).

**Tabela 4.16.** Intervistat e ndërprera

|                                                                                    | n       | %    |
|------------------------------------------------------------------------------------|---------|------|
| <b>Intervista u ndërpre nga bashkëshorti apo anëtar tjetër i rritur i familjes</b> | 127 803 | 17,3 |
| Bashkëshorti                                                                       | 56 753  | 7,7  |
| Mashkull tjetër i rritur                                                           | 39 143  | 5,3  |
| Femër e rritur                                                                     | 82 623  | 11,2 |

Teksa Tabela 4.16 tregon se 17.3% e intervistuesve raportuan se intervista ishte ndërprerë nga bashkëshorti ose një i rritur tjetër në familje, dhe Figura 4.22 tregon se pjesa më e madhe e këtyre grave kishin përjetuar dhunë në familje, këto gjetje duhen interpretuar se të paktën 17.3% e grave mund të kenë nënraportuar natyrën dhe shkallën e dhunës që mund të kenë përjetuar, lëndimet që kanë ardhur si pasojë e kësaj dhune si dhe/ose vullnetin e tyre për të kërkuar ndihmë, nga frika se një anëtar i familjes mund të kishte qenë duke përgjuar.

**Figura 4.23.** Intervistat e ndërprera, sipas përvojave të grave me dhunën në familje



## REFERENCA

1. US Department of Justice, *Office on Violence Against Women* (Departamenti i Drejtësisë i SHBA, Zyra e Dhunës ndaj Grave). Marrë më 11 mars 2009 nga <http://www.ovw.usdoj.gov/domviolence.htm>
2. Garcia-Moreno, C., H. Jensen, M. Ellsberg, L. Heise & C. Watts (2005). *WHO Multi-Country Study on Women's Health and Domestic Violence Against Women*. (Studim shumë-vendësh i OBSH mbi Shëndetin e Grave dhe Dhunën në familje) Geneva, Switzerland: WHO.
3. Haarr, R.N. & Dharmo (2009). *Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtim Kombëtar me Bazë Popullatën*. Tiranë, Shqipëri: UNDP.
4. OBSH (2013). *Global and Regional Estimates of Violence Against Women: Prevalence and Health Effects of Intimate Partner Violence and Non-Partner Sexual Violence* (Vlerësime globale dhe rajonale të dhunës ndaj grave: përhapja dhe pasojat shëndetësore të dhunës nga partnerët dhe dhunës seksuale nga jo-partnerët). Geneva, Switzerland: WHO.
5. Paulo Sergio Pinheiro (2006). *World Report on Violence against Children* (Raport Botëror mbi Dhunën ndaj fëmijëve). Geneva, Switzerland: UNICEF.
6. Paulo Sergio Pinheiro, 2006.
7. Holt, S., H. Buckley & S. Whelan (2008). *The Impact of Exposure to Domestic Violence on Children and Young people: A Review of the Literature* (Ndikimi i ekspozimit ndaj dhunës në familje tek fëmijët dhe të rinjtë: Pasqyrë e literaturës). *Child Abuse & Neglect*, Vol. 32, No. 8, f. 797-810.
8. Moylan et al. (2009). *The Effects of Child Abuse and Exposure to Domestic Violence on Adolescent Internalizing and Externalizing Behavior Problems* (Ndikimi i dhunimit dhe ekspozimit të fëmijëve ndaj dhunës në familje mbi problemet e sjelljes internalizuese dhe eksternalizuese tek adoleshentët). *Journal of Family Violence*, 25, f. 53-63.
9. Paulo Sergio Pinheiro, 2006.
10. Sackett & Saunders (1999). *The Impact of Different Forms of Psychological Abuse on Abused Women* (Ndikimi i formave të ndryshme të dhunës psikologjike tek gratë). *Violence and Victims*, 14(1), f. 105-117.
11. Garcia-Moreno, 2005.
12. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
13. Sackett & Saunders, 1999.
14. Garcia-Moreno, 2005.
15. Sackett & Saunders, 1999.
16. Garcia-Moreno, 2005.
17. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
18. Abraham (2002). *Speaking the Unspeakable: Wife Abuse among South Asian Immigrants in the United States* (Të thuash të pathënshmen: dhunimi i bashkëshorteve ndër imigrantët aziatikë në Shtetet e Bashkuara). Rutgers, NJ: Rutgers University Press.
19. Bennice & Resick (2003). *Marital Rape: History, Research and Practice* (Përdhunimi bashkëshortor: historiku, studime kërkimore dhe praktika). *Trauma, Violence and Abuse*, Vol. 4, f. 228-246.
20. Bergen (2006). *Marital Rape: New Research and Directions* (Përdhunimi bashkëshortor: studime dhe drejtime të reja). Marrë nga [http://new.vawnet.org/category/Main\\_Doc.php?docid=248](http://new.vawnet.org/category/Main_Doc.php?docid=248)
21. Haarr (2007). *Wife Abuse in Tajikistan* (Dhunimi i bashkëshorteve në Tashikistan). *Feminist Criminology*, Vol. 2, No. 3, f. 245-270.
22. Garcia-Moreno et al., 2005.
23. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
24. Garcia-Moreno et al., 2005.
25. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
26. Garcia-Moreno et al., 2005.
27. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
28. Garcia-Moreno et al., 2005.
29. Garcia-Moreno et al., 2005.
30. Haarr, R.N. & M. Dharmo (2009). *Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtim Kombëtar me Bazë Popullatën*. Tiranë, Shqipëri: UNDP.
31. Garcia-Moreno et al., 2005.
32. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
33. Garcia-Moreno et al., 2005.
34. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
35. Garcia-Moreno et al., 2005.
36. Haarr & Dharmo, 2009.
37. Garcia-Moreno et al., 2005.
38. Garcia-Moreno et al., 2005.
39. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
40. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
41. Garcia-Moreno et al., 2005.
42. Garcia-Moreno et al., 2005.
43. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.

44. *Myths about Alcohol and Domestic Violence* (Mitet për alkoolin dhe dhuna në familje). Marrë nga [http://www.stopvaw.org/Myths\\_About\\_Alcohol\\_and\\_Domestic\\_Violence.html](http://www.stopvaw.org/Myths_About_Alcohol_and_Domestic_Violence.html)
45. *Myths about Alcohol dhe dhuna në familje* (Mitet për alkoolin dhe dhunën në familje). Marrë nga [http://www.stopvaw.org/Myths\\_About\\_Alcohol\\_and\\_Domestic\\_Violence.html](http://www.stopvaw.org/Myths_About_Alcohol_and_Domestic_Violence.html)
46. Garcia-Moreno et al., 2005.
47. *Behind Closed Doors: The Impact of Domestic Violence on Children* (Pas dyerve të mbyllura: ndikimi i dhunës në familje tek fëmijët). Marrë nga [http://www.violencestudy.org/IMG/pdf/SVITH\\_report.pdf](http://www.violencestudy.org/IMG/pdf/SVITH_report.pdf)
48. Brown & Bzostek (2003). *Violence in the Lives of Children* (Dhuna në jetën e fëmijëve). Cross Currents, Issue 1, Child Trends Data Bank.
49. Pinheiro (2006). *World Report on Violence against Children* (Raport Botëror mbi Dhunën ndaj fëmijëve). Geneva, Switzerland: United Nations Publishing Services.
50. *Behind Closed Doors: The Impact of Domestic Violence on Children* (Pas dyerve të mbyllura: ndikimi i dhunës në familje tek fëmijët). Marrë nga [http://www.violencestudy.org/IMG/pdf/SVITH\\_report.pdf](http://www.violencestudy.org/IMG/pdf/SVITH_report.pdf)

# 5

## Përfundime







Studimet në mbarë botën kanë treguar se dhuna në familje është një nga llojet më të përhapura të dhunës së përdetuar nga gratë dhe fëmijët në pjesën më të madhe të vendeve në botë (1, 2, 3, 4). Në mënyrë të ngjashme, shifrat dhe rezultatet e këtij vërtetimi kombëtar me bazë popullatën, të vitit 2013 për dhunën në familje ndaj grave, së bashku me rezultatet e vërtetimit kombëtar me bazë popullatën të vitit 2007, konfirmojnë se dhuna në familje është problem i përhapur në familje dhe mbarë shoqërinë shqiptare (5). Duke pasur parasysh se vërtetimet kombëtare me bazë popullatën të viteve 2007 dhe 2013 për dhunën në familje ndaj grave përdorën metodologji dhe instrumente të ngjashme për mbledhjen e të dhënave, mund të bëhen krahasime. Këto krahasime do t'i japin mundësi qeverisë së Shqipërisë që të fillojë monitorimin e modeleve dhe tendencave të shfaqura me kalimin e kohës në natyrën dhe

shtrirjen e dhunës në familje ndaj grave dhe të faktorëve që kontribuojnë tek dhuna në familje, si dhe të shqyrtojë ndikimin e nismave më të fundit parandaluese, ndërhyrëse dhe mbrojtëse mbi karakterin dhe përhapjen e dhunës në familje. Të dhënat dhe rezultatet e vërtetimit të vitit 2013 mund të shërbejnë gjithashtu si informacion mbi të cilin të mbështeten reformat legjislativë dhe zhvillimi i politikave të mëtejshme, për t'i dhënë formë nismave parandaluese dhe ndërhyrëse, dhe për të përmirësuar mbrojtjen dhe mbështetjen për gratë dhe fëmijët që janë viktimat dhe të mbijetuar të dhunës në familje.

Në të gjithë këtë kapitull do të bëhen krahasime ndërmjet rezultateve të vërtetimeve kombëtare me bazë popullatën të viteve 2007 dhe 2013 për dhunën në familje ndaj grave në Shqipëri.

## DHUNA NË FAMILJE NDAJ GRAVE

Tabela 5.1 tregon se nga viti 2007 në vitin 2013, përqindja e grave që kishin përdetuar dhunë në familje "gjatë jetës" është rritur nga 56,0% në 59,4%. Në vitin 2007, pjesa e grave që po përdetonin dhunë "aktuale" në familje nuk u llogarit sepse nuk u bënë pyetje për dhunën "aktuale" për secilin nga llojet e dhunës të përfshirë në vërtetim (6).

Në vitin 2013, vërtetimit iu bënë përmirësime dhe gratë u pyetën për përvojat e tyre me secilin prej llojeve të

ndryshme të dhunës në familje të përfshirë në vërtetim, si "gjatë jetës" ashtu edhe "aktualisht" dhe, për pasojë, u bë e mundur të llogariteshin llojet e dhunës "aktuale" në familje. Tabela 5.1 tregon se 53,7% e grave po përdetonin "aktualisht" dhunë në familje në vitin 2013. Në të ardhmen do të jetë e rëndësishme të monitorohen tendencat "aktuale" të dhunës në familje ndaj grave dhe të krahasohen të dhënat e ardhshme me ato të vërtetimit të vitit 2013.

**Tabela 5.1.** Përqindja e grave që kishin pësuar dhunë në familje "gjatë jetës" (krahasime ndërmjet 2007 dhe 2013)

|                                        | 2007 – Gjatë jetës | 2013 – Gjatë jetës | 2013 - Aktualisht |
|----------------------------------------|--------------------|--------------------|-------------------|
| Dhuna në familje (të gjitha llojet)    | 56,0%              | 59,4%              | 53,7%             |
| Dhuna emocionale <sup>1</sup>          | 50,6%              | NA                 | NA                |
| Dhuna psikologjike                     | 39,1%              | 58,2%              | 52,8%             |
| Dhuna fizike                           | 31,2%              | 23,7%              | 14,7%             |
| Dhuna seksuale                         | 12,7%              | 7,9%               | 5,0%              |
| Dhuna fizike dhe seksuale <sup>2</sup> | NA                 | 24,6%              | 16,2%             |

<sup>1</sup> në vitin 2013, dhuna emocionale dhe psikologjike u bashkuan në një kategori të vetme gjatë analizës.

<sup>2</sup> në vitin 2007, nuk u llogaritën as dhuna fizike e as ajo seksuale.

Tabela 5.1 tregon gjithashtu se në vitin 2007, 50,6% e grave kishin përjetuar dhunë emocionale “gjatë jetës” dhe 39,1% kishin përjetuar dhunë psikologjike “gjatë jetës” (7). Në vitin 2013, kategoritë dhunë emocionale dhe dhunë fizike u shkrinë në një kategori të vetme – dhunë psikologjike. Në vitin 2013, 58,2% e grave kishin përjetuar dhunë psikologjike “gjatë jetës” dhe 52,8% po përjetonin dhunë në familje “aktualisht”. Dhuna psikologjike u nda më tej në katër lloje – dhunë verbale, kërcënime psikologjike, sjellje kontrolluese dhe dhunë ekonomike – gjë që bëri të mundur një analizim më të mirë të numrit të grave që kanë përjetuar secilin prej këtyre llojeve të dhunës psikologjike “gjatë jetës” dhe “aktualisht” (shih Tabelën 4.2).

Nga viti 2007 në vitin 2013, përqindja e grave që kishin pësuar dhunë fizike në familje “gjatë jetës” u ul nga 31,2% në 23,7% (8). Në vitin 2013 u mat edhe përqindja e grave që po përjetonin dhunë në familje “aktualisht” dhe u konstatua se 14,7% e grave po përjetonin dhunë fizike “aktualisht”. Në vitin 2013, dhuna fizike u nda më tej në katër lloje të ndryshme – dhunë fizike e moderuar, dhunë fizike e rëndë, dhunë fizike me armë dhe dhunë fizike me

lëndime të rënduara – që bënë të mundur një analizim më të mirë të numrit të grave që kanë përjetuar secilin prej këtyre llojeve të dhunës fizike (shih Tabelën 4.3).

Së fundi, Tabela 5.1 tregon se nga viti 2007 në vitin 2013, përqindja e grave që kishin përjetuar dhunë seksuale në familje “gjatë jetës” u ul nga 12,7% të 7,9% (9). Po kështu, në vitin 2013, përqindja e grave që po përjetonin dhunë seksuale “aktualisht” ishte 5,0%. Në vitin 2013 u llogarit gjithashtu edhe përqindja e grave që kishin përjetuar si dhunë fizike ashtu edhe dhunë seksuale “gjatë jetës” dhe “aktualisht”, që tregoi se 24,6% e grave kishin përjetuar si dhunë fizike, ashtu edhe dhunë seksuale “gjatë jetës”, dhe 16,2% po përjetonin si dhunë fizike ashtu edhe dhunë seksuale “aktualisht”.

Në të ardhmen, do të jetë e rëndësishme që të monitorohen tendencat e dhunës në familje “gjatë jetës” dhe “aktualisht”, në përgjithësi, si dhe për çdo lloj të dhunës psikologjike, fizike dhe seksuale ndaj grave, si dhe të krahasohen të dhënat e vrojtimeve të ardhshme me ato të vërtetimit të vitit 2013.

## LLOJET E SHUMËFISHTA TË DHUNËS NË FAMILJE

Është e mirë-dokumentuar se në vitet 2007 dhe 2013 gratë kanë përjetuar lloje të shumfishta dhune në familje në martesën/marrëdhënien e tyre intime, ndër të cilat edhe forma të shumfishta të dhunës psikologjike, fizike, dhe seksuale (10). Në vitin 2013, analizë më e përmirësuar tregoi se ndër 59,4% të grave që kishin përjetuar dhunë në familje, 35,9% kishin përjetuar vetëm një nga llojet e dhunës në familje – dhunë psikologjike, fizike ose seksuale

– në martesë/marrëdhënien e tyre intime, 16,7% kanë përjetuar dy nga këto lloje të dhunës në familje, dhe 6,8% kishin përjetuar çdonjërin prej këtyre tre llojeve të dhunës në familje (shih Figurën 4.5). Në vitet 2007 dhe 2013, analiza tregoi gjithashtu se ekzistonte një marrëdhënie e konsiderueshme ndërmjet të tre llojeve të dhunës në familje (shih Tabelën 4.5) (11).

## KUR FILLON DHUNA NË FAMILJE NË MARTESË

Në vitin 2007, u konstatua se nga 45% deri në 56% të grave që kishin përjetuar dhunë në familje (në varësi të llojit të dhunës) raportuan se dhuna kishte filluar brenda vitit të parë të martesës/bashkëjetesës me partnerin e tyre. Më tej, një grup prej 31% deri 36% e grave raportuan se dhuna në familje (në varësi të llojit të dhunës) kishte filluar në vitin e dytë dhe të tretë të martesës/bashkëjetesës së tyre. Si rrjedhojë, nga mbledhja e këtyre dy rasteve, del që nga 82% deri në 88% e grave raportuan se dhuna në familje kishte filluar brenda tre viteve të para të martesës/bashkëjetesës (12).

Në vitin 2013, u konstatua që 27,6% e grave raportuan se dhuna kishte filluar brenda vitit të parë të martesës, ndërsa 50,2% thanë se ajo kishte filluar në vitin e 2-të dhe të 3-të të martesës. Pra, 77,8% e grave thanë se dhuna kishte filluar brenda tre viteve të para të martesës (shih Tabelën 4.6). Pavarësisht nga disa dallime ndërmjet viteve 2007 dhe 2013, shumë nga gratë kishin jetuar me dhunën në martesë dhe në familje për 10 deri në 30 vjet (13).

## LËNDIMET E SHKAKTUARA NGA DHUNA NË FAMILJE

Në vitet 2007 dhe 2013, gratë e dhunuara treguan se kishin pësuar shpesh lëndime të shkallëve të ndryshme të shkaktuara nga dhuna në familje. Në veçanti, në vitin 2007, 48,3% e grave që kishin përjetuar dhunë në familje thanë se kishin pësuar çarje/prerje, të nxira, apo dhimbje; 18,1% kishin pësuar lëndime në sy, djegie, ndrydhje ose nxjerrje të kyçeve ose eshtrave; 5,4% kishin pasur humbje ndjenjash; dhe 1% kishin plagë të thella, eshtra të thyera, dhëmbë të thyer ose lëndime të rënda (14).

Në krahasim me këtë, në vitin 2013, vetëm 18,8% e grave të dhunuara fizikisht "gjatë jetës" raportuan se kishin pësuar lëndime të shkaktuara nga dhuna në familje. Për sa i përket llojeve të lëndimeve, 12,1% e grave të dhunuara fizikisht kishin pësuar çarje/prerje, të nxira, apo dhimbje; 6,3% kishin pësuar lëndime në sy, djegie, ndrydhje ose nxjerrje të kyçeve ose eshtrave; 6,5% kishin pësuar lëndime në kokë; 4,4% kishin pësuar lëndime abdominale; 2,2% kishin plagë të thella, eshtra të thyera, dhëmbë të thyer ose lëndime të tjera të rënda; dhe 1,1% kishin humbur ndjenjat si rezultat i dhunës në familje. Në vitin 2013, u pa gjithashtu se gratë e dhunuara që kishin pësuar lëndime të shkaktuara nga dhuna në familje, shpesh kishin pësuar më shumë se sa një lloj lëndimi (shih Tabelën 4.8).

Në vitin 2013, u bë gjithashtu një analizë më e avancuar e lëndimeve të shkaktuara nga dhuna në familje për të gjitha llojet e ndryshme të dhunës fizike dhe seksuale, si dhe për secilin prej llojeve të ndryshme të dhunës fizike (d.m.th, dhunë fizike e moderuar, dhunë fizike e rëndë, dhe dhunë fizike me armë). Rezultatet treguan se gratë që ishin dhunuar fizikisht dhe seksualisht nga bashkëshortët/partnerët e tyre kishin pësuar lëndime me shkallë të ndryshme ashpërsie. Megjithatë, gratë e dhunuara seksualisht kishin më shumë gjasa se gratë e dhunuara fizikisht që të kishin pësuar secilin prej llojeve të ndryshme të lëndimeve fizike. Po kështu, gratë që kishin përjetuar dhunë të rëndë fizike në martesë/marrëdhënien e tyre intime, kishin më shumë gjasa të përjetonin secilin prej llojeve të ndryshme të lëndimeve fizike, krahasuar me

gratë që kishin përjetuar dhunë fizike të moderuar. Gratë që kishin përjetuar dhunë fizike me përdorim arme kishin më shumë gjasa nga të gjitha të pësonin lëndime fizike, ndër të cilat edhe lëndime më të rënda dhe serioze (shih Figurën 4.7).

Në vitin 2007, 26% deri në 66% e grave që kishin pësuar lëndime të shkaktuara nga dhuna në familje raportuan se nuk kishin mundur të punonin për një periudhë nga 1 deri 5 ditë, për shkak të lëndimeve (15). Ndërsa në vitin 2013, vetëm 9,4% e grave që kishin pësuar lëndime të shkaktuara nga dhuna në familje raportuan se nuk kishin mundur të bënin punët e shtëpisë apo të kujdeseshin për fëmijët për shkak të lëndimeve të shkaktuara nga dhuna në familje, ndërsa 5,1% nuk kishin qenë në gjendje të bënin punë jashtë shtëpisë. Megjithatë, u pa se gratë kishin humbur më shumë ditë pune jashtë shtëpisë, se sa brenda shtëpisë me punët e shtëpisë dhe kujdesin për fëmijët, si pasojë e lëndimeve të shkaktuara nga dhuna në familje (shih Tabelën 4.9).

Një shpjegim i mundshëm se pse kaq pak gra raportuan lëndime të shkaktuara nga dhuna në familje në vitin 2013 mund të lidhet me faktin se në këtë vërtetim u përdorën mini-kompjuterë portativë për administrimin e vërtimit dhe mbledhjen e të dhënave. Gratë mund të kenë ngurrar më shumë t'i raportojnë lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje nga frika se mos gjërat që thoshin regjistroheshin zyrtarisht dhe bashkëshortët e tyre mund ta pësonin ngaqë i kishin lënduar gratë.

Këto rezultate kanë rrjedhoja serioze për sektorin mjekësor/shëndetësor, sepse shumë prej mjekëve dhe punonjësve të shërbimit shëndetësor janë ata që i vizitojnë dhe trajtojnë gratë që jetojnë në marrëdhënie të dhunshme si dhe fëmijët që jetojnë në familje të dhunshme, qoftë kur këta janë të ndërgjegjshëm për këtë apo jo. Në shumë raste, personeli mjekësor mund të jetë pika e parë e kontaktit për personat që i kanë mbijetuar dhunës në familje.

## DHUNA SEKSUALE, PËRDORIMI I MJETEVE KONTRACEPTIVE DHE RREZIKU NGA SST-të

Në vitet 2007 dhe 2013 u bë analiza e të dhënave për të kuptuar marrëdhënien midis dhunës në familje, aftësisë së grave për të përdorur kontraktivë, dhe rrezikut që ato të marrin sëmundje seksualisht të transmetueshme. Si në vitin 2007 dhe në vitin 2013 u konstatua se gratë që ishin dhunuar seksualisht në martesë/marrëdhënien e tyre intime kishin gati tri herë më shumë gjasa të raportonin se bashkëshorti nuk i lejonte të përdornin mjete kontrceptive për të shmangur shtatzëninë, krahasuar me gratë që nuk ishin dhunuar seksualisht (18). Në vitin 2013, u konstatua

gjithashtu se gratë e dhunuara seksualisht kishin dy herë më shumë gjasa të raportonin se bashkëshorti/partneri nuk e dinte kur ato përdornin kontraktivë, krahasuar me gratë që nuk ishin dhunuar seksualisht.

Për sa i përket rrezikut të SST-ve, në vitet 2007 dhe 2013 u konstatua se gratë e dhunuara seksualisht kishin dy herë më shumë gjasa të kishin pasur një sëmundje seksualisht të transmetueshme në të kaluarën, krahasuar me gratë që nuk ishin dhunuar seksualisht në martesë/marrëdhënien e tyre intime (shih Figurën 4.8; 19).

## ALKOOLI DHE DHUNA NË FAMILJE

Marrëdhëniet ndërmjet përdorimit/abuzimit të alkoolit nga bashkëshorti dhe dhunës në familje u shqyrtuan si në vërtetimin e vitit 2007, ashtu edhe në atë të vitit 2013. Nga viti 2007 në vitin 2013, numri i grave që raportuan se bashkëshortët/partnerët e tyre pinin alkool ishte pak a shumë i qëndrueshëm (përkatësisht 38,1% dhe 35,5%). Megjithatë, numri i grave që raportuan se bashkëshortët/partnerët e tyre deheshin në mënyrë të konsiderueshme u rrit nga 31,0% në vitin 2007 në 69,1% në vitin 2013 (shih Figurën 4.10; 20). Kjo rritje e konsiderueshme është e rëndësishme po të kemi parasysh lidhjen ndërmjet përdorimit/abuzimit të alkoolit nga bashkëshorti/partneri dhe dhunës në familje.

Si në vitin 2007 ashtu edhe në vitin 2013, analiza tregoi se gratë bashkëshortët/partnerët e të cilave pinin alkool kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin dhunë në familje të të gjitha llojeve, krahasuar me gratë bashkëshortët/partnerët e të cilave nuk pinin alkool. Në vitet 2007 dhe 2013 u konstatua se gratë me bashkëshortë/partnerë që pinin

alkool kishin dy herë më shumë gjasa të përjetonin dhunë fizike dhe seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime (21). Në vitin 2013, u konstatua se gratë, bashkëshortët/partnerët e të cilave pinin alkool, kishin gati tri herë më shumë gjasa të përjetonin dhunë fizike dhe gjashtë herë më shumë gjasa të përjetonin dhunë seksuale në martesë/marrëdhëniet e tyre intime (shih Figurën 4.9). Rritja e konsiderueshme nga viti 2007 në vitin 2013 në rrezikimin e grave nga dhuna seksuale që lidhet me konsumimin e alkoolit nga bashkëshorti/partneri, është e rëndësishme dhe duhet shqyrtuar dhe trajtuar më tej.

Në vitet 2007 dhe 2013, analizat gjithashtu treguan se gratë që ishin dhunuar fizikisht dhe seksualisht dhe që thoshin se bashkëshortët/partnerët e tyre pinin alkool kishin shumë më tepër gjasa të pësonin lëndime të shkaktuara nga dhuna në familje (shih Figurën 4.10; 22). Është e rëndësishme të mos harrohet se alkooli është faktor që kontribuon në dhunën në familje, por nuk është shkak i dhunës në familje.

## GJENDJA CIVILE E GRAVE DHE DHUNA NË FAMILJE

Dhuna në familje ndodh brenda kontekstit të martesës/marrëdhënies; ndaj në vitet 2007 dhe 2013 u analizuan marrëdhëniet ndërmjet gjendjes civile të grave – të martuara, të divorcuara/të ndara, dhe beqare (që jetonin me një partner intim). Në vitet 2007 dhe 2013, u konstatua se kishte dallime të mëdha në bazë të gjendjes civile të grave dhe përvojave të tyre me dhunën psikologjike, fizike dhe seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Një rezultat që dilte vazhdimisht në vërtetim ishte se gratë e divorcuara/të ndara kishin shumë më tepër gjasa të

përjetonin dhunë psikologjike, fizike dhe seksuale “gjatë jetës” në martesë/marrëdhënien e tyre intime, krahasuar me gratë që ishin të martuara/bashkëjetonin me partnerin (shih Figurën 4.11; 23). Në krahasim me këtë, gratë që ishin të martuara kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin “aktualisht” dhunë në familje të të gjitha llojeve, krahasuar me gratë e divorcuara/të ndara (Figura 4.11; 24); megjithatë, në vitin 2007 u konstatua se 44% deri në 68% të grave të divorcuara/ndara raportonin se po përjetonin “aktualisht” dhunë fizike në marrëdhënien e tyre të tanishme (25).

## MOSHA E GRAVE DHE DHUNA NË FAMILJE

U kryen analiza edhe për të përcaktuar nëse kishte dallime të konsiderueshme ndërmjet përvojave të grave me dhunën në familje në bazë të moshës. Në vitin 2007, gratë nga 15 deri 49 vjeç u grupuan në nëntë grupmosha të ndryshme (26). Gratë e secilës grupmoshë kishin përjetuar dhunë në familje dhe nuk kishte dallime të rëndësishme ndërmjet grupmoshave për sa i përket përvojave të grave me dhunën emocionale apo psikologjike; megjithatë, dallime ndërmjet grupmoshave ishin të mëdha kur bëhej fjalë për përvojat e grave me dhunën fizike dhe seksuale. Në veçanti, gratë 26 vjeç e lart kishin shumë më tepër gjasa të thoshin se ishin dhunuar fizikisht dhe/ose seksualisht nga bashkëshorti/partneri se sa gratë në grupmoshat 15-17 vjeç, 18-21 vjeç, dhe 22-25 vjeç (27).

Në vitin 2013, kampioni përfshiu gratë e moshës nga

18 deri 55 vjeç dhe ato u ndanë në katër grupmosha të ndryshme. Analiza tregoi se shumica e grave të të gjitha grupmoshave kishin përjetuar dhunë në familje “gjatë jetës”; megjithatë gratë e moshës 18-24 vjeç kishin pak më tepër gjasa të kishin përjetuar dhunë në familje “gjatë jetës”, krahasuar me gratë e grupmoshave 25-34 vjeç, 35-44 vjeç, dhe 45-55 vjeç. Në veçanti, gratë e moshës 18-24 vjeç kishin shumë më tepër gjasa të kishin përjetuar dhunë psikologjike në martesë/marrëdhënien e tyre intime “gjatë jetës”; megjithatë, gratë e moshës 25 vjeç e lart kishin shumë më tepër gjasa të kishin përjetuar dhunë fizike në martesë/marrëdhënien e tyre intime “gjatë jetës” (shih Figurën 4.13). Ky rezultat është i ngjashëm me atë të vitit 2007, kur u konstatua se gratë e moshës 26 vjeç e lart kishin shumë më tepër gjasa të raportonin se ishin dhunuar

fizikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre në krahasim me gratë e moshës nga 15 dhe 25 vjeç (28).

Për sa i përket dhunës seksuale, vërtetimi i vitit 2013 konstatoi se gratë e moshës 35-44 vjeç (9,5%) kishin më tepër gjasa të kishin përjetuar dhunë seksuale "gjatë jetës" në martesë/marrëdhënien e tyre intime (shih Figurën 4.13); ndërsa në vitin 2007 gratë e moshës 26 vjeç e lart kishin më tepër gjasa të raportonin se ishin dhunuar seksualisht nga bashkëshorti/partneri i tyre (29).

Në vitin 2013 u shqyrtuan edhe marrëdhëniet ndërmjet moshës së grave dhe përvojave të tyre "aktuale" të dhunës në familje. Kjo analizë tregoi se, ndonëse një numër i konsiderueshëm i grave të moshës 45-55 vjeç (49,8%) po përjetonin dhunë në familje "aktualisht" në martesë/marrëdhënien e tyre intime, ato kishin më pak gjasa të përjetonin "aktualisht" dhunë në familje të të gjitha llojeve krahasuar me gratë e moshave 18-24 vjeç (58,7%), 25-34 vjeç (58,1%), dhe 35-44 vjeç (14,7%; shih Figurën 4.14).

## NIVELI ARSIMOR I GRAVE DHE DHUNA NË FAMILJE

Gratë e të gjitha niveleve arsimore kishin përjetuar dhunë në familje; megjithatë përvojat e grave me dhunën në familje ndryshonin në varësi të nivelit arsimor. Në vitin 2013, u konstatua gjithashtu se gratë me arsim tetëvjeçar (66,7%) kishin shumë më tepër gjasa të kishin përjetuar dhunë në familje të të gjitha llojeve "gjatë jetës", krahasuar me gratë me arsim fillor ose më të ulët (58,5%), gratë me arsim të mesëm (56,4%), dhe ato me arsim universitar/pasuniversitar (43,2%; shih Figurën 4.15). I njëjti model

shfaqet edhe për gratë që po përjetonin dhunë në familje "aktualisht" (shih Figurën 4.16).

Në vitet 2007 dhe 2013, analizat treguan se gratë me arsim universitar/pasuniversitar kishin më pak gjasa nga të gjitha që të kishin përjetuar dhunë në familje të të gjitha llojeve "gjatë jetës"; megjithatë, ato nuk ishin të përjashtuara nga përjetimi i dhunës në familje në martesë/marrëdhënien e tyre intime "gjatë jetës" thjesht sepse ishin me arsim të lartë (shih Figurën 4.15; 30).

## NIVELI ARSIMOR I BASHKËSHORTIT DHE DHUNA NË FAMILJE

Në vitin 2007, u analizuan gjithashtu edhe marrëdhëniet midis nivelit arsimor të bashkëshortit dhe dhunës në familje. U konstatua se burrat e çdo niveli arsimor kryenin akte dhune në familje ndaj bashkëshorteve/partnereve të tyre, megjithatë, gratë që kishin pësuar dhunë emocionale "gjatë jetës" kishin shumë më tepër gjasa të raportonin se bashkëshorti/partneri i tyre kishte arsim të mesëm. Përveç kësaj, edhe gratë që kishin përjetuar dhunë psikologjike dhe fizike kishin më shumë gjasa të raportonin se bashkëshorti/partneri i tyre kishte arsim të mesëm. Kurse gratë që nuk kishin përjetuar dhunë emocionale, psikologjike dhe fizike

kishin më shumë gjasa të raportonin se bashkëshorti i tyre kishte arsim të lartë. Nuk kishte ndonjë marrëdhënie të rëndësishme midis nivelit arsimor të bashkëshortit dhe përvojave të grave dhe dhunës seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime (31).

Në vitin 2013, marrëdhënia midis nivelit arsimor të bashkëshortit dhe dhunës në familje nuk u analizua sepse të dhënat për nivelin arsimor të bashkëshortëve nuk u përfshinë në të dhënat demografike të grave dhe të dhënat e përcaktuara për dhunën në familje.

## GJENDJA E PUNËSIMI TË GRAVE DHE DHUNA NË FAMILJE

Në vitet 2007 dhe 2013, u bënë analiza për të shqyrtuar marrëdhënien ndërmjet gjendjes së punësimit të grave dhe dhunës në familje. Në vitin 2007 nuk kishte dallime të konsiderueshme midis përvojave të grave me dhunën psikologjike, fizike dhe seksuale, mbi bazën e gjendjes së punësimit të grave. Me fjalë të tjera, gratë që në kohën e vërtetimit punonin jashtë shtepisë të paktën 20 orë në javë, kishin po aq gjasa të përjetonin dhunë psikologjike, fizike dhe seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime sa edhe gratë që nuk punonin jashtë shtepisë (32).

Në vitin 2007, i vetmi dallim që u identifikua mbi bazën e gjendjes së punësimit lidhej me numrin e rasteve të dhunës emocionale; gratë që nuk punonin jashtë shtepisë

kishin shumë më tepër gjasa të kishin përjetuar dhunë emocionale se sa gratë që punonin jashtë shtepisë për të paktën 20 orë në javë në kohën e vërtetimit (33).

Në krahasim me këtë, në vitin 2013 u konstatua se gratë që nuk punojnë jashtë shtepisë (64,2%) kishin shumë më tepër gjasa të kishin përjetuar dhunë në familje të të gjitha llojeve "gjatë jetës", krahasuar me gratë që punonin jashtë shtepisë (52,9%); megjithatë, gratë me leje lindjeje (77,9%, ose tre të katërtat) kishin më shumë gjasa nga të gjitha gratë të kishin përjetuar dhunë në familje "gjatë jetës" (shih Figurën 4.17). Modeli ishte i njëjtë edhe për sa i përket dhunës në familje "aktuale" (shih Figurën 4.18).



## GJENDJA E PUNËSIMIT TË BASHKËSHORTËVE DHE DHUNA NË FAMILJE

Në vitin 2007 u mor në shqyrtim marrëdhënia midis gjendjes së punësimit të bashkëshortëve dhe dhunës në familje të përjetuar nga gratë. Nuk u zbulua ndonjë marrëdhënie statistikisht domethënëse ndërmjet gjendjes së punësimit të bashkëshortit dhe përvojës së grave me dhunën emocionale dhe dhunën fizike apo seksuale në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Megjithatë, gratë që kishin përjetuar dhunë psikologjike, kishin shumë më tepër

gjasa të thoshin se bashkëshortët e tyre punonin të paktën 20 orë në javë jashtë shtëpisë në kohën e vërtetimit (34).

Në vitin 2013 nuk u analizua marrëdhënia ndërmjet gjendjes së punësimit të burrave dhe dhunës në familje sepse të dhënat për gjendjen e punësimit të burrave nuk u përfshinë në të dhënat demografike të grave dhe të dhënat e përcaktuara për dhunën në familje.

## VENDBANIMI I GRAVE (URBAN KUNDREJT RURAL) DHE DHUNA NË FAMILJE

Gjithashtu u bënë analiza për të kuptuar nëse ka dallime ndërmjet grave që jetojnë në zonat urbane kundrejt atyre në zonat rurale për sa i përket përvojave të tyre me dhunën në familje. Në vitet 2007 dhe 2013 u konstatua se, ndonëse kishte një përqindje të madhe grash që kishin

përjetuar dhunë në familje si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, gratë në zonat rurale kishin më tepër gjasa të përjetonin dhunë në familje të të gjitha llojeve (shih Figurat 4.19 dhe 4.20; 35).

## DHUNA NË FAMILJE NGA ANËTARË TË TJERË TË FAMILJES

Dhuna në familje ndaj grave nuk shtrihet vetëm nga bashkëshorti/partneri; shpesh anëtarë të tjerë të familjes (p.sh. prindër, vëllezër e motra, familja e burrit, ose të afërm të tjerë) kryejnë akte dhune kundër grave dhe vajzave. Në vitin 2007 u konstatua se që nga moshja 15 vjeçare, 13,8% e grave ishin keqtrajtuar fizikisht nga nëna/njerka e tyre, 13,4% nga babai/njerku, dhe 9,7% nga një motër/vëllai. Çuditërisht, vetëm 2,0% e grave ishin dhunuar fizikisht nga vëhri apo vëhrra (36).

Në vitin 2013, 6,9% e grave raportuan se ishin dhunuar fizikisht nga anëtarë të tjerë të familjes që nga moshja 15 vjeçare. Më konkretisht, 3,6% raportuan se që nga moshja 15 vjeçare ishin keqtrajtuar fizikisht nga nëna/njerka, 4,1% ishin keqtrajtuar fizikisht nga babai/njerku, dhe 2,3% nga motra/vëllai (shih Tabelën 4.11). Këto përqindje janë më të ulëta se në vitin 2007.

## NDIKIMI I DHUNËS NË FAMILJE TEK FËMIJËT

Në vitet 2007 dhe 2013, u bënë përpjekje për të vlerësuar ndikimin e dhunës në familje tek fëmijët. Në vitin 2013, 14,0% e grave thanë se dhuna në familje ndikonte tek fëmijët e tyre (shih Tabelën 4.13). Si në vitin 2007 edhe në vitin 2013, gratë e pranuan se fëmijët e tyre kishin qenë dëshmitarë të dhunës në familje, jetonin me frikë, ishin lënduar ose dëmtuar nga dhuna në familje, madje ishin larguar nga shtëpia për të jetuar me të afërm si pasojë e dhunës në familje (shih Tabelën 4.13; 37). Në vitin 2013, ndër gratë që e pranonin se dhuna në familje kishte ndikim tek fëmijët e tyre, 42,8% thanë se dhuna në familje faktikisht u kishte shkaktuar fëmijëve të tyre probleme të të nxënies (shih Tabelën 4.13).

Në vitin 2007 u anketuan edhe fëmijët, të cilët u pyetën për dhunën në familje në shtëpitë e tyre. Analiza tregoi se 57,7% e fëmijëve thanë se ishin keqtrajtuar fizikisht nga një anëtar i familjes, dhe disa fëmijë kishin përjetuar njëkohësisht disa lloje të shumta të dhunës fizike (38). Fëmijët raportuan se ishin keqtrajtuar shpesh nga prindërit; por edhe motrat/vëllezërit,

gjyshërit/gjyshet, dhe të afërm të tjerë i kishin keqtrajtuar fëmijët. Është e rëndësishme të theksohet se djemtë kishin shumë më tepër gjasa të keqtrajtoheshin fizikisht nga babai/njerku i tyre se sa vajzat; kurse vajzat kishin shumë më tepër gjasa se djemtë të keqtrajtoheshin fizikisht nga vëllai dhe/ose motra. Djemtë dhe vajzat kishin gjasa të barabarta të keqtrajtoheshin fizikisht nga nëna/njerka (39).

Ngaqë fëmijët përgjithësisht nuk kanë ndonjë status brenda familjes dhe dhuna fizike përdoret shpesh si mjeti disiplinimi, ata shpesh ngurren të flasin hapur për dhunën në familje. Ndonëse një pjesë e mirë e fëmijëve kishin kërkuar ndihmën e dikujt për dhunën që po përjetonin në familje, shumica e tyre e kishin kërkuar këtë ndihmë nga një anëtar i familjes. Shumë rrallë ndodhte që fëmija t'i tregonte dikujt jashtë familjes për dhunën/keqtrajtimin (40).

Së fundi, vetëm 17,4% e fëmijëve raportuan se kishin dijeni për dhunën në familje midis prindërve të tyre (41).

## SJELLJET E GRAVE TË DHUNUARA PËR KËRKIMIN E NDIHMËS

Gratë e keqtrajtuara shpesh nuk janë të gatshme të flasin hapur për dhunën në familje. Në vitin 2007, vetëm 16% deri 28% e grave që kishin përjetuar dhunë në familje kishin kërkuar ndihmë për dhunën në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Nga ato që kishin kërkuar ndihmë, pothuaj 91% e kishin kërkuar atë nga familja ose të afërm të tjerë të tyre, dhe shumë pak gra kishin dalë jashtë familjes për të kërkuar ndihmë për dhunën në jetën e tyre. Për shembull, vetëm 1,5% kishin kërkuar ndihmë nga mjekët/punonjës të shëndetësisë, 1,5% kishin kërkuar ndihmë në polici, 3,1% nga avokatët, 5,7% nga gjykatësit, dhe 0,5% nga organizatat që ofrojnë shërbime sociale (42).

Në vitin 2013, vetëm 8,4% e grave të dhunuara “gjatë jetës” dhe 7,1% e grave të dhunuara “aktualisht” ishin përpjekur të kërkonin ndihmë për dhunën në familje në martesë/marrëdhënien e tyre intime. Ndër gratë që kërkuan ndihmë, 90% e kishin kërkuar këtë ndihmë nga familja e tyre, 60% kishin kërkuar ndihmë nga familja e bashkëshortit/partnerit, dhe 28% nga shoqëria. Shumë pak gra kishin kërkuar ndihmë jashtë familjes dhe shoqërisë së tyre. Megjithatë, në vitin 2013, kishte një përqindje më të madhe grash të dhunuara “aktualisht” që kishin kërkuar ndihmë nga mjekët/punonjës të shëndetësisë (15,6%), policia (14,1%), avokatët (7,8%), gjykatësit (6,2%), dhe organizatat e shërbimeve sociale (1,1%; shih Tabelën 4.14). Kjo do të thotë se ka një rritje të konsiderueshme nga viti 2007 deri në vitin 2013 në përqindjen e grave të dhunuara që ishin të gatshme të kërkonin ndihmë nga shërbimet shëndetësore, ligjore dhe shoqërore.

Arsyet pse gratë e dhunuara nuk kërkonin ndihmë për dhunën në familje ishin të shumta (shih faqet 48-49; 43). Në vitin 2013, u konstatua se viktimat e dhunës në familje që

kishin kërkuar ndihmën e shërbimeve shëndetësore dhe/ose ligjore duhet të paguanin (madje edhe nën dorë) për ndonjë prej shërbimeve shëndetësore dhe/ose ligjore që kishin marrë (shih Figurën 4.21). Për shumë gra të dhunuara, fakti se mund t’u duhet të paguajnë për shërbimet, është një pengesë e konsiderueshme që ato të kenë mundësi të përdorin shërbimet mjekësore, të mbrojtjes dhe përkrahjes, si edhe ato të drejtësisë.

Gjithashtu, në vitin 2013 u bë një analizë për të përcaktuar nëse karakteristikat demografike kishin ndikuar në sjelljet e grave për kërkimin e ndihmës. Këto të dhëna treguan se gratë me arsim fillor ose më të ulët kishin më shumë gjasa të kërkonin ndihmë për dhunën në familje, ndërsa gratë me arsim universitar/pasuniversitar kishin më pak gjasa të kërkonin ndihmë për dhunën në familje. Po kështu, gratë që nuk punojnë jashtë shtëpisë kishin më shumë gjasa të kërkonin ndihmë për dhunën në familje, krahasuar me gratë që punonin jashtë shtëpisë. Gjithashtu, gratë në zonat urbane kishin më shumë gjasa të kërkonin ndihmë për dhunën në familje sesa gratë në zonat rurale.

Në përfundim, rezultatet nga të dy vrojtimet kombëtare me bazë popullatën mbi dhunën në familje ndaj grave në Shqipëri, ai i vitit 2007 dhe i vitit 2013, tregojnë modele dhe tendenca të rëndësishme për natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje dhe faktorët e rëndësishëm që kontribuojnë në dhunën në familje. Këto rezultate tregojnë nevojën për veprim nga një gamë e gjerë faktorësh, ndër të cilat institucionet qeveritare, organizatat jo qeveritare dhe ato ndërkombëtare, punonjësit e rendit dhe të drejtësisë, mjekët dhe punonjësit e shëndetësisë, si dhe drejtuesit në këtë shoqëri.


## REFERENCA

1. Krug E.G., L. Dahlberg, J.A. Mercy, A.B. Zwi & R. Lozano (2002). *World Report on Violence and Health*. Geneva, Switzerland: World Health Organization.
2. Garcia-Moreno, C., H. Jensen, M. Ellsberg, L. Heise & C. Watts (2005). *WHO Multi-Country Study on Women's Health dhe dhuna në familje against Women*. Geneva, Switzerland: World Health Organization.
3. OBSH (2013). *Global and Regional Estimates of Violence Against Women: Prevalence and Health Effects of Intimate Partner Violence and Non-Partner Sexual Violence* (Vlerësime globale dhe rajonale të dhunës ndaj grave: përhapja dhe pasojat shëndetësore të dhunës nga partnerët dhe dhunës seksuale nga jo-partnerët). Geneva, Switzerland: WHO.
4. Pinheiro (2006). *World Report on Violence against Children* (Raport Botëror mbi Dhunën ndaj fëmijëve). Geneva, Switzerland: United Nations Publishing Services.
5. Haarr, R.N. & M. Dhamo (2009). *Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojt看 Kombëtar me Bazë Popullatën*. Tiranë, Shqipëri: UNDP.
6. Haarr & Dhamo, 2009, f. 107.
7. Haarr & Dhamo, 2009, f. 107.
8. Haarr & Dhamo, 2009, f. 107.
9. Haarr & Dhamo, 2009, f. 107.
10. Haarr & Dhamo, 2009, f. 109-117.
11. Haarr & Dhamo, 2009, f. 119-121.
12. Haarr & Dhamo, 2009, f. 121.
13. Haarr & Dhamo, 2009, f. 121.
14. Haarr & Dhamo, 2009, f. 122-123.
15. Haarr & Dhamo, 2009, f. 123.
16. Garcia-Moreno et al., 2005.
17. World Health Organization, 2013.
18. Haarr & Dhamo, 2009, f. 123-124.
19. Haarr & Dhamo, 2009, f. 123-124.
20. Haarr & Dhamo, 2009, f. 124-126.
21. Haarr & Dhamo, 2009, f. 124-126.
22. Haarr & Dhamo, 2009, f. 124-126.
23. Haarr & Dhamo, 2009, f. 113- 118.
24. Haarr & Dhamo, 2009, f. 113-118.
25. Haarr & Dhamo, 2009, f. 115.
26. Haarr & Dhamo, 2009, f. 103.
27. Haarr & Dhamo, 2009, f. 116-119.
28. Haarr & Dhamo, 2009, f. 116.
29. Haarr & Dhamo, 2009, f. 116.
30. Haarr & Dhamo, 2009, f. 109-115.
31. Haarr & Dhamo, 2009, f. 125-126.
32. Haarr & Dhamo, 2009, f. 109-115.
33. Haarr & Dhamo, 2009, f. 109-115.
34. Haarr & Dhamo, 2009, f. 126-127.
35. Haarr & Dhamo, 2009, f. 110-119.
36. Haarr & Dhamo, 2009, f. 128.
37. Haarr & Dhamo, 2009, f. 128-129.
38. Haarr & Dhamo, 2009, f. 131-136.
39. Haarr & Dhamo, 2009, f. 131-136.
40. Haarr & Dhamo, 2009, f. 131-136.
41. Haarr & Dhamo, 2009, f. 131-136.
42. Haarr & Dhamo, 2009, f. 129.
43. Haarr & Dhamo, 2009, f. 129.



# 6

## Shtojca: Tabelat





**Tabela 1.** Gjendja civile sipas moshës së grave

|                       | Grupmosha  |      |            |      |            |      |            |      | Testi i domethënies statistikore |       |
|-----------------------|------------|------|------------|------|------------|------|------------|------|----------------------------------|-------|
|                       | 18-24 vjeç |      | 25-34 vjeç |      | 35-44 vjeç |      | 45-55 vjeç |      |                                  |       |
| Gjendja civile        | n          | %    | n          | %    | n          | %    | n          | %    | χ2                               | Vlera |
| E martuar/bashkëjeton | 27 382     | 44,3 | 141 779    | 80,5 | 215 016    | 92,9 | 251 826    | 93,2 | 186,431,21                       | 0,000 |
| E ve                  | 0          | 0,0  | 1067       | 0,6  | 4 651      | 2,0  | 11 683     | 4,3  |                                  |       |
| E shkurorëzuar/ndarë  | 1 187      | 1,9  | 3329       | 1,9  | 4 908      | 2,1  | 3 913      | 1,4  |                                  |       |
| Beqare                | 33 202     | 53,8 | 29 947     | 17,0 | 6 963      | 3,0  | 2 905      | 1,1  |                                  |       |

\* Të dhëna të ponderuara për një kampion prej 3 589 grash

**Tabela 2.** Arsimi dhe gjendja e punësimit të grave sipas vendbanimit urban kundrejt rural

|                             | N=739 758* |      |         |      | Testi i domethënies statistikore |       |
|-----------------------------|------------|------|---------|------|----------------------------------|-------|
|                             | Urban      |      | Rural   |      |                                  |       |
| Arsimi                      | n          | %    | n       | %    | $\chi^2$                         | Vlera |
| Fillor ose më i ulët        | 12 186     | 3,0  | 19 491  | 5,9  | 85,931,71                        | 0,000 |
| Tetëvjeçar                  | 107 862    | 26,9 | 181 087 | 55,0 |                                  |       |
| I mesëm/profesional         | 188 228    | 46,9 | 111 776 | 33,9 |                                  |       |
| Universitar/pas-universitar | 93 063     | 23,2 | 17 060  | 5,2  |                                  |       |
| Gjendja e punësimit         |            |      |         |      |                                  |       |
| Punon jashtë shtëpisë       | 206 432    | 51,0 | 114 699 | 34,3 | 21,177,14                        | 0,000 |
| Po, por me leje lindjeje    | 3 645      | 0,9  | 2 523   | 0,8  |                                  |       |
| Nuk punon jashtë shtëpisë   | 194 909    | 48,1 | 217 549 | 65,0 |                                  |       |

\* Të dhëna të ponderuara për një kampion prej 3 589 grash

**Tabela 3.** Format e dhunës psikologjike të përjetuara nga gratë(18-55 vjeç)

|                                                                       | Gjatë jetës |      | Aktualisht |      |
|-----------------------------------------------------------------------|-------------|------|------------|------|
|                                                                       | n           | %    | n          | %    |
| Dhunë verbale                                                         |             |      |            |      |
| Të bërtet dhe të fyen                                                 | 246 593     | 38,1 | 198 815    | 30,7 |
| Thotë ose bën diçka për t'ju poshtëruar para të tjerëve               | 63 112      | 9,8  | 43 252     | 6,7  |
| Të flet në një mënyrë që ju bën të ndiheni keq/pa vlerë               | 65 648      | 10,1 | 46 069     | 7,1  |
| Kërcënime psikologjike                                                |             |      |            |      |
| Kërcënim se do t'ju lëndojë ju ose dikë të afërt me ju                | 15 094      | 2,3  | 5 993      | ,9   |
| Bën kërcënime për t'ju lënduar fizikisht                              | 33 529      | 5,2  | 20 207     | 3,1  |
| Shkatërron/thyen diçka që ishte e rëndësishme për ju                  | 26 090      | 4,0  | 9 978      | 1,5  |
| Sjellje kontrolluese                                                  |             |      |            |      |
| Bashkëshorti im është xheloz ose inatoset nëse flas me burra të tjerë | 261 547     | 39,5 | 192 635    | 29,1 |
| Bashkëshorti im më akuzon se nuk i jam besnike                        | 29 314      | 4,4  | 15 841     | 2,4  |
| Bashkëshorti im nuk më lejon të takoj shoqet e mia                    | 67 688      | 10,2 | 49 762     | 7,5  |
| Bashkëshorti im më kufizon kontaktet me familjen time                 | 44 973      | 6,8  | 30 003     | 4,5  |
| Bashkëshorti im ngul këmbë të dijë se ku jam në çdo kohë              | 144 253     | 21,8 | 121 903    | 18,4 |
| Bashkëshorti im e vë në dyshim besnikërinë ime                        | 19 946      | 3,0  | 7 930      | 1,2  |
| Më shpërfill                                                          | 79 234      | 12,2 | 58 759     | 9,1  |
| Merr/merrte vendime që më takon mua t'i marr                          | 175 781     | 27,2 | 148 935    | 23,0 |
| Thoshte gjëra si "Po nuk ishte e imja, nuk ke për të qenë e askujt"   | 27 759      | 4,3  | 16 669     | 2,6  |
| Dhunë ekonomike                                                       |             |      |            |      |
| Bashkëshorti im nuk më jep para në dorë                               | 68 902      | 10,4 | 57 224     | 8,6  |

**Tabela 4.** Format e shumëfishta të dhunës psikologjike të përjetuar nga gratë (18-55 vjeç)

| Numri i llojeve të dhunës psikologjike | N=646 879   |      |            |      |
|----------------------------------------|-------------|------|------------|------|
|                                        | Gjatë jetës |      | Aktualisht |      |
|                                        | n           | %    | n          | %    |
| 1                                      | 101 393     | 15,7 | 114 222    | 17,7 |
| 2                                      | 79 689      | 12,3 | 77 729     | 12,0 |
| 3                                      | 58 271      | 9,0  | 53 182     | 8,2  |
| 4                                      | 35 452      | 5,5  | 28 536     | 4,4  |
| 5                                      | 26 759      | 4,1  | 24 297     | 3,8  |
| 6                                      | 23 125      | 3,6  | 13 213     | 2,0  |
| 7                                      | 13 445      | 2,1  | 10 183     | 1,6  |
| 8                                      | 9 834       | 1,5  | 6 436      | 1,0  |
| 9                                      | 6 177       | 1,0  | 2 866      | 0,4  |
| 10                                     | 3 437       | 0,5  | 3 363      | 0,5  |
| 11                                     | 4 136       | 0,6  | 3 314      | 0,5  |
| 12                                     | 3 339       | 0,5  | 1 045      | 0,2  |
| 13                                     | 2 666       | 0,4  | 1 064      | 0,2  |
| 14                                     | 3 946       | 0,6  | 1 017      | 0,2  |
| 15                                     | 1 597       | 0,2  | 782        | 0,1  |
| 16                                     | 3 289       | 0,5  | 498        | 0,1  |

**Tabela 5.** Llojet e dhunës fizike të përjetuar nga gratë (18-55 vjeç)

|                                                                       | N=646 879   |      |            |      |
|-----------------------------------------------------------------------|-------------|------|------------|------|
|                                                                       | Gjatë jetës |      | Aktualisht |      |
|                                                                       | n           | %    | n          | %    |
| <b>Dhunë fizike e moderuar</b>                                        |             |      |            |      |
| Ju ka hedhur tutje ose shtyrë                                         | 53 667      | 8,3  | 27 245     | 4,2  |
| Ju ka shkukur flokët                                                  | 35 717      | 5,5  | 16 920     | 2,6  |
| Ju ka goditur me shkelma                                              | 16 227      | 2,5  | 5 773      | 0,9  |
| Ju ka tërhequr zvarrë                                                 | 5 803       | 0,9  | 1 799      | 0,3  |
| Ju ka goditur me shuplakë                                             | 129 212     | 20,0 | 76 691     | 11,9 |
| <b>Dhunë fizike e rëndë</b>                                           |             |      |            |      |
| Ju ka rrahur                                                          | 84 281      | 13,0 | 47 901     | 7,4  |
| Është përpjekur t'ju djegë me qëllim                                  | 2 978       | ,5   | 1 293      | 0,2  |
| Është përpjekur t'ju mbysë/marrë frymën                               | 6 212       | 1,0  | 998        | 0,2  |
| Ju ka përplasur pas diçkaje                                           | 23 260      | 3,6  | 9 672      | 1,5  |
| Është përpjekur t'ju lëndojë duke ju mbytur ose zënë frymën           | 7 315       | 1,1  | 1 356      | 0,2  |
| <b>Dhuna fizike me armë</b>                                           |             |      |            |      |
| Ju ka goditur me ndonjë objekt ose diçka tjetër që mund t'ju lëndonte | 18 368      | 2,8  | 6 580      | 1,0  |
| Ju ka kërcënuar me thikë ose ndonjë armë tjetër                       | 6 977       | 1,1  | 1 258      | 0,2  |

**Tabela 6.** Llojet e shumëfishta të dhunës fizike të përdetura nga gratë (18-55 vjeç)

|                                  | N=646 879   |      |            |     |
|----------------------------------|-------------|------|------------|-----|
|                                  | Gjatë jetës |      | Aktualisht |     |
| Numri i llojeve të dhunës fizike | n           | %    | n          | %   |
| 1                                | 64 868      | 10,0 | 49 749     | 7,7 |
| 2                                | 36 233      | 5,6  | 20 554     | 3,2 |
| 3                                | 19 288      | 3,0  | 11 417     | 1,8 |
| 4                                | 11 462      | 1,8  | 6 727      | 1,0 |
| 5                                | 6 868       | 1,1  | 3 038      | 0,5 |
| 6                                | 5 676       | 0,9  | 1 098      | 0,2 |
| 7                                | 2 279       | 0,4  | 932        | 0,1 |
| 8                                | 1 879       | 0,3  | 307        | 0,0 |
| 9                                | 901         | 0,1  | 197        | 0,0 |
| 10                               | 1 117       | 0,2  | 689        | 0,1 |
| 11                               | 1 068       | 0,2  | 465        | 0,1 |
| 12                               | 1 547       | 0,2  | 78         | 0,0 |

**Tabela 7.** Llojet e shumëfishta të dhunës seksuale të përdetura nga gratë (18-55 vjeç)

|                                    | N=646 879   |     |            |     |
|------------------------------------|-------------|-----|------------|-----|
|                                    | Gjatë jetës |     | Aktualisht |     |
| Numri i llojeve të dhunës seksuale | n           | %   | n          | %   |
| 1                                  | 31 448      | 4,9 | 27 300     | 4,2 |
| 2                                  | 19 639      | 3,0 | 5 239      | 0,8 |

**Tabela 8.** Shpeshtësia e marrëdhënieve seksuale të detyruara nga bashkëshorti, sipas dhunës seksuale

| Gjatë muajit të kaluar, sa shpesh keni kryer marrëdhënie seksuale me bashkëshortin/partnerin tuaj pa pëlqimin tuaj? | Dhunë seksuale |      | Dhunë jo seksuale |      | Testi i domethënies statistikore |       |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|------|-------------------|------|----------------------------------|-------|
|                                                                                                                     | n              | %    | n                 | %    | X <sup>2</sup>                   | Vlera |
| Asnjëherë                                                                                                           | 17 732         | 34,8 | 461 381           | 78,2 | 48 865,62                        | 0,000 |
| Shumë rrallë                                                                                                        | 21 887         | 43,0 | 82 696            | 14,0 |                                  |       |
| Ndonjëherë                                                                                                          | 8 358          | 16,4 | 32 219            | 5,5  |                                  |       |
| Shpesh                                                                                                              | 1 299          | 2,5  | 2 438             | 0,4  |                                  |       |

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

**Tabela 9.** Llojet e shumëfishta të dhunës në familje të përdetura nga gratë (18-55 vjeç)

|                                      | N=646 879   |      |            |      |
|--------------------------------------|-------------|------|------------|------|
|                                      | Gjatë jetës |      | Aktualisht |      |
| Numri i llojeve të dhunës në familje | n           | %    | n          | %    |
| 1                                    | 232 017     | 35,9 | 247 467    | 38,3 |
| 2                                    | 108 255     | 16,7 | 77 587     | 12,0 |
| 3                                    | 44 100      | 6,8  | 22 299     | 3,4  |

**Tabela 10.** Marrëdhëniet ndërmjet llojeve të dhunës në familje

|                    | N=646 879          |                   |       |                  |              |                   |         |                   |                |                   |         |                   |
|--------------------|--------------------|-------------------|-------|------------------|--------------|-------------------|---------|-------------------|----------------|-------------------|---------|-------------------|
|                    | Dhuna psikologjike |                   |       |                  | Dhuna fizike |                   |         |                   | Dhuna seksuale |                   |         |                   |
|                    | Po                 |                   | Jo    |                  |              |                   |         |                   |                |                   |         |                   |
|                    | n                  | %                 | n     | %                | n            | %                 | n       | %                 | n              | %                 | n       | %                 |
| Dhuna psikologjike | ---                | ---               | ---   | ---              | 146 526      | 38,9 <sup>a</sup> | 230 029 | 61,1 <sup>a</sup> | 49 006         | 13,0 <sup>a</sup> | 327 550 | 87,0 <sup>a</sup> |
| Dhuna fizike       | 146 526            | 95,7 <sup>a</sup> | 6 660 | 4,3 <sup>a</sup> | ---          | ---               | ---     | ---               | 45 025         | 29,4 <sup>a</sup> | 108 162 | 70,6 <sup>a</sup> |
| Dhuna seksuale     | 49 006             | 95,9 <sup>a</sup> | 2 081 | 4,1 <sup>a</sup> | 45 025       | 88,1 <sup>a</sup> | 6 062   | 11,9 <sup>a</sup> | ---            | ---               | ---     | ---               |

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

<sup>a</sup> Vlera = 0,000

**Tabela 11.** Llojet e shumëfishta të lëndimeve e shkaktuara nga dhuna në familje të pësuar nga gratë e dhunuara (18-55 vjeç)

|                                        | N=646 879   |      |            |     |
|----------------------------------------|-------------|------|------------|-----|
|                                        | Gjatë jetës |      | Aktualisht |     |
| Numri i kategorive të lëndimeve fizike | n           | %    | n          | %   |
| 1                                      | 19 706      | 12,4 | 7 436      | 4,7 |
| 2                                      | 4 749       | 3,0  | 2 406      | 1,5 |
| 3                                      | 2 451       | 1,5  | 1 038      | 0,7 |
| 4                                      | 801         | 0,5  | 524        | 0,3 |
| 5                                      | 711         | 0,4  | 152        | 0,1 |
| 6                                      | 1 453       | 0,9  | 212        | 0,1 |

**Tabela 12.** Lëndimet e pësuar, të shkaktuara nga dhuna në familje, sipas llojit të dhunës fizike dhe seksuale (gjatë jetës)

|                                                                                        | Dhuna fizike<br>(të gjitha llojet) |                   | Dhunë fizike<br>e moderuar |                   | Dhunë fizike<br>e rëndë |                   | Dhunë fizike<br>me armë |                   | Dhuna<br>seksuale |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|-------------------|----------------------------|-------------------|-------------------------|-------------------|-------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
|                                                                                        | n                                  | %                 | n                          | %                 | n                       | %                 | n                       | %                 | n                 | %                 |
| Llojet e lëndimeve                                                                     |                                    |                   |                            |                   |                         |                   |                         |                   |                   |                   |
| Çarje/prerje, nxirje, or dhimbje                                                       | 19 252                             | 12,6 <sup>a</sup> | 18 842                     | 13,2 <sup>a</sup> | 17 452                  | 19,2 <sup>a</sup> | 8 028                   | 41,0 <sup>a</sup> | 9 498             | 18,6 <sup>a</sup> |
| Lëndime në sy, djegie, ndrydhje<br>or nxjerrje kyçesh/eshtresh                         | 10 077                             | 6,6 <sup>a</sup>  | 9 882                      | 6,9 <sup>a</sup>  | 8 811                   | 9,7 <sup>a</sup>  | 4 313                   | 22,0 <sup>a</sup> | 4 714             | 9,2 <sup>a</sup>  |
| Plagë të thella, eshtra të thyera,<br>dhëmbë të thyer ose çdo lëndim<br>tjetër i rëndë | 3 510                              | 2,3 <sup>a</sup>  | 3 510                      | 2,5 <sup>a</sup>  | 3 510                   | 3,9 <sup>a</sup>  | 2 988                   | 15,3 <sup>a</sup> | 3 001             | 5,9 <sup>a</sup>  |
| Kishin humbur ndjenjat                                                                 | 1 731                              | 1,1 <sup>a</sup>  | 1 731                      | 1,2 <sup>a</sup>  | 1 731                   | 1,9 <sup>a</sup>  | 1 591                   | 8,1 <sup>a</sup>  | 1 591             | 3,1 <sup>a</sup>  |
| Lëndime në kokë                                                                        | 10 391                             | 6,8 <sup>a</sup>  | 10 255                     | 7,2 <sup>a</sup>  | 9 922                   | 10,9 <sup>a</sup> | 6 022                   | 30,7 <sup>a</sup> | 6 108             | 12,0 <sup>a</sup> |
| Lëndime abdominale                                                                     | 7 073                              | 4,6 <sup>a</sup>  | 6 900                      | 4,8 <sup>a</sup>  | 7 073                   | 7,8 <sup>a</sup>  | 4 692                   | 24,0 <sup>a</sup> | 5 948             | 11,6 <sup>a</sup> |

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

<sup>a</sup> Vlera = 0,000

**Tabela 13.** Llojet e lëndimeve të shkaktuara nga dhuna në familje, sipas paaftësisë për të bërë punët e shtëpisë/kujdesur për fëmijët

|                                                                                  | Pamundësi për të bërë punët e shtëpisë/ kujdeset për fëmijët |                   | Numri i ditëve të humbura |      |          |      |                     |      |
|----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|-------------------|---------------------------|------|----------|------|---------------------|------|
|                                                                                  |                                                              |                   | 1-3 ditë                  |      | 4-6 ditë |      | 7 ose më shumë ditë |      |
| Llojet e lëndimeve                                                               | n                                                            | %                 | n                         | %    | n        | %    | n                   | %    |
| Çarje/prerje, nxirje, or dhimbje                                                 | 7 333                                                        | 38,1 <sup>a</sup> | 4 343                     | 59,2 | 1 893    | 25,8 | 1 097               | 15,0 |
| Lëndime në sy, djegie, ndrydhje or nxjerrje kyçesh/eshttrash                     | 5 196                                                        | 51,6 <sup>a</sup> | 2 901                     | 55,8 | 1 761    | 33,9 | 534                 | 10,3 |
| Plagë të thella, eshtra të thyera, dhëmbë të thyer ose çdo lëndim tjetër i rëndë | 1 676                                                        | 47,7 <sup>a</sup> | 967                       | 57,7 | 152      | 9,1  | 557                 | 33,2 |
| Kishin humbur ndjenjat                                                           | 567                                                          | 32,8 <sup>a</sup> | 427                       | 75,3 | 0        | 0,0  | 140                 | 24,7 |
| Lëndime në kokë                                                                  | 4 879                                                        | 47,0 <sup>a</sup> | 2 725                     | 55,9 | 1 080    | 22,1 | 1 074               | 22,0 |
| Lëndime abdominale                                                               | 3,925                                                        | 55,5 <sup>a</sup> | 1,988                     | 50,6 | 840      | 21,4 | 1,097               | 27,9 |

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

<sup>a</sup> Vlera = 0,000

**Tabela 14.** Llojet e lëndimeve të shkaktuara nga dhuna në familje sipas paaftësisë për të bërë punë

|                                                                                  | Pamundësi për të bërë punët e shtëpisë/ kujdeset për fëmijët |                   | Numri i ditëve të humbura |      |          |      |                     |      |
|----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|-------------------|---------------------------|------|----------|------|---------------------|------|
|                                                                                  |                                                              |                   | 1-3 ditë                  |      | 4-6 ditë |      | 7 ose më shumë ditë |      |
| Llojet e lëndimeve                                                               | n                                                            | %                 | n                         | %    | n        | %    | n                   | %    |
| Çarje/prerje, nxirje, or dhimbje                                                 | 3 207                                                        | 16,7 <sup>a</sup> | 1 253                     | 39,1 | 1 025    | 32,0 | 929                 | 29,0 |
| Lëndime në sy, djegie, ndrydhje or nxjerrje kyçesh/eshttrash                     | 2 201                                                        | 21,8 <sup>a</sup> | 664                       | 30,2 | 1 003    | 45,6 | 534                 | 24,3 |
| Plagë të thella, eshtra të thyera, dhëmbë të thyer ose çdo lëndim tjetër i rëndë | 953                                                          | 27,2 <sup>a</sup> | 335                       | 35,2 | 230      | 24,1 | 388                 | 40,7 |
| Kishin humbur ndjenjat                                                           | 219                                                          | 12,6 <sup>a</sup> | 0                         | 0,0  | 78       | 35,8 | 140                 | 64,2 |
| Lëndime në kokë                                                                  | 2 580                                                        | 24,8 <sup>a</sup> | 952                       | 36,9 | 722      | 28,0 | 906                 | 35,1 |
| Lëndime abdominale                                                               | 1 834                                                        | 25,9 <sup>a</sup> | 326                       | 17,8 | 579      | 31,6 | 929                 | 50,7 |

\*Shënim: Përqindjet e krahasimit janë bazuar në përqindje të vlefshme dhe nuk pasqyrojnë rastet që mungojnë.

<sup>a</sup> Vlera = 0,000

**Tabela 15.** Përdorimi i mjeteve kontraceptive nga gratë dhe rreziku i SST-ve sipas dhunës seksuale

|                                                                                                | Dhunë seksuale |      | Dhunë jo seksuale |                   | Testi i domethënies statistikore |       |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|------|-------------------|-------------------|----------------------------------|-------|
|                                                                                                | n              | %    | n                 | %                 | X <sup>2</sup>                   | Vlera |
| Përdorimi i mjeteve kontraceptive/parandalimit të shtatzënisë                                  |                |      |                   |                   |                                  |       |
